MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR


TREGUESIT/INDIKATORËT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

SETI I PARË

Prishtinë

Qershor, 2016





MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

TREGUESIT/INDIKATORËT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

SETI I PARË

Qershor, 2016

Prishtinë

Ky dokument i hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor paraqet setin e parë të treguesve/indikatorëve për fushën e planifikimit hapësinor. Përmbajtja dhe rezultatet e treguesve janë të bazuar në të dhënat aktuale të sektorëve relevant të Qeverisë së Kosovës, dhe të dhënat nga burime të ndryshme kredibile për fushat përkatëse. Pjesa e konsiderueshme e analizave, grafikëve, tabelave, hartave dhe fotove të prezantuara në dokument janë origjinale, janë produkt i angazhimit të zyrtarëve përgjegjës për temat përkatëse.

Dokumenti është i natyrës së hapur, i cili gjatë gjithë kohës do të plotësohet me informata dhe analiza aktuale për treguesit e setit të parë. Paralelisht me këtë tashmë ka filluar hartimi i setit të dytë me një listë të re të treguesve që do ta kenë të njëjtën rëndësi për sektorin. Të gjitha këto informata do të publikohen në Ueb-faqen e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe do të jenë të qasshme për të gjithë të interesuarit, me fokus të veçantë në komunitetin e planerëve, duke përfshirë edhe përgjegjësit e të dy niveleve të planifikimit hapësinor në Kosovë.

Përmbajtja:

H Y R J E 5

PROCESI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË RAPORT ME TREGUESIT 7
DËSHMITË/FAKTET DHE MONITORIMI PËRMES TREGUESVE 7
TRAJTIMI I TREGUESVE PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR 8
TREGUESIT / INDIKATORËT 10
TIPOLOGJIA E TREGUESVE/INDIKATORËVE 10
TREGUESIT SIPAS PARAQITJES/PERFORMANCES 11

SETI I PARË ME TREGUESIT E TRAJTUAR 11

DENDËSIA E POPULLSISË DHE SHPËRNDARJA E SAJ 12
MIGRIMET E JASHTME NË KOSOVË 14
RAPORTI NË MES POPULLSISË URBANE DHE RURALE 17
SHKALLA E PAPUNËSISË 21
BRUTO PRODUKTI VENDOR (BPV) PËR KOKË BANORI 24
PJESËMARRJA E SEKTORËVE NË BPV 26
VLERA E EKSPORT - IMPORTIT DHE E BILANCI TREGTAR 28
NUMRI I VIZITORËVE TË JASHTËM DHE VENDOR 30
RAPORTI NË MES PRODHIMIT DHE KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE 32
PËRQINDJA E POPULLSISË QË FURNIZOHET ME UJË TË PIJSHËM 34
PËRQINDJA E RRUGËVE TË ASFALTUARA NGA RRJETI I RRUGËVE 36
DENDËSIA E RRJETIT RRUGOR TË ASFALTUAR NË KOSOVË 38
DENDËSIA E RRJETIT HEKURUDHOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 40
PROGRESI NË MENAGJIMIN E ZONAVE TË NDOTURA 42
KUALITETI I AJRIT 44
KUALITETI I UJËRAVE SIPËRFAQËSORE 47
DEGRADIMI I SHTRETËRVE TË LUMENJVE DHE RREZIKU NGA VËRSHIMET 50
PËRDORIMI (SHFRYTËZIMI) I TOKËS 52
PYLLZIMI DHE RIPYLLZIMI SI MASË ANTIEROZION 55
POTENCIALI I TOKËS BUJQËSORE 57
POTENCIALI I TOKËS NDËRTIMORE 60
VENDBANIMET JOFORMALE 63
NUMRI I NDËRTIMEVE PA LEJE 65
LLOJLLOJSHMËRIA BIMORE 69
ZONAT E MBROJTURA NATYRORE 70
NUMRI I MONUMENTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE NËN MBROJTJE 72

PËRGJEGJËS TË ZHVILLIMIT TË TREGUESVE/INDIKATORËVE 75

LITERATURA DHE REFERENCAT PËR TREGUESIT E TRAJTUAR 76

Planifikimi hapësinor është një funksion i sektorit publik, që zhvillohet në një proces me cikël në qark të mbyllur dhe me fushë-veprimtarinë e vet shumë-disiplinore që tregon për nivelin e zhvillimit të territorit të caktuar përmes analizës dhe studimit të ndërhyrjeve e të ndërlidhjes së veprimeve sektoriale në hapësirën gjegjëse. Andaj, për të dëshmuar nivelin e arritur të zhvillimit hapësinor të një vendi, rajoni ose komune, planifikimi hapësinor bazohet në të dhënat (informatat) sektoriale në dispozicion. Kështu që, edhe vetë hulumtim-kërkimi, grumbullimi, përpunimi dhe ruajtja e këtyre informatave konkrete, që janë kryesisht rezultate të matshme dhe konkluzione të dala për indikatorët themelor, të cilat krijojnë platformën bazë që do të mundësonte, së pari paraqitjen, analizën dhe vlerësimin e gjendjes së arritur të zhvillimit hapësinor dhe më pas në nxitjen, ndikimin dhe koordinimin e zhvillimeve të ardhshme. Nëse objektivat dhe veprimet strategjike janë të planifikuara mirë, me kujdes e saktësi, atëherë edhe matjet periodike, për arritjet e synuara janë të mundshme, si për vlera të rezultuara për indikatorë ashtu edhe në përmirësimin e gjendjes së mëparshme zhvillimore, përkatësisht të jetës së qytetarëve.

Qëllimi kryesor i sektorit të planifikimit hapësinor, është krijimi dhe menaxhimi efektiv i një organizimi territorial e hapësinor për rajonin e caktuar, duke synuar arritjen e një shfrytëzimi sa më racional e të ndërlidhur të përdorimeve të tokës dhe të resurseve të trashëguara si dhe të objektivave që sigurojnë një balancë në mes kërkesave për zhvillim socio-ekonomik dhe nevojave për mbrojtje të mjedisit.

Mes tjerash, planifikimi hapësinor përfshinë masat për koordinim dhe për përmirësim të ndikimeve hapësinore, të politikave tjera sektoriale, për të arritur një shpërndarje më të barabartë të zhvillimit ekonomik për një territor të caktuar, ndryshe nga zhvillimi i trendit që do të krijohej nga forcat aktuale të tregut. Prandaj, edhe me të drejtë thuhet se, planifikimi hapësinor është mbështetësi më i rëndësishëm për promovim të investimeve, që ofrojnë përfitime në zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, në përmirësim të mjedisit ku jetojmë dhe të vet cilësisë së jetesës.

Ndër faktorët më të rëndësishëm, që planifikimin hapësinor e bëjnë një sistem më të fortë dhe më të efektshëm, janë:

- Angazhimi i hershëm i aktorëve kyç në proces të planifikimit dhe në komunikim e dialog të vazhdueshëm;
- Pajtueshmëria për parime, objektiva dhe strategji të zhvillimit hapësinor, për të cilat edhe nuk kërkohet qasje e detajuar dhe e fiksuar për zonën e përcaktuar;
- Zhvillimi i një planifikimi hapësinor të bazuar në dëshmi e fakte, për të siguruar një themel të fortë për politikë-bërjen dhe vendim-marrjen;
- Përdorimi i procedurave të drejta, reale dhe të qëndrueshme, që sigurojnë se edhe çështjet e influencuara kanë qasje në procesin e vendim-marrjes;
- Hartimi i një plani-kornizë të thjeshtë, që ofron siguri dhe mundësi për një fleksibilitet në fushat që janë objekt i ndryshimeve të mëdha;
- Përnjohja dhe përfshirja e kushteve lokale, në një proces fleksibil, për trajtim të pasojave të paparashikuara dhe propozimin e zgjidhjeve të qëndrueshme;
- Aplikimi i analizave vlerësuese dhe të teknikave të arsyetimit (fizibilitetit), për të vlerësuar ndikimet potenciale të politikave alternative;
- Integrimi i strategjive urbane dhe rurale, që sigurojnë se punët dhe interesat sektoriale janë në ujdi dhe bashkëpunim të ndërsjellë;

- Bashkë-udhëheqja, strategjia dhe koordinimi i të gjitha resurseve (të kapaciteteve dhe burimeve e pasurive: natyrore, njerëzore, financiare, teknike etj.), që janë themelet kryesore të zbatimit.

Meqenëse, sektori i planifikimit hapësinor njihet për rolin e vet integrues, ndërmjetësues dhe koordinator i të gjitha ndërhyrjeve të mundshme sektoriale në hapësirë, atëherë ai është edhe përgjegjësi kryesor dhe i drejtpërdrejtë për pasqyrim të gjendjes aktuale dhe për hartim, zbatim, monitorim dhe vlerësim, të shkallës së arritur nga realizimi i strategjisë së planifikuar për zhvillimet e ardhshme hapësinore, në kuadër të procesit të planifikimit hapësinor. Njëkohësisht, për zhvillimin dhe funksionimin e drejtë të këtij procesi dhe sektori të në të dy nivelet e qeverisjes në Kosovë, përveç mekanizmit të ndërtuar për pasqyrim të gjendjes dhe hartim të strategjisë duhet të ngrihen edhe mekanizmat tjerë, me përgjegjësi të zbatimit të strategjisë, monitorimit dhe raportimit si dhe të vlerësimit të arritjeve, duke fuqizuar edhe më tej fazat përkatëse në procesin e planifikimit hapësinor.

PROCESI I PLANIFIKIMIT HAPËSINOR NË RAPORT ME TREGUESIT

Procesi i planifikimit hapësinor zhvillohet në një cikël të vazhdueshëm dhe në qark të mbyllur, me fazat kryesore të saj, duke përfshirë funksione dhe veprime që duhet ndërmarrë në mënyrë që të jepen përgjigje edhe në pyetjet, si në vijim:

- Ku jemi?
- Ku dëshirojmë të shkojmë?
- Si do të shkojmë? dhe
- A i kemi arritur synimet dhe objektivat?

Rrjedhimisht, një vlerësim i tillë për shkallën e arritur të zhvillimit të planifikuar mundësohet nga rezultatet e prodhuara për tregues (indikatorë) të trajtuar, që janë informata të dala në formë një rezultati të drejtpërdrejtë (vlerë numerike dhe njësi) ose të vlerësimit rezultues (konkluzione të nxjerra) që tregojnë për efekte/pasoja të shkaktuara/ndikuara nga projekte-plane-programe të realizuara.

Ndërsa, bazuar në vlerën e rezultuar për nivelin e arritur të shkallës së zbatimit, të Strategjisë së Planifikuar, me qëllime e objektiva afatgjata dhe afatmesme dhe të Planit të Veprimit saj, me projekt-programe dhe aktivitete afatmesme dhe afatshkurta, përcaktohet edhe mënyra e Rishikimit të Planit, si fazë përmbyllëse e një cikli qarkor dhe për të filluar tjetrin në vazhdën e procesit të planifikimit hapësinor, përmes procesit të Revidimit (plotësim/ndryshimit) apo të Hartimit të një Plani të Ri.

DËSHMITË/FAKTET DHE MONITORIMI PËRMES TREGUESVE[1]

Ofrimi i informacionit është një mjet tepër i rëndësishëm për planifikim dhe menaxhim të zhvillimit hapësinor, i cili për të qenë efikas duhet të jetë edhe shumë i kujdesshëm, sepse:

- Rrezikon shtyrjen e politikë-bërjes së rëndësishme për shkak të përqendrimit vetëm në mbledhjen e të dhënave nga burime të sigurta (meqë studim-hulumtimi duhet t'i paraprijë planit);
- Nevojitet të zhvillohet një proces ndërveprues dhe përsëritës, që mund të përdor plane dhe politika të përkohshme, përderisa baza e fakteve-dëshmive të jetë në zhvillim e sipër;
- Informatat duhet të mbahen në një bazë të përbashkët të dhënash, që është e mbështetur së paku nga një sistem i thjeshtë i informacionit gjeografik (GIS);
- Baza e të dhënave duhet të mbështesë dhe të ruaj regjistrimin e ndryshimeve hapësinore, si për: përdorimin dhe pronësinë e tokës, rritjen dhe shpërndarjen demografike, aktivitetet dhe zhvillimet sociale dhe ekonomike, qasjet dhe shërbimet në infrastrukturë, si dhe në cilësinë e mjedisit dhe të ndërtimeve, duke përfshirë edhe rreziqet natyrore e njerëzore, etj.;
- Është shumë me rëndësi të kuptohet se: ku, si dhe çfarë ndryshimesh po ndodhin, dhe se kush janë shkaktarët apo drejtuesit që ndikuan në efekte ose pasoja të prodhuara;
- Qasja fillestare duhet të jetë e orientuar kah problemi në mënyrë që çështjet dhe proceset kyçe të identifikuara të shërbejnë për pika referuese të ndërhyrjes së menjëhershme dhe potenciale të mundshme për ndryshime të ardhshme.

Qëllimi dhe rezultatet e treguesve janë komponentë thelbësore në procesin e planifikimit dhe gjerësisht po përdoren çdo ditë e më shumë për të ndihmuar jo vetëm planerët por edhe politikë-

[1] UN Economic Commission for Europe Geneva, *SPATIAL PLANNING: Key Instruments for Development and Effective Governance* (with Special Reference to Countries in Transition, page 27 – 28), New York and Geneva 2008.

bërjen dhe vendim-marrjen, në formulimin dhe hartimin e politikave, të planeve strategjike dhe në vlerësimin e rishikimin e tyre. Kështu që, procesi i planifikimit hapësinor, duhet të integrojë dhe të mundësojë një përdorim sa më të lehtë të informatave të krijuara edhe nga organizatat tjera publike dhe private. Për këtë qëllim, është e preferueshme të themelohet një përgjegjës rajonal i mbikëqyrjes së të dhënave hapësinore, i cili punon për interesa të një numri të konsiderueshëm të hisedarëve sektorial, që grumbullon, përzgjedhë, ndërlidh, ndërton dhe ruan të dhënat e përgjithshme, për të mundësuar edhe analiza të ndryshme në nivelin rajonal e lokal. Prandaj ana më madhore e këtij zhvillimi është dhe përnjohja me organizimin hapësinor dhe të funksionimit të territorit, e posaçërisht të veprimtarive për strehim e punësim, duke përfshirë edhe trendin e transportit dhe qasshmërisë.

Bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor (LPH) Nr. 04/L-174, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), si pjesë e ekzekutivit të qeverisjes qendrore, është instanca më e lartë dhe përgjegjëse për profilizim të gjendjes, planifikim të ardhshëm, zbatim, monitorim e raportim si dhe vlerësim të zhvillimeve hapësinore për territorin e Kosovës, përderisa në nivelin lokal, këtë përgjegjësi për tërë territorin komunal e bartë Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm[2].

TRAJTIMI I TREGUESVE PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH) në kuadër të MMPH-së, ka marr për sipër hartimin e një dokumenti kornizë "Indikatorë themelor për planifikim hapësinor", me qëllim të krijimit të një instrumenti bazik dhe të nevojshëm për këtë sektor. Prandaj, nëpërmjet rezultateve të prodhuara për indikatorët (si vlera të drejtpërdrejta numerike dhe konkluzione të nxjerra për ndikimet e shkaktuara në hapësirë për periudhën e caktuar) e prezantuar në këtë dokument, po ndërtojmë një hallkë të rëndësishme që do ta lehtësojë në përgjithësi procesin e planifikimit hapësinor. Për planerët dhe politikë-bërjen, do të bëhet më e lehtë vendim-marrja, meqë këto rezultate mundësojnë, jo vetëm pasqyrimin dhe vlerësimin e nivelit të zhvillimit hapësinor, por edhe krahasimi i vlerave si me ato të jashtme ashtu dhe me ato të brendshme për territorin e caktuar (të Kosovës apo të Komunës).

- Krahasimi i brendshëm - është krahasimi i vlerave të fituara për indikatorë, nga matja e tyre në periudha të ndryshme kohore, e që tregojnë për ndryshimet e niveleve të zhvillimit të një vendi, rajoni apo komune, dhe
- Krahasimi i jashtëm – është krahasimi i vlerave të fituara për indikatorë, nga matja e tyre aktuale, që tregojnë për nivelin e zhvillimit të një vendi, rajoni apo komune në raport me nivelin e zhvillimit të vendeve, rajoneve apo komunave tjera përreth dhe më gjerë.

Hartimi i këtij dokumenti me indikatorë themelorë për planifikim hapësinor, është i domosdoshëm për kohën dhe do të shërbejë si instrument bazë për matje dhe vlerësim periodik të zhvillimit. Duke pasur lkëtë parasysh shtohet nevoja për vendosjen e një sistem raportues të mirëfilltë për monitorim të gjendjes së zhvillimeve dhe të vlerësimit të zbatimit të planeve. Një veprim i tillë është në harmoni të plotë me Direktivën 2007/2 të Këshillit të Evropës dhe Parlamentit të Evropës - INSPIRE, për Informata Hapësinore dhe Infrastrukturore të komunitetit Evropian dhe me listat e indikatorëve të Agjencive Evropiane për Statistika - EUROSTAT dhe asaj për Mjedis - EEA si dhe të Rrjetit Mbikëqyrës për Planifikim Hapësinor Evropian - ESPON[3] (që trajton dhe pasqyron vlerat e rezultuara për regjionet statistikore të nivelit NUTS'2 e NUTS3 në BE).

Si pjesë e sektorit, duke përfshirë dy nivelet e vendimmarrjes, në vazhdimësi duhet të kërkojmë dhe të përmirësojmë formulimet, për qëllimet specifike (objektivat) dhe të përgjithshme (synimet), në të gjitha llojet e planeve, në mënyrë që të sigurohet një ndërlidhje e fortë me indikatorë përkatës por

[2] Shënim: Drejtoritë nëpër komuna kanë emërtime të ndryshme, ky përveç urbanizmit, mund të figurojnë edhe planifikimi, mjedisi, kadastri, etj.
[3] ESPON: The European Spatial Planning Observation Network (*në gjuhën shqipe: Rrjeti Mbikëqyrës i Planifikimit Hapësinor Evropian*).

edhe të mundësohet matja e arritjeve të tyre. Kur rezultatet e fituara drejtohen nga procesi i planifikimit hapësinor nuk mungon efikasiteti dhe se do të arrihet një zhvillimi i qëndrueshëm për vendin.

Krijimi i sistemit për monitorim dhe vlerësim të zhvillimeve, me qëllim të integrimit të niveleve të planifikimit hapësinor dhe të politikave ndër-sektoriale, është një sfidë e madhe dhe shumë me rëndësi në procesin e planifikimit. Ngritja dhe trajtimi i kësaj sfide lidhet ngushtë me kornizën e konkluzioneve të renditura, që dalin nga zhvillimi indikatorëve për planifikim hapësinor, e cila sigurohet përmes një grupi të përzgjedhur indikatorësh sipas këtyre kritereve kyçe:

- Lista-kornizë e propozuar e indikatorëve (treguesve) do të shërbejë si platformë e fuqishme që edhe palët tjera të interesit të zhvillojnë kornizën e vet të treguesve sektorial e hapësinor;
- Korniza duhet të jetë e përshtatshme për të gjithë Kosovën/Regjionin/Komunën dhe të formoj një shtyllë të fortë lidhur me monitorimin e politikave nga sektorët tjerë;
- Analizat nuk duhet të përqendrohen vetëm në vlerën e thjeshtë të prodhuar të treguesit por më shumë në mënyrën e kombinimit të treguesve për të nxjerrë politika të mençura e kuptimplote;
- Analiza duhet të përfshijë aspektin hapësinor duke theksuar rëndësinë e funksionimit të zonave me qasjet dhe ndërlidhjet hapësinore;
- Fokusimi në shfrytëzim të rezultateve përfundimtare (konkluzioneve) që dalin nga treguesit, ndihmon planerët dhe palët kryesore të interesit në pikëpyetjet e tyre për vlerat, supozimet dhe strategjitë bazike, që përmes veprimeve politike të jenë në gjendje të modifikojnë edhe politika, qëllime dhe veprime tjera për të adresuar edhe çështje të reja të identifikuara;
- Korniza duhet të ndihmoj në sigurimin e qasjes së lehtë të komunikimit dhe të përsëritjes së monitorimit të cilën duhet mbjellë me kohë mu në thelb të procesit të krijimit të politikave.

Planifikimi hapësinor në mes tjerash, ka për qëllim formësimin dhe pasqyrimin e rezultateve të zhvillimit të një vendi, regjioni specifik apo komune. Nga përvojat e shumta, të shteteve tjera, rekomandohet që rezultatet përfundimtare të zhvillimeve hapësinore duhet të jenë të matshme. Këto rezultate, duhet të shikohen si efekte të kombinuara me karakteristika socio-ekonomike dhe mjedisore, të mbështetura nga sistemi i planifikimit e të përkrahura edhe nga sektorët dhe forcat tjera, që tentojnë arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm për hapësirën e caktuar territoriale.

Prandaj, identifikimi dhe specifikimi i indikatorëve për planifikim hapësinor, do të shërbejë si një kornizë bazë për trajtimin e gjendjes së zhvillimeve, të cilët, duhet të ndërlidhen drejt për drejt me objektivat (qëllime specifike) e synimet (qëllimet e përgjithshme) dhe të jenë titullar (udhëheqës) dhe domethënës nëpër disa fusha (sfera) kryesore tematike të trajtimit të zhvillimeve, që në rastin tonë janë:

- Demografia dhe zhvillimi social;
- Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik;
- Shfrytëzimi racional dhe efikas i resurseve për zhvillim cilësor;
- Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit natyror e kulturor – historik;
- Qasja dhe përfshirja e komuniteteve në infrastrukturë dhe shërbime.

Meqenëse, ballafaqimi dhe krahasimi i rezultateve të dala nga matja e vlerës së indikatorëve, në fazën e monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes së zhvillimeve të planifikuara kundruall vlerave të regjistruara në gjendjen ekzistuese, është sfidë e përgjithshme, meqë akoma nuk ekziston një sistem i unifikuar për monitorim dhe vlerësim të zbatimit të instrumenteve të planifikimit hapësinor. Një gjë e tillë mund të rregullohet me nxjerrjen e këtij dokumenti (lista kornizë e unifikuar e indikatorëve), të cilët duhet të jenë të matshëm dhe të bazuar në këto parime:

- Rezultati përfundimtar i indikatorit (në formën e efektit dhe pasojës së prodhuar - konkluzioni) duhet të jetë një e dalë që rrjedh nga objektivat e bazuara në një sistem të udhëhequr nga instrumente planifikimi;
- Konkluzionet duhet të interpretohen në frymën e kontekstit më të gjerë kohor dhe hapësinor;
- Rezultatet e drejtpërdrejta mund të përdoren edhe si masa përfaqësimi të konkluzioneve për një periudhë të konsiderueshme kohore dhe mase të gjerë hapësinore;
- Indikatorët duhet të reflektojnë kontributin e planifikimit hapësinor drejt integrimit të politikave kyçe sektoriale në pjesë të ndryshme të rajonit;
- Indikatorët e ndryshëm duhet të maten më mirë në nivele me interes të rëndësisë veçantë hapësinore, si në zonat funksionale dhe ato nën shënjestrën kritike në kuadër të një rajoni, të cilat pasqyrojnë rezultate të ndryshme e komplekse të politikave hapësinore dhe sektoriale;
- Korniza krahas indikatorëve me të hyra matëse duhet të përfshijë edhe procese që ofrojnë konkluzione me ndikim të madh;
- Korniza duhet të përfshijë një grup më të fokusuar të treguesve me konkluzione që formojnë pakon me tregues analitik që në mënyrë efikase pasqyrojnë natyrën shumëdimensionale të objektivave të planifikimit hapësinor;
- Analizat duhet të përdorin sondazhe shtesë për të bërë vlerësime të ndryshme me të cilat konstatohen konkluzionet e 'padukshme dhe të buta', dhe
- Analizat duhen të zgjedhin afatin më të përshtatshëm për të vlerësuar efektin më afatgjatë të politikave të planifikimit hapësinor.

TREGUESIT / INDIKATORËT

Treguesi ose indikatori është një e dhënë (informatë) që paraqet një masë të matshme sasie (vlerë numerike me njësi matëse) apo edhe një konkluzion i nxjerrë cilësie (vlerësim ose përfundim i dalë nga krahasimi i vlerave të fituara ose për efektet/pasojat e shkaktuara nga ndikimet e ndryshme), që përdoret për të treguar gjendjen aktuale ose ndryshimin e një situate, të një progresi dhe një ndikimi të arritur nga zhvillimi i një aktiviteti, projekti ose programi të planifikuar në kohë dhe territor të caktuar.

TIPOLOGJIA E TREGUESVE/INDIKATORËVE

Indikatorët janë instrumentet esenciale për monitorim dhe vlerësim të gjendjes së zhvilluar dhe se për nga lloji apo tipologjia mund të ndahen dhe klasifikohen në forma të ndryshme:

- Indikatorët me rezultat të drejtpërdrejtë e që saktësisht i korrespondojnë rezultateve të cilitdo nivel të paraqitjes (performances), dhe
- Indikatorët me rezultat indirekt ose "Rrethanor (Proxy)" që përdoren për të treguar ndryshimin ose rezultatin e zhvillimit kur matja dhe rezultati i drejtpërdrejtë i prodhuar nuk është i mundshëm dhe se një vlerë e tillë është vështirë të përcaktohet për një afat të shkurtë kohor;
- Rezultatet e indikatorëve, zakonisht janë një masë sasiore (vlera kuantitative), që d.m.th. janë në formë të një vlere numerike për njësi matëse e që shpreh një përqindje, përpjesëtim ose ndarje, një normë ose një raport (p.sh. banorë/mjekë), dhe
- Indikatorët me rezultat cilësorë (kualitativë) mund të përkufizohen si gjykime dhe perceptime cilësie të njerëzve rreth një teme të caktuar;
- Indikatorët për "cilësinë e jetesës", që matin ndryshimet në shëndetin e popullsisë, arsimin apo punësimin, shpesh janë ngatërruar me indikatorët cilësorë, meqë ata të dy i referohen

"cilësisë". Në fakt, edhe indikatorët me rezultate cilësorë dhe ato sasiorë shërbejnë për matjet në shëndetësi, arsim ose të çfarëdo fushe ose sektori tjetër;

- Përveç, indikatorëve të standardizuar dhe në nivel global, në kontekst të përgjithshëm tematik dhe territorial (që mundësojnë lehtësim në krahasime për të gjithë parametrat ekzistues), vërehet një tendencë e vazhdueshme që të krijohen dhe të zhvillohen edhe indikatorët sipas nevojës me kontekst më specifik si për territore më të vogla (për matjen e ndryshimeve për territore rajonale e kombëtare) ashtu edhe për çështje të ndryshëm tematike, sektoriale e nën-sektoriale, kur edhe rezultatet e fituara të të cilave gjithsesi mundësojnë edhe krahasime me indikatorët e standardizuar.

TREGUESIT SIPAS PARAQITJES/PERFORMANCES

Treguesit/Indikatorët e performancës na tregojnë për rezultatet e fituara që na paraqiten dhe janë më të afërta në relacion me procesin e planifikimit hapësinor sipas çdo niveli – hallke të zinxhirit të "rezultateve": si me të dhëna hyrëse ose bazike, me të dhëna të prodhuara nga proceset, me vlera të prodhuara të drejtpërdrejta, me efekte dhe pasoja të shkaktuara ashtu edhe me prodhime të ndikimeve.

Treguesit me rezultate bazike (Input Indicators) – Tregojnë për masën sasiore, cilësore apo/dhe kohore, për kapacitete dhe burime njerëzore, financiare dhe materiale (teknike, teknologjike dhe informative), që janë të dhëna hyrëse - bazë për planifikim të aktivitetit, projektit apo programit.

Treguesit me rezultate që dalin nga proceset (Process Indicators) – Tregojnë për masën e progresit të arritur si rezultate të prodhuara nga zhvillimi i aktiviteteve në një projekt - program si dhe rruga e mënyra e realizimit tyre.

Treguesit me rezultate të drejtpërdrejta (Output Indicators) – Tregojnë për masën sasiore, cilësore apo/dhe kohore të prodhimeve, mallrave e shërbimeve, që janë rezultate afatshkurta me të dala të drejtpërdrejta nga një aktivitet - projekt – program i zhvilluar.


Treguesit me rezultate të shkaktuara (Outcome Indicators) – Tregojnë për përmasat dhe përfundimet (konkluzionet) e nxjerra si rezultate të ndërmjetme (afatmesme) me të dala në formë efektesh / pasojash të shkaktuara nga një program i zhvilluar.

Treguesit me rezultate të ndikuara (Impact Indicators) – Tregojnë për përmasat e cilësisë apo të sasisë si rezultate afatgjata të prodhuara nga ndikimi i një programi të caktuar (p.sh. të ndryshimeve të matshme në cilësinë e jetës, të reduktimit të sëmundjeve dhe vdekshmërisë së fëmijëve, etj).

SETI I PARË ME TREGUESIT E TRAJTUAR

Në vazhdim është dhënë seti i parë i treguesve/indikatorëve që janë trajtuar dhe renditur sipas çështjeve, sektorëve dhe fushave tematike.

Treguesi:	**DENDËSIA E POPULLSISË DHE SHPËRNDARJA E SAJ**
Synimi:	NGRITJA E NIVELIT TË ZHVILLIMIT DHE KOHEZIONIT SOCIAL
Objektivi:	RRITJA E ZHVILLIMIT SOCIAL TË BARASPESHUAR NËPËR KOMUNA



Përshkrimi i treguesit: Sipas EUROSTAT-it (Agjencisë Evropiane për Statistika), dendësia e popullsisë paraqet raportin mes numrit të popullsisë për njësi të sipërfaqes së një territori për kohën e caktuar. Zakonisht tregon numrin e banorëve të përhershëm në një kilometër katror (b/km²) për njësinë territoriale.

<u>Mënyra e matjes së treguesit:</u> Në Kosovë, nga regjistrimi i fundit më 2011 dhe publikimi i rezultateve zyrtare më 2013 nga ASK[4], vlera mesatare për dendësi të popullsisë është 163.2 b/km², e fituar nga përpjesëtimi i numrit të përgjithshëm të popullsisë (1.780.021 b.) për sipërfaqen e përgjithshme (10.906 km²). Ndërsa, në kontekst të njësisë më të madhe territoriale, ajo tregon për shpërndarjen hapësinore dhe dendësinë e popullsisë së përgjithshme nëpër njësitë më të vogla territoriale.

Fig. 1. Hartat për zhvillimin e trendit të dendësisë së popullsisë nëpër komuna të Kosovës. Burimi: ASK 2013.




Fig. 2. Harta për dendësinë e popullsisë në Kosovë sipas grid-it. Burimi: ASK 2013

<u>Burimi informatës/ave:</u> Burimi kryesor i informatave për këtë tregues është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). ASK-ja ka publikuar hartën me të dhëna për njësi hapësinore edhe më të vogël se ajo komunale, në nivel Rrjeti (grid) me Raster prej 1.000 x 1.000 m, e cila mundëson një imazh më të saktë për shpërndarje, dendësi dhe qartësim të dallimeve në mes të popullsisë rurale dhe urbane.

<u>Kufizimet për matjen e treguesit:</u> Për shkak të lëvizjeve të pa regjistruara mekanike dhe të faktorëve tjerë gjatë fillim shek. XXI në Kosovë, janë bërë vlerësime të ndryshme vendore e ndërkombëtare. Mbi këto vlerësime, që ishin burim informatash me vlera të ndryshme për dendësinë e popullsisë prej 220 -245 b/km², janë prodhuar edhe shumë dokumente të rëndësishme zhvillimore për vendin.

Për shkak të planifikimit të zhvillimeve të ardhshme si dhe të ndarjes së investimeve të përgjithshme, të dhënat për dendësinë dhe shpërndarjen e popullsisë duhet të shqyrtohen si çështje të veçanta. Është

[4] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): *Atllasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011*, Prishtinë 2013.

shumë me rëndësi, që të bëhen edhe analiza të ndryshme për dendësinë, lëvizjet dhe shpërndarjen e popullsisë, të cilat përdoren në varësi të llojit dhe nivelit të planifikimit, kurse, me raste mund të zbatohen edhe indekse të veçanta për popullsinë urbane dhe rurale.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Treguesi i dendësisë së popullsisë është i një rëndësie të veçantë për planifikimin e zhvillimeve të ardhshme hapësinore, meqë përmes shqyrtimit të komponentëve social, ekonomik e të tjerë, mundësohen edhe informata bazë mbi të cilat planifikohen zhvillimet e ardhshme. Në bazë të parametrave dhe trendit të këtij treguesi bëhen edhe planifikimet hapësinore si për ndërtime të objekteve shkollore, shëndetësore, kulturore, të banimit, të infrastrukturës dhe shërbimeve teknike, të organizimeve territoriale, të hapësirave të përbashkëta, etj.

Gjendja e treguesit: Kosova, me vlerën mesatare për dendësinë e popullsisë prej 163.2 b/km², është prijëse në renditjen e vendeve të rajonit, të Evropës Jug-Lindore (shih grafikun në fig. 3), përderisa vlerat mesatare nëpër komuna, janë të ndryshme. Komunat, me shkallë më të ulët të dendësisë së popullsisë, janë Zubin Potoku me 20 b/km², Leposaviqi 26 b/km², Shtërpcë 28 b/km², Novobërdë 33 b/km², etj. Ndërsa, komunat me shkallë më të lartë të dendësisë së popullsisë, janë Mamusha me 500 b/km², Fushë Kosova me 414 b/km², Prishtina me 380 b/km², Ferizaj me 315 b/km², etj.




Fig. 3. Grafiku i dendësisë së popullsisë në vendet e Ballkanit. Burimi: ASK 2013 dhe http://en.wikipedia.org/wiki/Balkans.




Fig. 4. Harta e shpërndarjes së dendësisë popullsisë në rajon. Burimi: "Balkan vital Graphics", koleksioni nga http://www.grida.no/publications/vg/balkan.

Konkluzionet:

- Vlera mesatare e dendësisë së popullsisë në Kosovë (163 b/km²), që është me e ulët se në vlerësimet e deritanishme por që ngelet më e larta në EJL (në Ballkan), u mundësua nga numri i popullsisë që jeton në një territor të vogël. Prandaj, bazuar në kërkesat e shumta për zhvillime të ardhshme në hapësirën e vogël territoriale të Kosovës, kërkon me doemos planifikim hapësinor edhe në nivelin qendror dhe ndërprerje të zhvillimeve sipas trendit ose atyre të pakontrolluara;
- Si në vendet e Evropës, e të rajonit edhe Kosova ka zonat me dendësi të popullsisë prej mbi 5000 b/km² (shih fig. 2). Këtu, përveç zonës së kryeqytetit vërehen edhe gjashtë qytete tjera dhe se këto 7 qendra të mëdha urbane si: Prishtina, Mitrovica, Peja, Gjakova, Prizreni, Ferizaj dhe Gjilani, siç nënvizohen edhe në PHK-në 2010 – 2020+, plotësojnë kushtet për kryeqendra regjionale (të statistikave - NUTS 3) përbrenda territorit të Kosovës.
- Komunat që kryesisht janë me territor të madh dhe numër të vogël të popullsisë, me sipërfaqe të pa banuar malore, që i përkasin brezit kufitar ose janë të banuara me komunitet pakicë, kanë dendësi më të vogël, me nën 50 b/km². Kurse, komunat me territor të vogël, që shtrihen në pjesë më të rrafshëta e qendrore të vendit, në tokat bujqësore, afër rrjedhave lumore e të korridoreve rrugore dhe që ndikohen nga grupimet e bizneseve të mëdha, të qendrave universitare e shëndetësore, të selive ndërkombëtare, etj, kanë shkallë më të lartë të dendësisë, me mbi 200 b/km².

Treguesi :	**MIGRIMET E JASHTME NË KOSOVË**
Synimi:	NGRITJA E NIVELIT TË ZHVILLIMIT DHE KOHEZIONIT SOCIAL
Objektivi:	PARANDALIMI DHE ZVOGËLIMI I EMIGRACIONIT NË VEND DHE NËPËR KOMUNA

Përshkrimi i treguesit: Migrimet paraqesin lëvizjen në hapësirë të popullsisë apo të ndërrimit të vendbanimit nga shteti ëmë në një shtet tjetër. Sipas definicioneve dhe standardeve mbi migrimin ndërkombëtar: një person është Emigrant nëse ai/ ajo ka lënë vendin e tij/saj të lindjes në mënyrë që të vendoset në një shtet tjetër pa marrë parasysh nëse ka ndonjë status të veçantë në vendin në të cilin ka emigruar. Personi që ka migruar (vendosur) është person rezident i atij vendi (Shteti ku personi jeton, që do të thotë, shteti ku ai/ajo ka një vend për të jetuar, ku kalon periudhën ditore të pushimit. Udhëtimet e përkohshme jashtë atij vendit për: pushime, vizita tek miqtë apo të afërmit, për biznes, trajtim mjekësor apo pelegrinazh fetar, nuk e ndryshojnë vendin e qëndrimit te zakonshëm te personit)[5].

Mënyra e matjes së treguesit: Shumë-dimensionaliteti dhe ndërlikueshmëria e migrimeve hapësinore horizontale dhe sociale-vertikale e popullsisë imponojnë nevojën e studimit shkencor të të gjitha formave, drejtimeve, distancës territoriale, aspektit kohor, vëllimit, karakterit etnik, gjuhësor e të konfesionit dhe veçanërisht të shkaqeve dhe pasojave të tyre. Të dhënat janë përllogaritur në dy variante si: a) numri i popullsisë migruese në raport me popullsinë rezidente dhe b) numri i popullsisë migruese në raport me popullsinë e përgjithshme të vendit të origjinës.

Burimi informatës/ave: Të dhënat a) parësore për numrin e emigrantëve jashtë vendit sigurohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, b) sekondare sigurohen nga raporte hulumtuese të organizatave lokale dhe ndërkombëtare dhe c) terciare sigurohen nga studime individuale.

Kufizimet për matjen e treguesit: Mungesa e të dhënave në njësi administrative më të vogla hapësinore / territoriale, veçanërisht mungesa e të dhënave në kontekstin rural – urban, vështirëson edhe kryerjen e një analize më të thellë, për njohjen me gjendjen reale hapësinore dhe masat apo aktivitetet që duhet ndërmerren në përmirësimin e gjendjes në përgjithësi. Arsyet nxitëse, pse njerëzit migrojnë apo lëvizin duke ndërruar vendbanimin e tyre të mëparshëm me një vendbanim tjetër të ri, të komunës apo shtetit tjetër, janë të shumta, të cilat nga ekspertët e fushës ndahen, në faktorët: a) Shtytës dhe b) Tërheqës.




Fig. 1: Grafiku mbi migrimeve ndërkombëtare & arsyet gjatë viteve 1969-2009. Burimi: ASK 2013.

Ndërsa, zbërthimi i këtyre faktorëve dhe shkaqet për migrim janë: i) Sigurimi i ekonomisë familjare në të ardhmen (kur një vend tjetër ofron mundësi punësimi, paga më të larta dhe mënyrë të mirë të jetesës, është faktorë shtytës që nxitë migrim nga vendet më pak të zhvilluara); ii) Standardi më i lartë i jetesës (kur ofrohen kushte që sigurojnë një perspektivë karriere, shërbime më të mira sociale e shëndetësore dhe mënyrë më të mirë të jetesës edhe për fëmijët e tyre të cilat nuk ofrohen nga vendet e tyre të origjinës); iii) Arsimim profesional (kur vendi i origjinës nuk ofron përzgjedhje të profileve të ndryshme profesionale dhe ky

[5] Organizata Ndërkombëtare për Migracion: E drejta migratore ndërkombëtare: Fjalorth i terminologjisë migratore

faktorë bëhet një impuls për gjeneratat e reja me mundësi të emigrimit); iv) Arsyet politike (kur në vendin e origjinës ekzistojnë përndjekjet politike, kundërshtime për sistemin qeverisës dhe ka kufizim të lirisë së shprehjes, emigrimi bëhet me qellim të mos rrezikimit të jetës dhe se në shumë rasteve këtyre personave iu ofrohet edhe siguri personale, hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve politike dhe lobim për vendin e tyre, etj); v) Bashkim familjar (kur anëtarët e familjes së ngushtë apo të gjerë nga vendi i origjinës bashkohen me anëtarët tjerë në vendin e ri të emigrimit, si dhe vi) Arsye të tjera[6].

Në Kosovë që nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar, arsyet kryesore të emigrimit ndërkombëtar, janë të paraqitura në grafikun e fig. 1 dhe kanë këtë përqindje: Familjare 46%, Punësimi 35%, Lufta 1998-99 8%, Arsimimi & qëllime trajnimi 1%, tjera 4% dhe Arsyet që nuk dihen 6%.


Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Të dhënat për migrimin ndërkombëtar, për hulumtuesit, sidomos për planerët demograf dhe social, paraqesin një burim të rëndësishëm për të vlerësuar trendin e migrimit në aspektin riprodhues, atë gjinor, të moshës dhe strukturave të tjera demografike në relacion me (mos) zhvillimin territorial të vendit. Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme për hulumtues të disiplinave e organizatave të ndryshme dhe për hartuesit e politikave e të planeve hapësinore, si në nivel komune ashtu edhe në nivel vendi. Përderisa, emigrimi ndërkombëtar përfshin kryesisht të rinj, në migrimin kombëtar, ishin familje të tëra që u zhvendosën nga viset rurale, kryesisht kodrinore-malore, në viset urbane apo ndër-urbane.

Përveç ndikimit socio-ekonomik, migrimi ndikoi edhe në aspektin riprodhues të popullsisë së Kosovës dhe të zonave të caktuara. Nëse vazhdohet me këtë shkallë të migrimit të të rinjve, Kosova do të humbë një resurs shumë të rëndësishëm, pasojat e të cilit do të vërehen më vonë. Andaj, treguesi i migrimeve ndërkombëtare të popullsisë është i një rëndësie të veçantë për planifikimet e zhvillimeve hapësinore, ngase përmes shqyrtimit të komponentëve social, ekonomik dhe të tjerë, mundëson edhe informata bazë mbi të cilat planifikohen zhvillimet e ardhshme dhe politikë-bërjes brenda dhe jashtë shtetit.

Gjendja e treguesit: Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës cilat dalin nga regjistrimi i popullsisë së Kosovës (2011), të grumbulluara përmes FORMULARI S1, numri i personave (të lindurit në Kosovë) që kanë emigruar nga Kosova është 380,826 veta. Në raport me popullsinë rezidente në Kosovë, del se 21.4 % e popullsisë jeton jashtë saj. Bazuar në analizat e mëtejme të ASK-së, kur në llogaritjen e përgjithshme të numrit popullsisë së emigruar dhe asaj me prejardhje kosovare (1969 - 2011) për vlerë reprezentative është marrë vlera mesatare e shtimit natyror prej 153.978 fëmijëve të lindur jashtë Kosovës, ky numër është rritë dhe vlerësohet në rreth 704.000 banorë. Mirëpo, ky numër është akoma më i madh kur i shtohet edhe numri i të emigruarve nga vala e fundit (2014 - 2015). Bazuar në të dhënat nga regjistrimi i popullsisë 2011, mbi 35% të të gjithë popullsisë kosovare kishte emigruar në Gjermani, në Zvicër me rreth 23% dhe në Itali me mbi 7%. Derisa, në vendet të tjerë si: Kanada, Australi si dhe vendet tjera përbënin mbi 10% të popullsisë emigruese kosovare. Nga raporti gjinor i popullsisë kosovare që kishte emigruar ishte: 56.67% meshkuj dhe 43.33 % femra. Emigrimi më i hershëm karakterizohej me dominim të gjinisë mashkullore (i fuqisë punëtore për të kaluar viteve të fundit në dominim nga femrat për shkak të martesave të shumta). Në emigrim është e përfshirë kryesisht mosha e re e popullsisë, si moshë kryesore riprodhuese në aspektin e fertilitetit dhe të fuqisë punëtore, e përfaqësuar nga Grup-mosha 25-44 vjeç dhe përbën 47.2% të popullsisë emigruese, me dominim Grup-moshe 30-34 vjeç me 12.7% brenda saj (ASK, 2014).

Në raport me popullsinë rezidente, numrin më të madh të popullsisë së emigruar e kanë komuna e Suharekës me rreth 47% dhe komuna e Prishtinës me rreth 15% të popullsisë që jeton jashtë vendit. Ndërsa, me numrin më të madh të popullsisë që ka migruar prijnë komunat Prishtinë, Gjakovë Mitrovicë dhe Suharekë, përderisa me numrin më të vogël të emigrimit (nën 10%) janë komunat e vogla Ranillug, Partesh dhe Mamushë.

[6] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): *Migrimi kosovar* , Prishtinë 2014



Harta. 2. Harta e migrimeve sipas komunave të Kosovës. Burimi: ASK 2014[7].

Konkluzione: Bazuar në analizën e të dhënave, del se Kosova është vend emigrator me mbi 30% të popullsisë së përgjithshme që jeton jashtë vendit.

- Analiza e të dhënave dhe teoritë e migrimeve, tregojnë se, popullsia që emigron është kryesisht nga vendet më pak të zhvilluara në drejtim të atyre të zhvilluara, gjithnjë në kërkim të një jete më të mirë, siç është edhe rasti me Kosovën.
- Migrimi ndërkombëtar në Kosovë, ka atakuar të dy gjinitë dhe më së shumti grup-moshën e re të popullsisë.
- Ndër komunat me numrin më të madh të emigruarave bëjnë pjesë: Suhareka, Mitrovica, Klina dhe Gjakova. Andaj, në këtë kontekst, duhet bërë edhe më shumë analiza hapësinore brenda njësive territoriale, për të gjetur shkaqet e emigracionit në këto komuna dhe për të ndërmarr veprime konkrete në parandalimin e migrimit të mëtejmë, që për pasojë do të ketë zbrazjen e vendbanimeve (në veçanti atyre rurale) dhe debalancimin e strukturave demografike në vend. Kësisoj, vijnë në shprehje zhvillime të pa balancuara hapësinore dhe me efekte popullative afatgjata.

[7] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): *Migrimi kosovar* , Prishtinë 2014

Treguesi:	**RAPORTI NË MES POPULLSISË URBANE DHE RURALE**
Synimi:	ZHVILLIM I BALANCUAR I PARTNERITETIT URBAN - RURAL
Objektivi:	NGRITJA E SHKALLËS SË URBANIZIMIT NË KOSOVË.

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet numrin ose % në mes së popullsisë që jeton në vendbanimet urbane dhe atyre rurale në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë për territorin e caktuar (Kosovë / Komunë). Për përcaktimin urban apo rural të një vendbanimi, përdoren kritere të ndryshme.




Fig. 1. – Harta e popullsisë urbane nëpër komunat e Kosovës. Burimi: ASK 2013

Mënyra e matjes së treguesit: Për të llogaritë përqindjen (%) e popullsisë urbane në raport me atë rurale, fillimisht duhet përcaktuar shkallën e urbanizimit të vendbanimit ose të njësisë territoriale, që varet nga kriteret për: dendësinë e popullsisë, të zhvillimit të veprimtarive ekonomike dhe të shërbimeve që ofrohen në të. Sipas prof. I. Ramadani, vendbanim urban është vendbanimi që ka minimum 2.000 banorë dhe ku 1/3 e të punësuarve punon në veprimtaritë terciare[8]. Kurse, nga Eurostat-i janë përcaktuar këto kriteret e për ndarjen e vendbanimeve në:
a) vendbanim rural (fshat), - që ka dendësi të popullsisë deri në 100 b/km² apo kur më shumë se 50% e popullsisë jeton në fshat dhe merret me veprimtari bujqësore,
b) vendbanim periferik (para-lagje), - që ka dendësi të popullsisë prej 100-300 b/km² ose së paku 5.000 banorë, dhe c) vendbanim urban (qytet), - që ka dendësi të popullsisë prej 1.500 b/km² dhe së paku me popullsi prej 50.000 banorë[9].

Burimi informatës/ave: Burim i të dhënave më të sigurta, për popullsinë, dendësinë si dhe për klasifikimin e saj, sipas zonave përkatëse të para-përcaktuara, në popullsi urbane dhe rurale, është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Kufizimet për matjen e treguesit: Në Kosovë, organizimi territorial nuk ka qenë i definuar saktë dhe si i tillë ka pësuar ndryshime gjatë periudhave kohore, përderisa tani përcaktimi i vendbanimeve urbane realizohet në bazë të vendimeve administrative nga komunat përkatëse[10]. Territorin e

[8] Ramadani I, "Planifikimi Hapësinor dhe Urban", Prishtinë 2013.
[9] http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Revision_of_the_degree_of_urbanisation
[10] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): *Atllasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011*, Prishtinë 2013.

Republikës së Kosovës, deri në vitin 1999 e përbënin 30 komuna, përderisa nga viti 2008 ishin 37 me 1467 vendbanime (shih fig. 2) dhe tani me shtimin e komunës Mitrovica e Veriut, në vitin 2015 janë 38 komuna me 1468 vendbanime.

Meqë nuk kishte koncepte të qarta të përdorura gjatë regjistrimit të popullsisë dhe se numër i konsiderueshëm i popullsisë që jetonin në vendbanimet urbane ishin regjistruar si banor të vendbanimeve rurale, këto vlera nuk janë edhe aq reale, me çka rritet dyshimi dhe zvogëlohet diferenca në raportin e popullsisë urbane – rurale në Kosovë.

Fig. 2. Tabela me të dhëna statistikore sipas komunave në Kosovë. Burimi: ASK 2013.

Kodi komunës Municipal code	Emri i komunës Name of municipality	Banorë Inhabitants	Siperfaqja në km² Area in km²	Dendësia Density	Popullsi urbane Urban population	Popullsi rurale Rural population	Numri i vendbanimeve Number of settlements
01	Deçan	40019	294	136,1	3 803	36 216	37
02	Gjakovë	94556	587	161,1	40 827	53 729	88
03	Gllogoc	58531	276	212,1	6 143	52 388	35
04	Gjilan	90178	392	230,0	54 239	35 939	49
05	Dragash	33997	434	78,3	1 098	32 899	36
06	Istog	39289	454	86,5	5 115	34 174	50
07	Kaçanik	33409	211	158,3	10 393	23 016	31
08	Klinë	38496	309	124,6	5 908	32 588	54
09	Fushë Kosovë	34827	84	414,6	18 515	16 312	16
10	Kamenicë	36085	417	86,5	7 331	28 754	58
11	Mitrovicë	84235	336	250,7	58 458	25 777	47
12	Leposaviq	13773	539	25,6	5 505	8 268	75
13	Lipjan	57605	338	170,4	6 870	50 735	62
14	Novobërdë	6729	204	33,0	0	6 729	26
15	Obiliq	21549	105	205,2	6 864	14 685	20
16	Rahovec	56208	276	203,7	15 892	40 316	36
17	Pejë	96450	603	160,0	48 962	47 488	79
18	Podujevë	88499	633	139,8	23 453	65 046	77
19	Prishtinë	198897	523	380,3	161 751	37 146	43
20	Prizren	177781	627	283,5	94 517	83 264	76
21	Skenderaj	50858	374	136,0	6 612	44 246	49
22	Shtime	27324	134	203,9	7 255	20 069	23
23	Shtërpcë	6949	248	28,0	1 265	5 684	16
24	Suharekë	59722	361	165,4	10 422	49 300	41
25	Ferizaj	108610	345	314,8	42 628	65 982	45
26	Viti	46987	270	174,0	4 924	42 063	39
27	Vushtrri	69870	345	202,5	27 272	42 598	67
28	Zubin Potok	6616	334	19,8	1 724	4 895	61
29	Zveçan	7481	123	60,8	1 297	6 184	35
30	Malishevë	54613	306	178,5	3 395	51 218	44
31	Junik	6084	78	78,0	0	6 084	3
32	Mamushë	5507	11	500,6	0	5 507	1
33	Hani i Elezit	9403	83	113,3	0	9 403	11
34	Graçanicë	10675	122	87,5	0	10 675	17
35	Ranillugë	3866	78	49,6	0	3 866	13
36	Partesh	1787	29	61,6	0	1 787	3
37	Klokot	2556	23	111,1	0	2 556	4
	Kosovë	1780021	10906	163,2	682 438	1 097 586	1467

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Treguesi i raportit të popullsisë urbane ndaj popullsisë përgjithshme është shumë i rëndësishëm dhe se duhet të analizohet me kujdes gjatë hartimit të planeve hapësinore, zhvillimore e sidomos atyre rregulluese të hollësishme për vendbanimet urbane. Analiza e mirëfilltë e këtij treguesi na parapërgatit për një shfrytëzim sa ma racional të mjedisit jetësor ku pritet të strehohen dhe të veprojnë një numër i madh i banorëve në një sipërfaqe të vogël. Aty, pra duhet gjetur zgjidhje që ofrojnë kushte më të mira dhe hapësira më

komode për kapacitetet e nevojshme të banimit, punës (ekonomike, administrative, tregtare, etj), infrastrukturës dhe të shërbimeve arsimore, shëndetësore, kulturore, shoqërore dhe rekreative.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Sipas Regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë në Kosovë, të realizuar në vitin 2011, del se 682.438 banorë që përbëjnë 38 % të popullsisë së përgjithshme janë popullsi që jetojnë në zonat urbane, ndërsa 1.097.586 banorë apo 62 % janë popullsi që jetojnë në zonat rurale (shih fig. 3). Gjithashtu, nga tabela në fig. 2, mund të shihet sipërfaqja, numri i vendbanimeve si dhe numri i popullsisë përgjithshme dhe asaj urbane e rurale për secilën komunë, prej nga edhe nxirren raporte të ndryshme për popullsinë urbane, duke filluar nga më e ulëta prej 3.2 % në Komunën e Dragashit e deri tek më e larta prej 81.3 % në Komunën e Prishtinës.

Regjistrimi popullsisë 2011	Nr. Popullsisë urbane	% e Popullsisë urbane	Nr. Popullsisë rurale	% e Popullsisë rurale
Republika e Kosovës	682.438	38	1.097.586	62
Qendrat tjera komunale	180.872	10	795.749	45
7 Qendrat Regjionale	501.566	28	301.837	17
Prishtina	161.751	81.32	37.146	18.67
Prizreni	94.517	56.13	83.264	46.83
Mitrovica	58.458	69.39	25.777	30.60
Gjilani	54.423	60.35	35.939	39.85
Peja	48.962	50.76	47.488	49.23
Ferizaji	42.628	39.24	65.982	60.75
Gjakova	40.827	43.17	53.729	58.62

Fig. 3. Tabela me raportet e popullsisë urbane e rurale në Kosovë dhe qendrat regjionale. Burimi: IPH me të dhëna të ASK.

Nga analiza për numrin e përgjithshëm, përqindjet dhe raportet mes popullsisë urbane dhe rurale në Kosovë (shih tabelën e fig. 3), vërehet se: të shtatë qendrat më të mëdha urbane të Kosovës (përndryshe 7 qendrat regjionale sipas PHK-së të aprovuar më 2011), Prishtina, Prizreni, Peja, Mitrovica, Gjilani, Ferizaj dhe Gjakova, që janë qytete qysh nga vitet e 40-ta të shekullit të kaluar, kanë numër më të lartë të popullsisë urbane. Këto 7 qendra urbane, me gjithsejtë 501.566 banorë, përbëjnë 28 % të popullsisë së përgjithshme urbane të vendit, ndërsa pjesa tjetër prej 10 % ose 301.837 banorë, përbënë popullsinë urbane prej të gjitha qendrave urbane të komunave tjera. Në ndërkohë, vetëm në kryeqendrën e Kosovës - Prishtinë, jetojnë rreth 9.5 % e popullsisë së përgjithshme urbane, vlerë kjo e cila përbënë gati 90 % të popullsisë urbane që jetojnë në 23 qendrat urbane të komunave tjera, të cilat nuk janë qendra regjionale.

Kurse, krahasimi i vlerës së raportit urban / rural prej 38/62 % në favor të popullsisë rurale, me vlerat e raporteve të vendeve tjerë të rajonit në vitin 2005 (shih fig. 4), tregon për nivelin më të ulët të popullsisë urbane në raport me atë rurale në Kosovë.




Fig. 2. Grafiku për raportin e popullsisë urbane – rurale në vendet e rajonit.

Konkluzione:

- Regjistrimi i fundit në Kosovë më 2011, tregon për zvogëlim (nga 40/60 % në 38/62 %) dhe de-balancim të raportit urban / rural si dhe mungesë të urbanizimit të vendbanimeve;
- Rritja e numrit të komuna, sidomos atyre me qendra komunale që i përkasin vendbanimeve rurale (ose që nuk i plotësojnë kriteret për të qenë vendbanime urbane), kanë shkaktuar edhe ndryshime tjera në strukturën e komunave fqinje, duke ia zvogëluar sipërfaqen e territorit në një anë dhe në anën tjetër duke ia shtuar dendësinë e popullsisë, përfshirë edhe % e popullsisë urbane;
- Urbanizimi assesi nuk mund të kufizohet vetëm në rritjen e numrit të popullsisë së qyteteve, por ai është një proces kompleks, i cili, përveç rritjes demografike të qyteteve, para së gjithash nga komponenti imigrues, nënkupton edhe transformimin e përbërjes sociale-ekonomike të popullsisë dhe të mënyrës së jetesës në përgjithësi;
- Është e nevojshme që të gjitha pjesët e qendrave komunale të pa-urbanizuara, sub-qendrat e përcaktuara me PZhK-të përkatëse si dhe vendbanimet tjera (të mëdha e të mesme rurale) nëpër komuna të kompaktësohen (me dendësim më të madh të popullsisë) e të urbanizohen;
- Për shkak të territorit të vogël të vendit dhe me qëllim të ruajtjes së tokës bujqësore duhet të krijohen dhe zbatohen politika të orientuara drejt zhvillimit më të koncentruar dhe kompakt të vendbanimeve përkundër trendit apo të vendbanimeve (lagjeve) të shpërndara;

Treguesi:	**SHKALLA E PAPUNËSISË**
Synimi:	ZHVILLIM I KOHEZIONIT SOCIO-EKONOMIK NË KOSOVË.
Objektivi:	NGRITJA E NIVELIT TË PUNËSIMIT DHE RRITJA E ZHVILLIMIT TË BALANCUAR.

Përshkrimi i treguesit: Shkalla e papunësisë paraqet raportin e të papunësuarve (në numër ose përqindje) në kuadër të kapacitetit të përgjithshëm të fuqisë punëtore aktive në nivel vendi ose të një territori të caktuar brenda një vendi apo në tërë. Pra, ky indikator socio-ekonomik tregon nivelin e fuqisë punëtore të pashfrytëzuar në proceset ekonomike në tërë territorin e Kosovës.




Fig 1. – Harta e papunësisë nëpër komunat e Kosovës. Burimi: ASK 2013[11].


Mënyra e matjes së treguesit: Për të llogaritë përqindjen (%) e popullsisë së papunësuar, së pari duhet të nxirret numri e me të edhe raporti i popullsisë së aftë dhe të gatshme për punë, në kuadër të popullsisë aktive për punë. Më pas, nga ai numër i përgjithshëm i kësaj kategorie të popullsisë zbritet numri i popullsisë së punësuar dhe në këtë mënyrë gjendet edhe shkalla e papunësisë, si raport i ndryshimit të atyre vlerave, në këtë rast sipas komunave në Kosovë.

Burimi informatës/ave: Burimi i të dhënave më të sigurta dhe zyrtare, për popullsinë dhe strukturën e përgjithshme ekonomike të saj në Kosovë, sipas zonave përkatëse të parapërcaktuara për moshën aktive dhe jo aktive, është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Kufizimet për matjen e treguesit: Standardet ndërkombëtare identifikojnë dy ndarje të popullsisë "ekonomikisht aktive": popullsia aktive ''e zakonshme'', e matur në lidhje me një periudhë të gjatë reference si ajo vjetore, dhe popullsia aktive ''aktuale'' që matet në lidhje me një periudhë më të shkurtër reference si javore apo ditore, në bazë të të cilave kufizohemi në gjetjen e shkallës së papunësisë, duke e zbritur me numrin e përgjithshëm të të punësuarve[12]. Këto vlera të papunësisë së Republikës së Kosovës këto matje nuk mund të jenë edhe aq reale, meqë nuk kishe koncepte të

[11]Agjencia e Statistikave e Kosoves (ASK), Atllasi i Regjistrimit të Popullsisë 2011, Prishtinë 2013.
[12] INSTAT, ''Njerëzit dhe Puna në Shqipëri'' faqe 28, Tiranë 2004.

qarta të për regjistrimin e përgjithshëm të shkallës së papunësisë dhe se këto rezultate janë të bazuara në të dhënat e mbledhura nga anketat.



Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)	Meshkuj	Femra	Totali
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	61.8	21.4	41.6
Shkalla e joaktivitetit	38.2	78.6	58.4
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit)	41.3	12.5	26.9
Shkalla e papunësisë	33.1	41.6	35.3
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	56.2	71.7	61.0
Përqindja e të rinjëve NEET në popullsinë e të rinjve (15-24 vjeç)	26.6	34.0	30.2
Përqindja e punësimit të paqëndrueshëm ndaj punësimit të përgjithshëm	26.7	18.9	24.9

Fig. 2. Skema e klasifikimit tregut të punës për popullsinë e Kosovës. Burimi: Rezultati AFP-së më 2014[13].

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Treguesi i raportit të papunësisë ndaj popullsi së përgjithshme është shumë i rëndësishëm dhe se duhet të analizohet me kujdes gjatë hartimit të planeve zhvillimore-ekonomike të një rajoni. Analiza e mirëfilltë e këtij treguesi na parapërgatitë për një shfrytëzim sa më racional të popullsisë aktive. Pra, duhet gjetur zgjidhje që ofrojnë hapjen e vendeve të reja të punës dhe njëkohësisht zbritjen e shkallës së papunësisë dhe rritjen e zhvillimit rajonal (ekonomik, administrativ, tregtar, etj) dhe të infrastrukturës e shërbimeve adekuate për investitorët.




Fig. 3. Paraqitja grafike e nivelit të papunësisë së Kosovë me vendet e rajonit. Burimi: Anketimet e Fuqisë Punëtore (AFP apo LFS) të Zyrave Kombëtare të Statistikave.

htinë, Qershor 2014 (Shënim: Të dhënat për Kosovën për vitin 2010 nuk janë në dispozicion).

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Sipas anketimit të fuqisë punëtore më 2014, nga numri i përgjithshëm i popullsisë aktive del se shkallën e papunësisë në Kosovë, e përbëjnë rreth 35,5 % të papunësuar. Ndërsa Kosova në krahasim me vendet e rajonit të Evropës Juglindore por edhe më tej ka nivelin papunësinë më të lartë ndër vite.

Konkluzione:

- Të dhënat e fundit nga regjistrimi i popullsisë tregojnë se nga 1.252.248 banorë të Kosovës që janë mbi 15 vjeç, 508.100 e tyre përbëjnë fuqinë punëtore në Kosovë. Nga ta, 280.454 persona janë të punësuar kurse 227.464 persona të tjerë konsiderohen të pa punë.
- Shkalla e papunësisë assesi nuk mund të kufizohet vetëm me rritjen e numrit të popullsisë së përgjithshme, sepse ky është një tregues shumë kompleks, i cili, përveç rritjes demografike të popullsisë, nënkupton edhe transformimin e përbërjes sociale-ekonomike të popullsisë dhe të mënyrës së jetesës në përgjithësi;
- Është e nevojshme që të gjitha qendrat komunale të paraqesin të dhënat e përgjithshme të popullsisë, para së gjithash numrin e të papunësuarve;
- Për shkak të territorit të vogël të vendit dhe me qëllim të zhvillimit ekonomik, ku kemi një numri të vogël të popullsisë është e domosdoshme të krijohen vende pune, të cilat do të arrinin vetëm me anë të zhvillimit të hapësirës dhe prodhimit ekonomik vendor.

Treguesi:	**BRUTO PRODUKTI VENDOR (BPV) PËR KOKË BANORI** (Eurostat code: tsdec100)
Synimi:	ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE I BALANCUAR EKONOMIK
Objektivi:	RRITJA EKONOMIKE PËR PËRMIRËSIMIN E STANDARDIT JETËSOR

Përshkrimi i treguesit: Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori është tregues më i rëndësishëm makroekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare, i cili paraqet performancën e ekonomisë së një shteti për një periudhë të caktuar kohore duke e krahasuar me periudhën paraprake (me vitin paraprak) dhe vendet tjera kurse në aspektin social përdoret për të vlerësuar gjendjen e standardit jetësor të banorëve.

Mënyra e matjes së treguesit: BPV për kokë banori (€/b) llogaritet në bazë të vlerës reale të bruto produktit të një vendi (BPV) duke e pjesëtuar me numrin e banorëve të atij vendi. BPV llogaritet në bazë të parimeve metodologjike të Sistemit Evropian të Llogarive "European System of Accounts" - ESA 2010 dhe " System of National Accounts" - SNA 2008.[14]

Burimi informatës/ave: Burim i informatave për këtë indikatorë është Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Institucionet financiare (BQK) dhe Institucionet Qeveritare.

Kufizimet për matjen e treguesit: BPV / kokë banori në të shumtën e rasteve klasifikohet si indikator indirekt për të vlerësuar standardin e jetës, pasi që BPV reale në kalkulim nuk i merr parasysh shpenzimet (sociale) private të shoqërisë dhe shpenzimet që shkaktohen në mjedis si pasojë e aktiviteteve ekonomike. Për shkak të hulumtimeve dhe analizave nga institucione të ndryshme për këtë tregues jepen edhe vlera të ndryshme.




Fig.1. Grafikoni i rangimit të Kosovës në indeksin e zhvillimit të BB. Burimi: MTI, Strategjia e Zhvillimit Sektorit Privat 2013-2017.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori, është tregues i rëndësishëm që ndihmon procesin e zhvillimit hapësinor. Vendet me BPV shumë më të lartë kanë potencial më të madh për të planifikuar zhvillimet e ardhshme dhe për të krijuar ekonomi më funksionale. Planifikimi ekonomik bëhet në bazë të rezultateve dhe trendit zhvillimor të llogarive kombëtare.

Sipas vlerësimit të Bankës Botërore të vitit 2012, Kosova synon të radhitet në grupin e shteteve me "të ardhura të sipërme të mesme" deri në vitin 2020, ndërsa deri më 2030 – ajo synon grupin e shteteve me "të ardhura të larta".[15]

14 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimeve (2008-2013), Prishtinë ,Shtator 2014.
[15]Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë: Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, Prishtinë Mars 2013.




Fig.2. Vlerat e BPV-së për kokë banori në vendet e rajonit në vitin 2012. Burimi: IPH me të dhënat nga RIINVEST 2014.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Sipas Bankës Botërore, vlerësim i vitit 2012 (fig. 1), Kosova bën pjesë në grupin e shteteve me të ardhura të ulëta të mesme të selektuara në rajonin "Evropë dhe Azi Qendrore"[16]. Kurse, sipas raportit të publikuar nga Instituti RIINVEST (2014)[17], bazuar në të dhëna të Bankës Botërore (2012), gjendja e Bruto Produktit Vendor (BPV) për kokë banori me vlerë më e lartë në rajon (fig. 2) është regjistruar në Malin e Zi (5,275 €) e ndjekur nga Serbia (3,930 €), Maqedonia (3,545 €), Bosnja dhe Hercegovina (3,429 €), Shqipëria (3,091 €) dhe e fundit është Kosova me BPV-në për kokë banori më të ulët (2,708 €).




Fig.3. Grafiku i paraqitjes së BPV/kokë banori në Kosovë 2008-2013. Burimi: ASK, BPV në qasjen e shpenzimeve (2008- 2013).

Gjatë viteve 2008-2013, BPV në Kosovë është rritur në vlerën prej 3,882.8 milion euro në 5,326.6 milion euro ndërsa BPV për kokë banori (fig. 3) është rritur prej 2,258 euro (në vitin 2008) deri në 2,935 euro (në vitin 2013). Rritja reale e BPV për vitin 2013 vlerësohet të jetë rritur me një normë prej 3.4%.[18]

Konkluzione:

- Performanca ekonomike e Kosovës nuk është në nivel të kënaqshëm dhe në krahasim me vendet tjera ajo radhitet e fundit me BPV-në për kokë banori prej 2.935 € është më e ultë në rajon dhe Evropë.
- Sipas ASK-së vlera e BPV-së dhe BPV-së për kokë banori është në rritje (ngritja e BPV është mesatarisht 250 mijë euro gjatë një viti), por nuk është e mjaftueshme që të ndryshoj gjendjen sociale në Kosovë, të ndikoj në uljen e papunësisë dhe uljen e varfërisë.
- Procesi i zhvillimit ekonomik në Kosovë është shumë i ngadalshëm si pasojë e moszbatimit të ligjit, evazionit fiskal, kontrabandës ekonomike, të mungesës së: një strategjie të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik, politikave efikase ekonomike, sektorit prodhues, përkrahjes shtetërore të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe të rënies së investimeve të reja nga investitorët e vendit dhe të huaj.
- Si rezultat i shkallës së ultë të rritjes ekonomike, Kosova nuk arrin të krijoj një zhvillim të balancuar socio- ekonomik, si dhe të përmirësoj standardin jetësor, për të krijuar të ardhura më të larta dhe për të ofruar qasje në konsumin e mallrave dhe të shërbimeve cilësore arsimore e shëndetësore.

[16] Ministria e Tregtisë dhe Industrisë: Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, Prishtinë Mars 2013.
[17] INSTITUTI RIINVEST/ Raporti: Klima e Biznesit në Kosovë – Një Perspektivë Ndër-Rajonale,Prishtinë 2014.
[18] Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimeve (2008-2013), Prishtinë, Shtator 2014.

Treguesi .	**PJESËMARRJA E SEKTORËVE NË BPV**
Synimi	ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE I BALANCUAR EKONOMIK
Objektivi	BALANCIM I ZHVILLIMEVE PËR PËRMIRËSIMIN E KUALITETIT TË JETËS

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet hisen e pjesëmarrjes së sektorëve të bujqësisë, industrisë dhe të shërbimeve si përfaqësuesit (komponentë) kryesor në krijimin e të ardhurave në kuadër të Bruto Produkti Vendor (BPV), i cili është treguesi më i rëndësishëm ekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare për paraqitjen ekonomisë së një shteti në një periudhë të caktuar.

Mënyra e matjes së treguesit: Ky indikator shprehet në përqindje të pjesëmarrjes të tri komponentëve kryesor në BPV për periudha të caktuara kohore dhe të krahasueshme me shtete tjera në botë.

Burimi i informatës/ave: Burimi referues për këtë tregues është Agjencia për Statistika e Kosovës (ASK 2015), me ndihmën e Zhvillimit të Indikatorëve Botëror (World Development Indicators, 2011) dhe të parimeve metodologjike të Sistemit Evropian dhe Sistemit Kombëtar të Llogarive ("European System of Accounts" - ESA 2010 & "System of National Accounts" - SNA 2008)[19].

Kufizimet për matjen e treguesit: Kufizimet, që konsistojnë për këtë tregues, janë në:

VENDI	BUJQËSIA	INDUSTRIA	SHËRBIMET
Shqipëria	18.50%	24.70%	56.6%
Kosova	20.00%	20.00%	60.00%
Mali I Zi	0.80%	11.30%	87.90%
Maqedonia	10.20%	27.50%	62.3%
Serbia	7.90%	31.80%	60.30%
Bota	5.90%	30.50%	63.60%
SHBA	1.12%	19.10%	79.70%
Kina	9.10%	42.60%	48.30%
Japonia	1.20%	27.50%	71.40%
Gjermania	0.80%	28.10%	71.10%
Franca	1.90%	18.30%	79.80%

Fig.1. Pjesëmarrja e sektorëve ekonomik në BPV – Bujqësi, Industri dhe Shërbime në shtetet e rajonit. Burimi:ESK 2015

a) Konceptin e pranuar dhe të krahasimit të referuar në botë, në tre sektorët e pjesëmarrjes në BPV, pa të dhëna të veçanta për sektorët turizëm dhe tregti por duke e nënkuptuar përfshirjen e tyre në grupin e shërbimeve (tabela në fig. 1);

b) Ndarjen dhe paraqitjen e vlerave të përqindjes sipas sektorëve pjesëmarrës me 20/20/60 % në BPV (fig. 1), kur e njëjta % vazhdon të jetë ndër vite, nënkuptohet si vlerë e përafërt e prezantuar;

c) Nivelin e përgjithshëm të kapaciteteve për të dhënat statistikore, që, sipas Bankës Botërore, është shumë i ulët në Kosovë, (graiku në fig. 2).




Fig.2. Grafiku për nivelin e statistikave në Kosovë. Burimi: http://data.worldbank.org/country/kosovo

19 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), *Bruto Produkti Vendor në Qasjen e Shpenzimeve (2008-2013)*, Prishtinë 2014.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Treguesit për BPV-së, BPV / kokë banori si dhe i % së pjesëmarrjes së sektorëve shfrytëzohen për të siguruar matjen, vlerësimin dhe krahasimin e pasurisë së prodhuar të një shteti sipas sektorëve kryesor ekonomik si dhe për të bërë analiza të shumta gjatë krahasimit të zhvillimeve në periudha të ndryshme kohore përbrenda vendit si dhe mes shtetesh të Rajonit, Evropës dhe Botës




Fig. 3. Grafiku i krahasimit të BPV / kokë banori mes shteteve të rajonit. Burimi: IPH sipas të dhënave nga RIINVEST 2014.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Paraqitja e nivelit të gjendjes aktuale të zhvillimit dhe e trendit për brenda Kosovës, vazhdon të jetë e njëjta për shumë vite. Kurse, sipas të dhënave të Bankës Botërore, në vitin 2011 BPV ishte rreth 4.2 miliard $, përderisa në vitin 2014 ishte ngritur në rreth 7.2 mld $. Kurse BPV / për kokë banori që në vitin 2010 ishte 1.847 $ në vitin 2014 kishte ngritje në 3.815 USD. Ndërsa, krahasimi i vlerës për BPV/banorë në mes shteteve të rajonit vërehet më së miri në grafikun e fig.3.

Konkluzione:

- Ky indikator duhet të paraqet të ardhurat për kokë banori në vend dhe se cili nga sektorët ekonomik dhe me çfarë përqindje merr pjesë në ato të ardhura!
- Nuk mjafton që me këtë tregues të përcaktohet niveli zhvillimor komunal apo në bazë të vlerës së tij të krahasohet se cila komunë ose cili rajon është më i zhvilluar se tjetri, por as të mirëqenies ekonomike e të amvisërive. Kurse, me ndihmën e indikatorëve tjerë, përmbushet dhe plotësohet edhe më tej fotografia e zhvillimit njerëzor si dhe të atij ekonomik të vendit.
- BPV/kb apo edhe BPV e ndarë në sektorë, nuk paraqesin me automatizëm mirëqenien e amvisërive lokale, me zhvillimin (ngritjen apo rënien) e saj, por pasqyrojnë vetëm transkakcione shtetërore (të paraqitura dhe të arkivuara) si në rastin tonë të përafërta dhe me vlera të njëjta ndër vite (Bujqësi / Industri / Shërbime : 20 / 20 / 60 %)!

Treguesi:	**VLERA E EKSPORT - IMPORTIT DHE E BILANCI TREGTAR**
Synimi:	ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE I BALANCUAR EKONOMIK
Objektivi:	ZHVILLIM I BALANCUAR EKONOMIK PËR PËRMIRËSIMIN E KUALITETIT TË JETËS

Përshkrimi i treguesit: Këta tregues mbulojnë Eksport – Importin sipas viteve dhe paraqesin tregtinë e mallrave e të shërbime dhe parashikimet tregtare në varësi të madhësisë së biznesit. Këto të dhëna tregojnë shkëmbimin ndërmjet rezidentëve dhe jo-rezidentëve në një ekonomi, vlerën e tyre të shtuar në proces të prodhimit.

Vitet	Eksport		Importi		Bilanci tregtar	Mbulimi i imp. me eks në %
	Vlera	Rritja e eksportit në %	Vlera	Rritja e importit në %		
2002	27,599	0.0	854,758	0.0	-827,159	3.2
2003	35,621	29.1	973,265	13.9	-937,644	3.7
2004	56,567	58.8	1,063,347	9.3	-1,006,780	5.3
2005	56,283	-0.5	1,157,492	8.9	-1,101,209	4.9
2006	110,774	96.8	1,305,879	12.8	-1,195,105	8.5
2007	165,112	49.1	1,576,186	20.7	-1,411,074	10.5
2008	198,463	20.2	1,928,236	22.3	-1,729,773	10.3
2009	165,328	-16.7	1,935,541	0.4	-1,770,213	8.5
2010	295,957	79.0	2,157,725	11.5	-1,861,768	13.7
2011	319,165	7.8	2,492,348	15.5	-2,173,183	12.8
2012	276,100	-13.5	2,507,609	0.6	-2,231,509	11.0
2013	293,842	6.4	2,449,064	-2.3	-2,155,222	12.0
Ritja mesatare		26.4	Ritja mesatare	9.5		

Fig. 1. Tabela me vlerat e Eksport-Importit përgjithshëm, rritja, bilanci tregtar dhe mbulimi importit nga eksporti për vitet 2002 - 2013. Burimi: ASK 2014.

Mënyra e matjes së treguesit: Me indeksin e çmimeve të Export - Importit paraqiten ndryshimet në transaksionet e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve ndërmjet banorëve të një shteti dhe botës për rreth. Përderisa, çmimet ndryshojnë me hapa të ndryshëm, merret mesatarja e tyre, e cila paraqet "Indeksin e çmimit". Të dhënat, për importet dhe eksportet, janë treguar në drejtim të rritjes vjetore dhe të përqindjes së pjesëmarrjes në BPV, të paraqitur në rritje vjetore dhe % të BPV-së, madhësisë së biznesit si dhe rritjen e tregut të eksportit në USD ($).

Burimi i informatës/ave: për këta tregues janë Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK 2015) dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë / Departamenti Industrisë (MTI / DI: Raporti Vjetor i Zhvillimit Industrial në Kosovë për vitin 2013).

Kufizimet për matjen e treguesit: Atëherë, këtu limitimet konsistojnë në konceptin e pranuar dhe të krahasueshëm në botë, në atë të indeksit të çmimeve si një tregues (indikator) i përgjithshëm makro-ekonomik, e jo të treguesit të veçantë për gjendjen reale të mirëqenies ekonomike të qytetarëve apo edhe të mundësive për investime.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Oda Ekonomike e Kosovës thekson se: "Bilanci tregtar, përkatësisht raporti në mes të importit dhe eksportit, janë treguesit më realë të situatës aktuale të ekonomisë së vendit" (OEK, 2015). Kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë shfaq edhe mundësinë ekonomike për investime dhe zhvillime hapësinore, pra mundësinë për investime të limituara ose të varura tërësisht nga ekonomia e vendit.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Nga analiza e të dhënave për periudhë 2009-2013, vërehet se bilanci negativ tregtar i Kosovës, ka shënuar rritje prej 2,231.509 milion Euro në vitin 2012, përderisa gjate vitit 2013, ka pësuar rënie prej 76.287 milion Euro. Po ashtu, referuar vlerave të rritjes mesatare, e shënuar prej disa viteve, tregon se përqindja e rritjes së eksportit është më e lartë përkundër rritjes së importeve, kurse mbulimi i vlerës së importeve me vlerën e eksporteve në % (përqindje), vazhdon ende të jetë shumë i vogël, duke arritur vlerën më të madhe të mbulimit në vitin 2010 prej 13.7%.




Fig. 2: Grafiku për vlerat e Eksport- Importit të përgjithshëm, rritjes dhe mbulimit të importit me eksport (në %) për vitet 2002-2013. Burimi MTI 2014[20].




Fig 3: Grafiku i paraqitjes së importeve nga vendet e CEFTA-s, sipas produkteve industriale në %. Burimi: MTI 2014.

Konkluzione:

- Ekziston ndërlidhje e fuqishme e Kosovës me shtetet e rajonit, e cila në kontekst të importit të artikujve të prodhimeve industriale më së shumti vjen në pah me Serbinë dhe Maqedoninë, gati në të gjithë artikujt metalike, kimike, plastike dhe të gomës, letrës dhe tekstilit, përveç importit të prodhimeve të industrisë së drurit që vjen nga Mali i Zi.
- Kosova vazhdon të ketë deficit të lartë në bilancin tregtar, ku dallimi në mes të shkallës së importit dhe eksportit vazhdon të jetë i thellë, meqë në masë të madhe importon prodhime industriale nga jashtë se sa që eksporton prodhime industriale vendore.
- Të dhënat e fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë për një situatë alarmante, ku eksporti mbulon importin me vetëm 10 % (dhjetë për qind), shifër kjo që mbetet shqetësuese për vendin dhe me trendë përkeqësimi, sipas njohësve të çështjeve ekonomike(OEK, 2015).

[20] MTI / DI, *Raporti Vjetor i Zhvillimit Industrial në Kosovë për vitin 2013, Prishtinë 2014.*

Treguesi:	**NUMRI I VIZITORËVE TË JASHTËM DHE VENDOR**
Synimi:	ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE I BALANCUAR EKONOMIK
Objektivi:	PROMOVIMI I TURIZMIT PËR NGRITJEN E NUMRIT TË VIZITORËVE

Përshkrimi i treguesit: Numri dhe përqindja (%) e vizitorëve vendor dhe të jashtëm është tregues statistikor i cili paraqet nivelin e zhvillimit të sektorit të turizmit në vend. Termi "vizitor" përfaqëson një "person" që udhëton dhe qëndron në një vend tjetër nga ai i vendbanimit të përhershëm, për një periudhë më pak se 12 muaj. Vizitorë vendor konsiderohen personat me vendbanim të përhershëm në Kosovë që udhëtojnë dhe qëndrojnë së paku një natë në një vend tjetër përbrenda saj. Kurse vizitorë të jashtëm janë personat me vendbanim të përhershëm jashtë Kosovës që vijnë dhe qëndrojnë përkohësisht ose së paku një natë në Kosovë.

Mënyra e matjes së treguesit: Matja e numrit të vizitorëve bazohet në llogaritjen e numrit të përgjithshëm të vizitorëve që janë regjistruar në: pikat hyrëse kufitare, aeroporte, zyrat e informimit turistik në komuna, apo edhe në bazë të statististkave dhe hulumtimeve më të hollësishme të kryera nga ekspertët e fushës. Aktualisht, të dhënat në dispozicion janë të bazuara në praktikat e deritanishme dhe programin statistikor të ASK-së dhe kryesisht merren me numrin e hoteleve, numrin e të punësuarve, kapacitetet e akomodimit (dhoma, shtretër), numrin e vizitorëve vendor dhe të jashtëm, me ndarjet e klasifikuara sipas muajve, vendit të prejardhjes dhe netëve të qëndrimit tyre në Kosovë.




Fig. 1. Numri i vizitorëve dhe bujtjeve sipas qendrave regjionale krahasuar më 2008 dhe 2014. Burimi: ASK 2015.

Burimi i informatës/ave: Në mungesë të mbledhjes dhe grumbullimit të dhënave për treguesin nga MTI/Divizioni i Turizmit, përmes zyrave të informacionit turistik, etj, janë shfrytëzuar të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës të përgatitura nga anketa e realizuar përmes pyetësorëve për statistika të turizmit në 105 objektet me kapacitete më të mëdha, që ushtrojnë veprimtari hoteliere, në territorin e Kosovës[21].

Kufizimet për matjen e treguesit: Këto kufizime konsistojnë në: Mungesën e të dhënave me vlera të sakta për treguesin, nga sektori i turizmit (DT në MTI), që kushtëzon shfrytëzimin e rezultateve të dala prej anketës së realizuar nga 7 (shtatë) zyrat rajonale statistikore (Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë dhe Ferizaj).që tregojnë vlera të përafërt për numrin e përgjithshëm të turistëve vendor dhe të huaj në Kosovë (fig.1) pa ndonjë klasifikim dhe pasqyrim tjetër të nevojshëm për zhvillim të turizmit.

Pra, nuk mund të mburremi me të dhëna të sakta e të besueshme, për numrin e përgjithshëm të vizitorëve, pikat më të vizituara dhe potencialet më atraktive turistike, marketingun dhe promovimin e vendeve dhe të llojeve të preferuara për turizëm, kapacitetet njerëzore të gatshme për hartim, monitorim, zbatim dhe vlerësim të strategjisë për zhvillimin e turizmit në Kosovë, etj.

[21] ASK: Statistikat e hotelerisë TM1, Prishtinë 2015.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Numri i vizitorëve vendor dhe të huaj ka rëndësi për planifikimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e turizmit në bazë të potencialeve dhe lokaliteteve turistike të Kosovës. Planifikimi hapësinor i rajoneve me vlera turistike, resurse të shumëta natyrore, kulturore dhe historike ka për qëllim rritjen e numrit të vizitorëve për të nxitur zhvillimin e sektorit të turizmit për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.




Fig. 2. Numri i vizitorëve (vendorë dhe të jashtëm) dhe i bujtjeve prej 2008 – 2014. Burimi: IPH sipas ASK 2015.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Numri i vizitorëve vendor, në vitin 2014 është rritur në raport me vitin 2013 për 2.42 %, ndërsa numri i bujtjeve (netë-qëndrimet) të tyre për 0.74%. Kurse, numri i vizitorëve të jashtëm, në vitin 2014 është rrit për 22.44%, përderisa numri i bujtjeve të tyre për 21.68 % në raport me vitin 2013 (fig. 2).

Ndërsa, numri më i madhi vizitorëve të jashtëm është nga Shqipëria, Gjermania, SHBA-ja, etj[22].
Regjionet më të vizituara gjatë vitit 2014 janë: regjioni i Prishtinës me 77.167 vizitor, Peja me 11.534 vizitor dhe Prizreni me 8.615 vizitor radhitet i treti[23].

Konkluzione:

- Numri i vizitorëve vendor dhe të jashtëm në Kosovë, krahasuar me vendet fqinje, nuk është në nivel të kënaqshëm karrshi resurseve ekzistuese për zhvillim të turizmit.
- Politikat qendrore dhe lokale të institucioneve relevante në Kosovë ende nuk e konsiderojnë turizmin si sektor me prioritet për zhvillim të qëndrueshëm të vendit.
- Mungesa e të dhënave nga MTI/DT, për gjendjen e turizmit në përgjithësi, përfshirë numrin e turistëve, llojin e turizmit si dhe destinacionet e preferuara të turistëve, e vështirësojnë procesin e planifikimit për zhvillimin e turizmit.
- Mungesa e strategjisë për zhvillim të turizmit në Kosovë rezulton me ngecje të shumta dhe sfiduese në identifikim të destinacioneve specifike turistike, menaxhim efikas të resurseve turistike, marketing dhe promovim të turizmit, pjesëmarrje të sektorit të turizmit në BPV si dhe në vendosje të parimeve për zhvillim të turizmit në tërë territorin Kosovës si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

[22] ASK: Statistikat e hotelerisë TM1, Prishtinë2015.
[23] ASK: Statistikat e hotelerisë TM1, Prishtinë 2015.

Treguesi:	**RAPORTI NË MES PRODHIMIT DHE KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**
Synimi:	ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS DHE KOMUNIKIMIT TË INTEGRUAR
Objektivi:	PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS DHE TË SHËRBIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues e jep sasinë e energjisë elektrike të prodhuar gjatë një viti të caktuar dhe sasinë e konsumuar të kësaj energjie gjatë të njëjtit vit në Republikën e Kosovës.

Mënyra e matjes së treguesit: Njësia matëse e treguesit është giga-vat-orë (GWh). Në këtë rast krahasohet sasia e prodhuar e energjisë elektrike me sasinë e konsumuar dhe gjendet diferenca.

Burimi i informatës/ave: Për paraqitjen e këtij treguesi janë përdorë informata nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë, Prishtinë 2015[24], kurse për krahasimet me të dhënat nga shtete të rajonit janë shfrytëzuar edhe Raporti për energji nga CEE Bankwatch Network (Weishaar, S.E., & Madani, S., 2015)[25] dhe Publikimi Kroat për Potenciale and Projekte të Energjisë, Zagreb 2015[26].




Fig. 1. Diagrami mbi raportin e prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike në Kosovë gjatë viteve 2010-2014. Burimi: ZRrE 2015.

Kufizimet për matjen e treguesit: Konsiderohet se nuk ka ndonjë kufizim të matjes së prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike meqë ato jepen në raportet vjetore nga ZRrE.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Viteve të fundit, me përjashtim të vitit 2013, në Republikën e Kosovës, kërkesa për konsum të energjisë elektrike nuk ka mundur të mbulohet me prodhimin e saj. Atëherë shihet qartë rëndësia e këtij treguesi që flet për nevojën e shtimit të prodhimit të kësaj energjie, kur dihet se blerja është më e kushtueshme dhe se Kosova disponon me resurse për prodhim të saj. Shtimi i prodhimit të energjisë elektrike mund të arrihet me shfrytëzimin e mirë të kapaciteteve prodhuese ekzistuese të rehabilituara si dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja, për çka edhe duhet të caktohen lokacioni i përshtatshëm për ndërtim, lloji dhe teknologjia më efikase e tyre. Energjia elektrike kushtëzon zhvillime të rëndësishme në hapësirë të cilat nuk mund të ndodhin në mungesë të saj, prandaj edhe prodhimi i balancuar i saj është i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Në diagramin e fig. 1 është dhënë balanca e prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike gjatë viteve 2010-2014 në Republikën e Kosovës. Aty shihet se, prodhimi është rritur për çdo vit (nga viti 2010 - 2013), kurse vetëm në vitin 2013 ai ka arritur të plotësojë nevojën e konsumit për energji elektrike. Në vitet tjera konsumi është mbuluar duke e shtuar sasinë e energjisë elektrike të importuar, përderisa në vitin 2014, prodhimi saj, jo vetëm që nuk ka mbuluar konsumin, por ka rënë madje nën nivelin e vitit 2010.

[24] Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE), *Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë (energji elektrike, gaz natyror dhe naftë),* Prishtinë 2015.
[25] Weishaar, S.E., & Madani, S., *Report on the long-term economic viability of constructing new electricity capacities for electricity exports in the Western Balkan countries:* CEE Bank-watch Network 2015.
[26] Busurelo, B., Zgrabljic, I., Lenardic, M., Klanjcic, S., *THE REPUBLIC OF CROATIA: ENERGY POTENTIAL AND PROJECTS*. Zagreb 2015.

Ndërsa, në diagramin e fig. 2 shihet prodhimi energjisë elektrike në raport me konsumin e vitit 2012 në Republikën e Kosovës si dhe në shtetet e rajonit. Prej shteteve të prezantuara, atë vit, Serbia dhe Bosna e Hercegovina e kanë mbuluar plotësisht konsumin me prodhim, kurse diferencën më të madhe në mes të prodhimit dhe konsumit e kanë pasur Kroacia dhe Maqedonia.




Fig. 2. Diagrami për balancën mes prodhimit dhe konsumit të EE në Kosovë dhe Rajon (2012). Burimi: IPH+[27].

Konkluzione:

- Republika e Kosovës, edhe pse nuk është e vetmja në rajon, ka nevojë për rritje të prodhimit të energjisë elektrike me qëllim të mbulimit të kërkesës së konsumit saj. Aktualisht, me përjashtim të Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës, asnjë shtet në rajon nuk e mbulon plotësisht konsumin me prodhim të energjisë elektrike.
- Në Republikën e Kosovës, nga viti 2010 deri në vitin 2013, prodhimi i energjisë elektrike është rritur për çdo vit, përkundër faktit që nuk ka pasur shtim të kapaciteteve të reja prodhuese. Rënia e prodhimit të energjisë elektrike në vitin 2014, madje deri nën nivelin e vitit 2010, akoma nuk është stabilizuar, meqë kërkesat për konsum kanë qenë më të mëdha se sa prodhimi, nëse përjashtohet prodhimi i vitit 2013 i cili kishte mbuluar plotësisht konsumin e energjisë elektrike.
- Rasti i vitit 2013 në Kosovë kur konsumi, edhe pse ka qenë i përafërt me ata të viteve tjera është arritur të mbulohet nga prodhimi, kurse mos mbulimi i konsumit me prodhim në 4 vitet tjera nuk ka ndodhur për shkak të mungesës së kapaciteteve prodhuese, sepse të njëjtat kapacitete kanë qenë edhe në vitin 2013. Ky rast tregon se nëse të njëjtat kapacitete prodhuese edhe në vitet tjera do të ishin mbajtur në gjendje të rregullt dhe do të ishin shfrytëzuar maksimalisht, prodhimi do ta kishte mbuluar konsumin. Kjo natyrisht nuk do të thotë se me këto kapacitete prodhuese që i ka Kosova momentalisht do të mund të plotësoheshin edhe kërkesat për konsum në të ardhmen. Zhvillimi i ardhshëm ekonomik nuk mund të ndodhë pa rritjen e prodhimit të energjisë elektrike. Me zhvillimin e ekonomisë rritet edhe konsumi i kësaj energjie, prandaj për të pasur zhvillim ekonomik dhe për ta mbuluar konsumin në rritje që e shkakton rritja ekonomike, është e nevojshme që përveç shfrytëzimit maksimal të kapaciteteve ekzistuese, të ndërtohen edhe kapacitete të reja prodhuese.

[27] Informatat janë marrë nga: *Raporte e publikime të cituara në rajon dhe Deklarata e ZRrE-së në Kosovë (2015).*

Treguesi:	**PËRQINDJA E POPULLSISË QË FURNIZOHET ME UJË TË PIJSHËM**
Synimi:	INFRASTRUKTURA TEKNIKE & KOMUNIKIMI I INTEGRUAR NË MJEDIS TË RESPEKTUAR
Objektivi:	SIGURIMI I QASJES NË INFRASTRUKTURË PËR TË GJITHË

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet vlerën e raportit (në përqindje) të popullatës së përfshirë në sistem të ujësjellësit, që furnizohen me ujë të pijshëm nga kompanitë regjionale të ujit (KRU), në kuadër të numrit të përgjithshëm të popullsisë në Republikën e Kosovës.




Fig. 1. Grafiku i % së popullsisë së përfshirë në furnizim me ujë të pijshëm nga KRU-të në Kosovë (2009 – 2013). Burimi: ZRrE 2014.

Mënyra e matjes së treguesit: Përqindja në nivel republike paraqet mesataren e përqindjeve të popullatave të 7 zonave të Kosovës që furnizohen me ujë nga 7 kompani të ndryshme rajonale të ujësjellësit.

Burimi i informatës/ave: Informata për gjendjen e treguesit në vitin 2013 është në "Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë në 2013" të përgatitur në shtator të vitit 2014 nga Zyra Rregullatorë për Ujësjellës dhe Kanalizim.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Kur të krahasohet e dhëna e vitit 2013 për përqindjen e popullsisë së furnizuar me ujë të pijshëm nga sistemi i ujësjellësit publik në nivel republike me të dhënat që i referohen furnizimit në 4-5 vitet paraprake, do të shihet se a ka pasur përparim në Kosovë sa i përket furnizimit të popullsisë gjatë kësaj periudhe kohore.

Të dhënat për përqindjet e banorëve të furnizuar, sipas zonave të shërbimit me ujë të pijshëm nga KRU gjegjëse, tregojnë se, në cilat rajone më shumë e në cilat më pak janë të përfshirë banorët e Republikës së Kosovës nga shërbimi i KRU-ve. Ky fakt tregon për domosdoshmërinë e planifikimit dhe të zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit publik në rajonet me më pak banorë të përfshirë.




Fig. 1. Grafiku i % së popullsisë së përfshirë në furnizim me ujë të pijshëm nga KRU-të në Kosovë (2009 – 2013). Burimi: ZRrE 2014, me shkurtesat: GJA – KRU "Radoniqi" (Gjakovë);
PE – KRU "Hidrodrini" (Pejë);
PR – KRU "Prishtina" (Prishtinë);
FE – KRU "Bifurkacioni" (Ferizaj);
MIT – KRU "Mitrovica" (Mitrovicë);
PZ – KRU "Hidroregjioni Jugor" (Prizren);
GJI – KRU "Hidromorava" (Gjilan)
MES – % Mesatare e Popullsië Përfshirë nga 7 KRU-të;

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Në vitin 2013, 82 % e popullsisë në Republikën e Kosovës është furnizuar me ujë të pijshëm, prej sistemit publik të ujësjellësit nën menaxhim të KRU-ve. Nga grafiku në fig. 1, kuptohet se, përfshirja e popullsisë në shërbimin e ujësjellësve publik në Republikën e

Kosovës, vazhdimisht është rritur nga viti 2009 deri në vitin 2013. Ndërsa, nga grafiku në fig. 2, kuptohet se në vitin 2013 zona me përqindjen më të madhe të përfshirjes së banorëve nga ky shërbim është regjioni i Gjakovës që furnizon 99.7 % të popullsisë me ujë të pijshëm nga KRU "Radoniqi", kurse zona me përqindjen më të vogël prej 62.7 % të përfshirjes së banorëve të saj në këtë shërbim është regjioni i Gjilanit që furnizohet nga KRU "Hidromorava".

Konkluzione:

- Në Republikën e Kosovës, gjendja sa i përket furnizimit të popullsisë me ujë të pijshëm nga ujësjellësit publik, nga viti 2009 deri në vitin 2013 ka shkuar duke u përmirësuar.
- Rreth 20% e popullsisë së Kosovës, që janë popullsi e viseve rurale, ende nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga ujësjellësit publik.
- Zonat që kanë nevojë dhe kërkesa më të mëdha për investime në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit publik në Republikën e Kosovës janë Mitrovica, Prizreni dhe Gjilani.

Treguesi:	**PËRQINDJA E RRUGËVE TË ASFALTUARA NGA RRJETI I RRUGËVE**
Synimi:	INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR
Objektivi:	PËRMIRËSIMI I RRJETIT DHE OBJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË BRENDSHME




Fig. 1. Harta e rrjetit kryesor të rrugëve në Republikën e Kosovës. Burimi: Ministria e Infrastrukturës.

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet përqindjen e rrugëve të asfaltuara nga rrjeti i rrugëve të Republikës së Kosovës ku janë të përfshira të gjitha kategoritë e rrugëve, pra edhe rrugët lokale.

Mënyra e matjes së treguesit: Vlera numerike e cila e tregon përqindjen e rrugëve të asfaltuara mund të gjendet nëse dihet sa është gjatësia e të gjitha rrugëve të Republikës së Kosovës dhe sa kilometra nga këto rrugë janë të asfaltuara.

Burimi i informatës: Ministria e Infrastrukturës; shtëpia konsulente ndërkombëtare "A.T. Kerni"

Kufizimet në matjen e treguesit: Ende nuk ekziston e dhëna e saktë se sa është gjatësia e rrugëve lokale në Republikën e Kosovës dhe sa kilometra prej tyre janë të asfaltuara. Ministria e Infrastrukturës (MI) e ka vlerësuar se gjatësia e tyre është 4761 kilometra. Përqindja e asfaltimit të rrugëve lokale është vlerësim që është bërë duke e marrë për bazë prononcimin për media të ish ministrit Fatmir Limaj nga i cili është dhënë shifra rreth 80% të asfaltuara më 23.11.2010, me rastin e përurimit të rrugës së asfaltuar në fshatin Smirë të komunës së Vitisë. Kjo tregon se e dhëna për treguesin mbështetet në vlerësim dhe nuk është 100% e saktë, por megjithatë është shumë e përafërt me vlerën e saktë, prandaj edhe mund të mbështetemi në të. Të dhënat në diagramin 1 janë gjithashtu vlerësim. Vlerësimin e ka bërë shtëpia konsulente ndërkombëtare "A.T. Kerni" më 30.05.2015 në Lubjanë të Republikës së Sllovenisë.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: E dhëna e këtij treguesi flet për gjendjen aktuale të rrugëve në vendin tonë. Ajo tregon se a është kjo gjendje e keqe apo e mirë dhe kjo i orienton qeveritë qendrore dhe lokale që ta caktojnë asfaltimin e rrugëve si prioritet të lartë ose jo. Harta këtu tregon se çfarë shpërndarje kanë patur rrugët e paasfaltuara regjionale në vitin 2013 dhe për cilat treva të republikës duhet të planifikohet asfaltimi i këtyre rrugëve nga MI. Sa i përket rrugëve lokale, komunat i kanë të dhënat që tregojnë se për cilat zona të territoreve të tyre duhet të planifikohet asfaltimi i këtyre rrugëve.




Fig. 2. Grafiku për % e rrugëve të asfaltuara në Kosovë dhe raporti saj me të vendeve në rajon. Burimi: MI dhe ShKN "A.T. Kerni".

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Është vlerësuar se rreth 85% të rrugëve nga rrjeti i rrugëve të Republikës së Kosovës ku hyjnë të gjitha kategoritë e rrugëve, janë të asfaltuara. Në hartën më lart tregohet shtrirja e auto-udhës, rrugëve nacionale dhe atyre regjionale në territorin e republikës, si dhe tregohet gjendja e tyre, për sa i përket asfaltimit. Në grafikun e fig. 2, vërehet se Sllovenia i ka 100 % të rrugëve (këtu hyjnë të gjitha kategoritë e rrugëve) të asfaltuara, kurse Bosnja e Hercegovina 92%, Kroacia 91%, Kosova 85%, Maqedonia 75%, Mali i Zi 65%, Serbia 63% dhe Shqipëria 40% të tyre.

Konkluzione:

- Analiza e të dhënave të vitit 2004 për rrugët rezulton me një vlerësim se në atë kohë, në Kosovë kanë qenë të asfaltuara 30-35% të të gjitha kategorive të rrugëve. Sot në vitin 2015 është vlerësuar se kjo përqindje ka arritur në rreth 85%, pra gati sa është trefishuar. Kjo tregon se në 10 vitet e fundit, Republika e Kosovës ka përparuar dukshëm në zhvillimin e infrastrukturës së transportit dhe se objektivi për përmirësimin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme, i caktuar me Planin Hapësinor të Kosovës, është arritur.
- Tani ka mbetur që niveli i përmirësimit të rrjetit të ngrihet edhe më lart deri sa përqindja e rrugëve të asfaltuara të arrijë në 100%. Pra duhet të planifikohet dhe përpjekjet të orientohen në asfaltimin e rrugëve, të cilat ende janë të paasfaltuara. Prioritet duhet t'u jepet atyre komunave dhe zonave ku ka më shumë rrugë të paasfaltuara.
- Republika e Kosovës momentalisht qëndron mirë në raport me shtetet në rajon sa i përket asfaltimit të rrugëve. Me 85% të rrugëve të asfaltuara, momentalisht mund të mos jetë akoma prioritet shumë i lartë i Qeverisë, por kjo nuk do të thotë se investimet në rrjetin rrugor nuk janë me prioritet. Edhe pse në vendin tonë janë ndërtuar dhjeta kilometra auto-udhë, ende ka nevojë për investime në ndërtimin e auto-udhëve sepse këto do të ngritin nivelin e sigurisë në trafik, e lehtësojnë lëvizjen dhe e rrisin shpejtësinë e saj.

Treguesi:	**DENDËSIA E RRJETIT RRUGOR TË ASFALTUAR NË KOSOVË**
Synimi:	INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR
Objektivi:	PËRMIRËSIMI I RRJETIT DHE OBJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË BRENDSHME

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet gjatësinë në kilometra të rrugëve të asfaltuara, të të gjitha kategorive në 1 km² të sipërfaqes së Republikës së Kosovës.

Mënyra e matjes së treguesit: Njësia matëse e rezultatin e treguesit është km/km². Ai gjendet kur numri i cili e tregon gjatësinë në kilometra të rrugëve të asfaltuara, të të gjitha kategorive në Republikën e Kosovës, pjesëtohet me numrin, i cili e tregon sipërfaqen në km² të Republikës së Kosovës.




Fig. 1. Harta e rrjetit kryesor të rrugëve në Republikën e Kosovës. Burimi: Ministria e Infrastrukturës.

Burime të informatës/ave: Ministria e Infrastrukturës e Republikës së Kosovës; Zyra e Statistikave e Republikës së Sllovenisë; Ministria e Infrastrukturës e Republikës së Sllovenisë; Auto-moto Klubi i Bosnjës dhe Hercegovinës; Ministria e Detarisë, Qarkullimit dhe Infrastrukturës e Republikës së Kroacisë; Ministria e Trafikut, Detarisë dhe Telekomunikacionit e Republikës së Malit të Zi; Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore e Republikës së Maqedonisë

Kufizimet në matjen e treguesit: Këto kufizime shkaktohen nga mungesa e të dhënave 100% të sakta për gjatësinë e rrugëve lokale në Republikën e Kosovës dhe për gjatësinë e asfaltimit të tyre. Ministria e Infrastrukturës (MI) e ka vlerësuar se gjatësia e tyre është 4761 kilometra, kurse sa kilometra prej tyre janë të asfaltuara është vlerësim që është bërë duke e marrë për bazë prononcimin për media të ish ministrit Fatmir Limaj nga i cili është dhënë shifra rreth 80% të asfaltuara më 23.11.2010, me rastin e përurimit të rrugës së asfaltuar në fshatin Smirë të komunës së Vitisë. Duke i patur këto dy vlerësime është gjetur pastaj gjatësia e rrugëve të asfaltuara, të të gjitha kategorive. Pra edhe kjo gjatësi është një vlerësim që megjithatë është shumë e përafërt me vlerën e saktë, prandaj edhe mund të mbështetemi në të.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Krahasimi i vlerës numerike të këtij treguesi me vlerën numerike të po të njëjtit tregues që i referohet gjendjes para 11 vjetëve, tregon se a ka pasur zhvillim sa i përket infrastrukturës rrugore në Kosovë. Krahasimi i vlerës numerike të këtij treguesi me vlerat numerike të treguesve të njëjtë që u referohen shteteve tjera, tregon si qëndron Kosova në raport me ato shtete dhe po ashtu u jep një orientim qeverive qendrore dhe lokale që ta caktojnë rritjen e dendësisë së rrugëve të asfaltuara si prioritet të lartë ose jo. Harta më lart tregon se çfarë shpërndarje kanë pasur rrugët e paasfaltuara regjionale në vitin 2013 dhe për cilat treva të republikës duhet të planifikohet asfaltimi i tyre nga MI që njëherësh do ta rriste edhe dendësinë e rrjetit rrugor të asfaltuar. Sa i përket rrugëve lokale, komunat i kanë të dhënat që tregojnë se për cilat zona të territoreve të tyre duhet të planifikohet asfaltimi i tyre.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Është vlerësuar se dendësia e rrjetit rrugor të asfaltuar në Republikën e Kosovës është 0.53 km/km². Në hartën më lart tregohet shtrirja e auto-udhës, rrugëve nacionale dhe atyre regjionale në territorin e republikës, si dhe gjendja në vitin 2013 sa i përket asfaltimit të tyre.




Fig. 2. Grafiku për dendësinë e rrjetit rrugor të asfaltuar në Republikën e Kosovës për vitet 2004 dhe 2015. Burimi: Mi.

Dendësia prej 0.195 km/km² sa është vlerësuar të ketë qenë në vitin 2004 ka arritur në 0.53 km/km² në vitin 2015 duke e rritë kështu vlerën gati për 3 herë më shumë për këto 11 vite. Kjo flet për një përparim të dukshëm të Kosovës në zhvillimin e infrastrukturës së transportit në këtë periudhë kohore. Për më tepër, në mesin e vendeve të rajonit, vetëm Republika e Sllovenisë e ka dendësinë më të madhe të rrjetit të rrugëve të asfaltuara me 1.00 km/km² të sipërfaqes së saj. Kurse, Republika e Kosovës radhitet e dyta me 0.53 km/km² të sipërfaqes së saj, ndërsa pas saj vijnë Kroacia me 0.43 km/km², Bosnja e Hercegovina dhe Maqedonia me nga 0.41 km/km² si dhe Shqipëria që e ka dendësinë e njëjtë me atë të Serbisë prej 0.28 km/km².




Fig. 3. Grafiku për vlerën e dendësisë dhe renditjen e Kosovës në raport me shtetet rajon. Burimi: Ministritë dhe zyrat statistikore të vendeve në rajon.

Konkluzione:

- Analiza e të dhënave të vitit 2004 për rrugët rezulton me një vlerësim se në atë kohë, dendësia e rrjetit rrugor të asfaltuar në Kosovë ka qenë 0.195 km/km². Sot në vitin 2015 është vlerësuar se kjo dendësi ka arritur në 0.53 km/km², pra gati sa është trefishuar. Kjo tregon se në 10 vitet e fundit, Republika e Kosovës ka përparuar dukshëm në zhvillimin e infrastrukturës së transportit dhe se objektivi për përmirësimin e rrjetit dhe objekteve të infrastrukturës së brendshme, i caktuar me Planin Hapësinor të Kosovës, është arritur.
- Në Republikën e Kosovës ende janë rreth 15% të rrugëve të paasfaltuara. Kjo do të thotë se duhet të planifikohet dhe përpjekjet të orientohen në asfaltimin e këtyre rrugëve. Kështu do të rritej akoma dendësia e rrjetit të rrugëve të asfaltuara. Prioritet duhet t'u jepet atyre komunave dhe zonave ku ka më shumë rrugë të paasfaltuara.
- Republika e Kosovës momentalisht qëndron mirë në raport me shtetet në rajon sa i përket dendësisë së rrjetit të rrugëve të asfaltuara. Me 0.53 km rrugë të asfaltuara në 1 km² të sipërfaqes së shtetit, Kosova radhitet e dyta pas Sllovenisë. Për shkak të kësaj pozite, relativisht të mirë dhe përmirësimit të dukshëm të rrugëve në Kosovë, momentalisht rritja e mëtejshme e dendësisë së rrugëve të asfaltuara mund të mos jetë prioritet shumë i lartë i Qeverisë, por kjo nuk do të thotë se investimet në rrjetin rrugor nuk janë prioritet. Edhe pse në vendin tonë janë ndërtuar dhjetëra kilometra auto-udhë, ende ka nevojë për investime në ndërtimin e auto-udhëve sepse këto do e ngritin nivelin e sigurisë në trafik, e lehtësojnë lëvizjen dhe e rrisin shpejtësinë e saj.

Treguesi:	**DENDËSIA E RRJETIT HEKURUDHOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**
Synimi:	INFRASTRUKTURA DHE KOMUNIKIMI I INTEGRUAR
Objektivi:	PËRMIRËSIMI I RRJETIT DHE OBJEKTEVE TË INFRASTRUKTURËS SË BRENDSHME



Fig.1 . Harta e rrjetit hekurudhornë Republikën e Kosovës. Burimi: MI.

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet numrin e kilometrave të hekurudhave të Republikës së Kosovës në 1 km² të sipërfaqes së Republikës.

Mënyra e matjes së treguesit: Njësia matëse e treguesit është km/km². Ai gjendet kur numri i cili e tregon gjatësinë në kilometra të të gjitha hekurudhave të Kosovës pjestohet me numrin, i cili e tregon sipërfaqen në km² të Republikës së Kosovës.

Burimi i informatës/ave: Ministria e Infrastrukturës; Trainkos; Infrakos





Fig. 2. Grafiku për vlerën e treguesit ndër vite në Kosovë. Burimi: MI.

Kufizimet në matjen e treguesit: Sipas shifrës që e jep ky tregues, del se Republika e Kosovës, krahasuar me vendet e rajonit nuk qëndron keq sa i përket dendësisë së rrjetit hekurudhor e madje ajo qëndron edhe më mirë se sa SHBA në këtë aspekt. Problemi është se një pjesë e këtij rrjeti është jashtë funksionit dhe edhe hekurudha që është në funksion nuk është në gjendje të mirë. Ky fakt e zbeh shifrën që e jep treguesi dhe ia zvogëlon dukshëm rëndësinë dhe relevanten.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Krahasimi i vlerës numerike të këtij treguesi me vlerën numerike të po të njëjtit tregues që i referohet gjendjes para 5 vjetëve, tregon a ka pasur zhvillim sa i përket hekurudhave në Kosovë. Krahasimi i vlerës numerike të këtij treguesi me vlerat numerike të treguesve të njëjtë që u referohen shteteve tjera, tregon si qëndron Kosova në raport me ato vende.

Nëse në Republikën e Kosovës dëshirohet që në të ardhmen të zhvillohet transporti hekurudhor, atëherë gjendja e këtij treguesi i cili ka mbetur i njëjtë për shumë vjet me radhë, tregon qartë për nevojën e planifikimit të përmirësimit dhe zhvillimit të rrjetit hekurudhor i cili ka stagnuar për shumë

vjet. Harta e shtrirjes së rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës tregon se dy nga 7 qytetet më të mëdha të vendit tonë, Gjilani dhe Gjakova, nuk janë të përfshirë në këtë rrjet, prandaj duhet të planifikohet ndërtimi i linjave hekurudhore që i lidhin edhe këto dy qytete dhe kështu e rrisin edhe dendësinë e rrjetit.



Diagrami 2 – Kosova në raport me disa shtete. Burimi: MI


Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Dendësia e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës është 0.04 km/km². Në grafikun e fig. 2, vërehet se në 5 vitet e fundit, por jo vetëm në këtë periudhë, dendësia e rrjetit hekurudhor në Republikën e Kosovës ka qenë e njëjtë, pra nuk është ndërtuar as edhe një kilometër hekurudhë që do të thotë se në këtë drejtim nuk ka pasur zhvillim. Nga diagrami 2 shihet se prej shteteve të prezantuara, Gjermania e ka rrjetin më të dendur hekurudhor me 0.12 km hekurudhë për 1 km² të sipërfaqes së saj, kurse Kosova me 0.04 qëndron diku në mes.

Konkluzione:

- Treguesi i dendësisë së rrjetit hekurudhor në Kosovë që me shifër është: i njëjtë me atë në Maqedoni, pak më i ulët se në Francë e Serbi dhe madje më i lartë se në SHBA, nuk e jep pasqyrën reale të zhvillimit të rrjetit hekurudhor në Kosovë sepse ai është më pak i zhvilluar se në Maqedoni, kurse zhvillimit të hekurudhave në Francë dhe SHBA as që i afrohet.
- Linjat hekurudhore në relacionet Klinë-Prizren dhe Fushë Kosovë-Podujevë janë jashtë funksionit, kurse ato që janë në funksion nuk janë në gjendje të mirë.
- Dendësia e rrjetit ka qenë e njëjtë jo vetëm në 5 vitet e fundit siq tregon diagrami 1, por ajo është e njëjtë që nga viti 1963 kur është ndërtuar linja e fundit hekurudhore në Republikën e Kosovës.
- Fakti që në 52 vitet e fundit nuk është ndërtuar as edhe një kilometër hekurudhë flet për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore në këtë periudhë kohore.
- Transporti hekurudhor i mallrave dhe udhëtarëve vlerësohet si më i përshtatshëm, me mundësi të transportimit të më shumë mallrave dhe udhëtarëve për një herë, më komfort, më i sigurt dhe më pak i kushtueshëm se sa transporti rrugor, prandaj niveli i tanishëm, jo i kënaqshëm i hekurudhave të Kosovës shtron nevojën e ngutshme për planifikimin e zhvillimit dhe më pas zhvillimin e infrastrukturës dhe transportit hekurudhor.
- Dy nga 7 qytetet më të mëdha të vendit tonë, Gjilani dhe Gjakova, nuk janë të përfshirë në rrjetin hekurudhor të Republikës së Kosovës, prandaj duhet të planifikohet ndërtimi i linjave hekurudhore që i lidhin edhe këto dy qytete.

Treguesi:	**PROGRESI NË MENAGJIMIN E ZONAVE TË NDOTURA (EEA: CSI 015)**
Synimi:	PLOTËSIMI I STANDARDEVE EVROPIANE PËR MJEDISIN
Objektivi:	PASTRIMI I SIPËRFAQEVE TË NDOTURA ME MBETURINA NGA E KALUARA

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet gjendjen e lokacioneve të ndotura mjedisore, të krijuara nga mbetjet industriale dhe mbeturinat tjera të rrezikshme, të deponuara në disa pjesë të vendit tonë. Këto pika ose lokacione, me ndikim të madh negativ në mjedisin jetësor, quhen pika të ndjeshme mjedisore apo "hot-spote - pika të nxehta".



ID	Emri	Area_ha
01	Deponia minerare ne Kishnice	10.23
02	Deponia minerare ne Kishnice 2	2.85
03	Deponi minerare ne Artane	2.38
04	Deponi minerare ne Artane 2	3.94
05	Deponi sanitare e mbeturinave ne Podujeve	8.72
06	Deponi sanitare e mbeturinave ne Mitrovice	3.60
07	Deponia minerare e Kelmendit	23.78
08	Deponia minerare e Zveqanit	62.28
09	Depo me lende Radioaktive ne Mitrovice	0.03
10	Meterie Radioaktive PIM	0.04
11	Deponi sanitare e mbeturinave ne Peje	4.85
12	Kemikale te rrezikshme industriale ne Peje	0.12
13	Deponi sanitare e mbeturinave ne Prizren	20.94
14	Mbetje asbesti ne Han te Elezit	0.18
15	Rezervuar me Fenole ne Obiliq	177.64
16	Mbetje asbesti ne Han te Elezit 2	0.42
17	Mbetjet minerare ne Golesh	15.13
18	Deponi sanitare e mbeturinave ne Mirash	33.65
19	Deponia e hirit ne Obiliq	181.97
20	Deponi e hirit ne Obiliq 2	192.94
21	Deponia sanitare e mbeturinave ne Gjilan	20.50
22	Deponi e skories te Feronikelit ne Gllogoc	71.37
23	Deponia e flotacionit ne Deve te Gjakove	5.23
24	Mbetjet bujqesore ne Shiroke te Suhareke	0.04
25	Fabrika e shiritave te gomes ne Suhareke	17.17
26	Deponi minerare ne Leposaviq	20.31
27	Parku Industrial i Trepqes ne Mitrovice	115.10

Fig. 1. Harta me lokacionet e hotspoteve në Kosovë Burimi: MMPH/AMMK[28].

Mënyra e matjes së treguesit: Matja e këtij treguesi bëhet duke llogaritur shumën e sipërfaqeve (në km²), të mbuluara me mbetje industriale dhe të tjera të rrezikshme, në raport me sipërfaqen e tërësishme të vendit. Matjet kanë rezultuar se sipërfaqja e përgjithshme e pikave të ndjeshme mjedisore / hot-spoteve në vendin tonë është 9.94 km² ose rreth 0.1 % e territorit të Kosovës.

Burimi i informatës/ave: Burimi kryesor i të dhënave për këtë tregues është Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës, në kuadër të MMPH.

Kufizimet për matjen e treguesit: Deri në vitin 2006 nuk ka pas progres, në pastrim dhe rehabilitim të pikave dhe lokacioneve të ndjeshme mjedisore, për shkak të mungesës së strategjisë, mjeteve financiare dhe institucioneve përgjegjëse për hulumtimin, monitorimin dhe menaxhimin e tyre. Prandaj, edhe matja e këtij treguesi, si në të kaluarën edhe tani, është i kufizuar edhe për kundër

[28] MMPH / AMMK, Raporti për Hotspotet Mjedisore në Kosovë, Prishtinë, 2011.

faktit që pastrimi dhe rehabilitimi është realizuar në disa prej këtyre pikave dhe lokacioneve të cilat shihen në fig. 1, edhe pse shkalla e progresit të arritur nuk është prezantuar në nivelin e duhur.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Ky tregues është shumë i rëndësishëm, sepse si i tillë, në formën e të dhënave hapësinore, na tregon për vendshtrirjen e pikave / lokacioneve të ndjeshme mjedisore, madhësinë e sipërfaqes, llojin e ndotësit të rrezikshëm ose industrial dhe sasinë ndotëse. Njëherit, kjo bazë e mirë e informacionit, do të shërbej si në identifikimin e sfidave dhe çështjeve në profil ashtu edhe në pëcaktimin e zgjidhjeve gjatë hartimit të projekteve tek strategjia për rehabilitimin dhe ripërdorimin e këtyre zonave, duke orientuar politika dhe donacione drejt fushës së mbrojtjes së mjedisit.


Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Në tërë territorin e Kosovës janë identifikuar rreth 110 zona të ndjeshme mjedisore. Ndërsa, 27 prej tyre janë evidentuar si zona me potencial dhe me ndikim më të madh në mjedis dhe në shëndetin e popullsisë.
Gjatë krahasimit të të dhënave rezulton se ndotja me e madhe ishte deri në vitin 2006. Mirëpo, gjatë viteve 2007-2009 Minsitria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor në bashkëpunim me Komisionin Evropian, ka investuar në mbylljen dhe rehabilitimin e katërmbëdhjetë (14) deponive të mbeturinave komunale. Po ashtu, ajo ka bërë investime edhe në ndërtimin e shtatë qendrave për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore, si dhe në ngritjen e imipanteve për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme.
Përveç kësaj, Ministria e Zhvillimit Ekonomik në përkrahje të organizatave ndërkombëtare dhe të donatorëve, ka realizuar disa projektet, për rehabilitimin e deponive industriale, si: Projekti për Pastrimin dhe Rikultivimin e Tokës nga deponitë e KEK-ut, kryesisht në Obiliq, si dhe trajtimi i deponive në Artanë dhe në Kelmend.

Konkluzione:

- Mos evidentimi, azhurnimi i të dhënave për projektet e realizuara si dhe pasqyrimin e gjendje reale në pikat dhe lokacionet e ndjeshme mjedisore;
- Mungojnë studime të thella për ripërdorimin e masës së deponuar në pikat e ndjeshme mjedisore (hot-spote) të cilat janë pasuri shtetërore dhe lëndë e parë për prodhime tjera finale;
- Në mungesë të vlerësimit të gjendjes reale dhe hartimit të strategjisë me kosto financiare, për pastrimin dhe rehabilitimin e hot-spoteve, situata vazhdon të jetë në nivel të njëjtë të ndotjes;
- Mos favorizimi i politikave për inkurajimin e sektorit privat pengon bashkëpunimin dhe zhvillimin e Partneritetit publik-privat në menaxhim të mjedisit.

Treguesi:	**KUALITETI I AJRIT**
Synimi:	MBROJTJA E AJRIT NGA NDOTJA
Objektivi:	PARANDALIMI NGA NDOTJES SË AJRIT

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet cilin e ajrit. Monitorimi i cilësisë së ajrit është obligim ligjor (Ligji për mbrojtjen e mjedisit neni 50, Ligji për mbrojtje të ajrit nga ndotja neni 23 dhe Ligji për veprimtarin hidrometeorologjike neni 5). Monitorimi i cilësisë së ajrit duhet të siguroj të dhëna për nivelin e ndotjes së ajrit, ndryshimet klimatike, ndikimet në shëndetin e popullsisë dhe ndikimet materiale në ekosistem dhe vegjetacion.



Mënyra e matjes së indikatorit: Gjendja momentale për monitorim të cilësisë së ajrit nuk i plotëson kërkesat e nevojshme për monitorim. Tani të dhëna për emisione raportojnë vetëm 4 operator KEK, Fabrika e çimentos "Sharr Cem", New Co Feronikeli dhe Ngrohtorja e qytetit "Termokos" në Prishtinë. Kurse dy institucione, IHMK dhe IKSHP, bëjnë monitorim të pavarur dhe përpunon informata

Burimet e informatave: IHMK, IKSHP, KEK, SHARCEM, FERONIKEL

Kufizimet për matjen e indikatorit: Informatat për treguesin bazohen në matjet e stacioneve të vendosura në pakat e lartpërmendura. Nuk ka stacione monitoruese të mjaftueshme për të paraqitur gjendjen reale në tërë territorin e Kosovës. Aktualisht kontribuues më të mëdhenj të ndotjes së ajrit në Kosovë janë: KEK-u që përfshin Termocentralet (Kosova A dhe Kosova B) dhe Mihjet sipërfaqësore të linjitit në Obiliq, Kompleksi Industrial në Mitrovicë, Ferro-nikeli në Gllogoc, Fabrika e çimentos Sharr-Cem në Han të Elezit, Fabrika e industrisë kimike dhe e gomës BALLKAN në Suharekë, Sistemet për ngrohje qendrore (Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë), Industria e rëndë bazike të cilat aktualisht nuk operojnë (Gjakovë, Pejë, Gjilan), Trafiku, Bujqësia, Deponitë e mbetjeve urbane dhe atyre industriale. Nga të dhënat me të cilat disponon AMMK, vlerësohet se ajri në Kosovë nuk është i cilësisë së duhur dhe në disa lokalitete është tepër i ndotur nga aktivitete prodhuese (rrethina e KEK-ut, Feronikelit, Sharrcemit, ndotja nga trafiku, deponitë e mbetjeve urbane dhe industriale etj.). Më së shumti ka tejkalime të vlerave të lejuara të pluhurit, dhe grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2,5. Prandaj, nevojitet të ndërmerren masa që sa më parë të zbatohen politika dhe strategji përkatëse për përmirësim e cilësisë së ajrit.


Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Analiza e të dhënave për vlerësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, është bërë duke u bazuar në të dhënat në dispozicion dhe duke marrë si pikë krahasimi standardet e BE-së nga Direktiva 2008/50/EC, mbi cilësinë e ajrit dhe Udhëzimi administrative për vlerat kufitare - normat e cilësisë së ajrit; Nr. 02/2011 Direktiva 2008/50/EC për Cilësinë e ajrit mjedisor dhe ajrit të pastër për Evropë, drejton aktivitetet, vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit, vendosjen e vlerave të synuara dhe vlerave limite për cilësinë e ajrit, që kanë për objektiv mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë punë të mire në transpozimin e legjislacionit Evropian përmes aprovimit të Udhëzimit Administrativ për Normat e cilësisë së ajrit. Materiet grimcore (pluhuri) krijohen nga proceset natyrore dhe antropogjene, të cilat shpërndahen në ajër në formë difuzive dhe në tokë bien nën ndikimin e gravitacionit ose së bashku me të reshurat atmosferike. Materiet grimcore kategorizohen në bazë të madhësisë së grimcave (grimcat PM10, PM2,5 dhe PM1 me diametër të caktuar aerodinamik < 10µm, <2,5 m dhe <1µm) dhe grimcat totale të suspenduara GTS.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Bazuar në të dhënat e disponueshme për cilësinë e ajrit, të dhënat për emisione dhe të dhënave tjera statistikore, mundë të vlerësohet se ajri në Kosovë ka cilësi jo të kënaqshme. Problem parësorë i ndotjes së ajri në Kosovë është ndotja me grimcat PM10, duke mos i abstrahuar edhe ndotësit tjerë të cilët atakojnë shëndetin e njeriut, vegjetacionit, botën bimore, botën shtazore dhe rrezikojnë materialet. Institucionet e Kosovës në periudhën e pasluftës brenda mandatit dhe mundësive kanë bërë përpjekje në ndërmarrjen e masave adekuate për zvogëlimin e ndikimit të burimeve ndotëse në ajër dhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Megjithëkëtë nevojitet angazhim edhe më i madh në përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në sektorin a ajrit.

Në bazë të dhënave në kompanitë me të mëdha industriale ka tejkalim te Vlerave të lejuara mesatare të Pluhurit .

	Pluhuri	NOx	SO_2	CO_2
Sharrcem	Tejkalim i VLM	VLM	VLM	Në rritje
TCB1	Tejkalim i VLM	Ka tejkalime të VLM	Ka tejkalime të VLM	Në rritje
TCB2	Tejkalim i VLM	Ka tejkalime të VLM	Ka tejkalime të VLM	Në rritje
Feronikeli	Tejkalim i VLM	VLM	Ka tejkalime të VLM	X
Sharrcem	Tejkalim i VLM	VLM	VLM	X

Tabela : Vlerat e lejuara mesatare në bazë të standardeve të Bashkimit Evropian



Vlerat mesataret vjetore e PM10 në tri stacionet e monitorimit

Konkluzione:

Ndër sfidat kryesore mjedisore për Kosovën është edhe plotësimi i standardeve mjedisore evropiane dhe përafrimi i legjislaturës kombëtare mjedisore me atë evropiane. BE ka parashtruar në mënyrë të qartë kriteret, metodologjinë dhe normat e lejuara, të cilat duhet të plotësohen nga shtetet anëtare

të BE por edhe shtetet në zhvillim, shtetet kandidate për anëtarësim apo edhe shtetet pretenduese për anëtarësim në BE.

Për plotësimin e këtyre kritereve, metodologjive dhe normativave të lejuara që i ka parashtruar BE duhet të bazohemi në këto direktiva:

- Direktiva 2008/50/EC, për cilësinë e ajrit dhe ajër të pastër në Evropë,
- Direktiva 2004/107/EC, në lidhje me arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet policiklike në ajrin mjedisorë,
- Direktiva 2001/80/EC, mbi limitimin e emisioneve të ndotësve të caktuar në ajër nga impiantet me djegëje të mëdha,
- Direktiva 2002/3/EC, në lidhje me Ozonin në ajrin mjedisorë,
- Direktiva 2000/69/EC në lidhje me vlerat limite për benzenin dhe monoksid karbonin në ajrin mjedisorë,
- Direktiva 1999/30/EC në lidhje me vlerat limite për dyoksidin e sulfurit, dyoksidin e azotit dhe oksidet e azotit, materiet grimcore (PM10, PM 2.5) dhe plumbi në ajrin mjedisorë,
- Direktiva 96/62/EC, mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit mjedisorë.

Me plotësimin e këtyre direktivave arrijmë ne parandalimin e ndotjes së ajrit

1. Kufizimi i mjeteve të vjetra ne qarkullim
2. Obligimi i kompanive për ndërrim te filtrave ne bazë të standardeve
3. Nevoja ndërtimi i stacioneve për monitorim të ajrit ne 7 qendra te mëdha të Kosovës
4. Furnizimi i IHMK apo edhe te ndenji subjekti tjetër me stacione mobile

Treguesi:	**KUALITETI I UJËRAVE SIPËRFAQËSORE (EEA - CSI 022)**
Synimi:	MBROJTJA DHE RUAJTJA E TRUPAVE UJOR NGA NDOTJA
Objektivi:	PARANDALIMI I NDOTJES SË UJËRAVE SIPËRFAQËSOR

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet kualitetin e ujërave sipërfaqësor të Kosovës të ndarë sipas klasifikimit I, II, III dhe IV të shkallës së ndotjes, të bazuar në pjesëmarrje të parametrave ndotës dhe të vlerës ndikuese.




Fig.1. Harta me shkallët e ndotjes së lumenjve. Burimi: MMPH/IPH

Mënyra e matjes së treguesit: Kualiteti i ujërave sipërfaqësore në Kosovë bazohet në metodat ndërkombëtare të llogaritjes së prezencës dhe pjesëmarrjes së këtyre parametrave: SHBO5, PE, pH, NO_2, NH_4^+, SO_4, PO_4, Fosfori total, FP si dhe të metaleve të rënda : Pb2+, Cd2+, Cu2+, Cr6+, Ni2, Fe2+, Zn2+, Mn2+, Cr3+. Në Kosovë këta parametra kanë filluar të monitorohen dhe maten prej vitit 2008, nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) dhe në bazë të Vlerës së Lejuar Mesatare (VLM) të tyre përcaktohen edhe klasat përkatëse të kualitetit të ujërave sipërfaqësor.

Burimi i informatës/ave: Në Kosovë janë dy burime të besueshme të informatave: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës- Instituti Hidro-Meteorologjik (IHM) dhe Instituti i Shëndetit Publik (IShP), që bëjnë analiza laboratorike për prezencën e parametrave të përmendur.

Kufizimet për matjen e treguesit: Informatat për treguesin bazohen në vlerat e dala nga analizat e mostrave që janë marrë drejtpërdrejtë në rrjedhat lumore. Mirëpo, stacionet hidrometeorologjike, të ngritura në rrjedhat lumore, si dhe pikat ku merren mostrat e ujit nuk janë të mjaftueshme. Në aspektin hapësinor këto vend matje duhen te zhvillohen edhe më tej dhe se duhet të monitorohet çdo rrjedhë lumore nga burimi deri në grykëderdhje. Pikat monitoruese, duhet të jenë aktive, sidomos në monitorimin e vendbanimeve urbane ku shkarkohen ujërat e zeza dhe industriale.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Në aspektin e menaxhimit të ujërave të ndotura, Kosovën e presin obligime të mëdha, sidomos në relacion me përmbushjen e direktivave të BE (Direktiva 91/271/EEC mbi Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane) si dhe të përmbushjes së detyrimeve të tjera ndërkombëtare. Prandaj, në aspektin e zhvillimeve hapësinore, është shumë me rëndësi të identifikohen pikat më të rrezikuara nga ndotja në mënyrë që shkaktarët të trajtohen para derdhjes tyre në ujërat sipërfaqësor, sidomos në rrjedhat lumore që dalin jashtë vendit.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Gjendja aktuale në Kosovë është e njëjtë sikur edhe në vendet e rajonit. Në Kosovë praktikisht nuk ekzistojnë impiante për trajtimin e ujërave të zeza dhe industriale, me përjashtim të disa gropa septike për zonat e kufizuara shtëpiake apo laguna natyrale të cilat janë formuar në pikat shkarkuese të sistemeve grumbulluese të ujërave të ndotura. Në disa kampe të Forcave të Armatosura të KFOR-it dhe në Kompleksin e QKUK-së në Prishtinë ka impiante për trajtim biologjik të ndotjes.

Shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, përbëjnë burimin kryesorë të ndotjes së ujërave sipërfaqësore, sepse ato përmbajnë shumë lëndë që shpenzojnë oksigjenin e tretur, kompozime të tretshme të fosforit dhe azotit (eutrofikimin), baktere dhe viruse patogjene, si dhe lëndë tjera që ndikojnë në cilësinë e ujërave. Ekziston vetëm impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Skenderaj i cili nuk është në funksion.

Shkarkimet e ujërave të ndotura industriale, janë një ndër ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndër ndotësit më të mëdhenj janë: KEK-u, Ferronikel-i, Sharrcem-i, Minierat e Trepçës, të Kishnicës, Artanës dhe minierat tjera.

Aktualisht, shtrirja e rrjetit të stacioneve monitoruese, për cilësitë fiziko - kimike të ujit, është me sa vijon: në pellgun e Drinit të Bardhë - 24 stacione, në pellgun e Ibrit - 17 stacione, në pellgun e Moravës së Binçës - 6 stacione dhe në Pellgun e Lepencit - 6 stacione.

Fig.1. Tabela e gjendjes së ujit sipas parametrave ndotës në pellgjet lumore. Burimi: IHMK / AMMK / MMPH.

Pellgjet	O_2 I tretur	SHBO5	PE	pH	NO_2	NH4	SO4	PO4	Fosfor	FP	Metale të rënda në VLM
P. D. Bardhë	+	+	+	+	-	0-	+	-	+-	+0	Cr
P.Iber Sitnicë	+-	0	0	0 -	0-	0-	0-	0	+-	+	Cr,Cd,Zn
Morava e Binçes	0+	0	0	0+	0	0	0-	0	0	0+	Cr
Lepenci	+ 0	0	0	0	0	0	0-	0	0	0	Cr

Sqarim: (+) në vlera të lejuara , (0) Vlera e lejuar mesatare, (-) tejkalimi I vlerave te lejuara


Situata e tanishme e ndotjes së trupave ujor është rënduar edhe më shumë nga hedhja e mbetjeve të amvisërisë prej vendbanimeve të afërta dhe nga dukuria tjetër negative e shfrytëzimit të inerteve në shtretërit e lumenjve (më shumë Drini i Bardh, Moravë e Birçes e më pak në Pellgun e Ibrit dhe Lepencit .

Konkluzione:

- Numër i pamjaftueshëm i stacioneve monitoruese dhe të pikave për marrjen e mostrave;
- Lumi Sitnica është më i ndoturi nga të gjithë lumenjtë në Kosovë;
- Mungesë e rrjetit të kanalizimit dhe trajtimi i ujërave të ndotura para shkarkimit tyre në ujërat sipërfaqësor;
- Mungesë e impianteve për trajtim të ujërave industriale dhe urbane;
- Sipërfaqe të degraduara të shtretërve të lumenjve nga nxjerrja e inerteve

Treguesi:	**DEGRADIMI I SHTRETËRVE TË LUMENJVE DHE RREZIKU NGA VËRSHIMET**
Synimi:	MBROJTJA E TRUPAVE UJOR NGA DEGRADIMI DHE NGA VËRSHIMET
Objektivi:	PARANDALIMI NGA DEGRADIMI DHE VËRSHIMET E UJËRAVE SIPËRFAQËSOR

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet sipërfaqet e degraduara për brenda trupave ujore dhe për rreth tyre e që janë nën rrezik permanent prej vërshimeve. Mbrojtja e shtretërve të lumenjve nga degradimi është jetike për boten bimore, shtazore dhe vet faktorin njeri si dhe mbron cilësinë dhe sasinë e tokave bujqësore të kualitetit të lartë, Infrastrukturën, vendbanimet dhe kualitetin e ujit.



Mënyra e matjes së treguesit: Mënyra dhe metoda më e mirë e analizës dhe vlerësimit të gjendjes mjedisore të lumenjve është veprimi i bazuar në gjendjen ekzistuese në terren dhe në studimet e modeleve krahasuese sipas imazheve satelitore të ortofotove 2009 / 2012. Raportet vjetore, të përpunuara nga Departamenti i Ujërave në MMPH, japin vlerat krahasuese të ha/vit. Ky raport i vlerave është në rritje sidomos për shkak të degradimit të sipërfaqeve ujore nga operatoret legal dhe ilegal të zhavorrit. Zbatimi i vendimit të Qeveris së R. Kosovës nr. 02/46, më datë 2 nëntor 2011, i cili ndalon shfrytëzimin dhe eksploatimin e materialeve inerte nga shtretërit, brigjet dhe hapësirat përreth lumenjve në të gjithë territorin e vendit.

Fig. 1. Sipërfaqet e degraduara në Lumin Drini Bardhë sipas analizave në ortofotot e viteve 2009 / 12. Burimi: DU / MMPH.

Burimi i informatës/ave: Burimi i informatave për këtë treguesin është MMPH-ja me të dhënat që merren nga Departamenti i Ujërave dhe IHMK/AMMK.

Kufizimet për matjen e treguesit: Ky tregues është vështirë të implementohet nga se në Kosovë janë paraparë ndërtimi i argjinaturave dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve në gjatësi 491km që sipas vlerësimeve janë konstatuar se sjellin përmbytje . Deri me tani janë rregulluar vetëm 140 km.

Shumë toka bujqësore, infrastrukturë fizike e vendbanime janë të ekspozuar rreziqeve nga përmbytja si pasoj e mos mirëmbajtjes së shtretërve të lumenjve, nxjerrja ilegale e zhavorreve,

hedhja e mbetjeve të amvisërisë dhe të ngurta pranë shtretërve të lumenjve, bimëve të vet rritura etj, e që ndikojnë drejtpërsëdrejti në hapësirën përgjatë dhe për rreth shtratit të lumit.

<u>Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor</u> – Eksploatimi i inerteve në shtretërit e lumenjve është dukuri negative që është e shprehur sidomos pas vitit 1999 e vazhdon edhe sodë edhe për kundër ndalesave te ndryshme që janë te përcaktuara me ligj. Puna ilegale e këtyre aktiviteteve në shtririt e lumenjve është ne rritje e sipër nga operator ilegal. Pasojat janë të mëdha sidomos ne humbjen e sipërfaqeve bujqësore të kualitetit të lartë, shkatërrim i infrastrukturës fizike , vërshimeve në tokat bujqësore dhe ne vendbanime, prishja e shtretërve të lumenjve etj . Lumenjtë që janë degraduar nga veprimet ilegale nga nxjerrja e inerteve si dhe që janë me rrezik për vërshime janë edhe mjedisin ekologjik.



Fig. 2. Paraqitja e degradimeve në shtratin e lumit përmes ortofotove të viteve 2009 - 12. Burimi: MMPH / DU.

<u>Gjendja e treguesit dhe krahasimi</u> – gjendja nuk është e nivelit te mirë dhe ende nuk ka përmasime as për parandalimin e degradimeve e as ne parandalimin e vërshimeve. Degradimet sipas llogaritjeve qe janë ber janë rreth 100 ha/vit. Mirëmbajtja e argjinaturave ekzistuese fare nuk behet, ndërtimi i argjinaturave te reja janë vetëm ne fazën e parafizibilitetit, urbanizimi i shtretërve lumor as qe ka filluar etj këto janë disa mangësi qe nuk është realizuar as një projekt i paraparë me Plan Hapësinor të Kosovës.

Drini i Bardhë	Burimi me bashkë rrjedhën e lumit Istog Bashkërrjedhja nga Istogu në drejtim të Rakovinës Rakovinë deri në Gjonaj	I pa dëmtuar I dëmtuar I dëmtuar
Lumëbardhi i Prizrenit	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Lumëbardhi i Deçanit	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Lumi i Istogut	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Lumi i Klinës	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Lumëbardhi i Pejës	Nga burimi deri në Pejë Nga Peja deri ne grykëderdhje të Drinit të bardhë	I pa dëmtuar I dëmtuar dhe vazhdon dëmi
Lumi i Erenikut	Nga burimi deri në Junik Nga Juniku deri në Shishman Nga Shishmani deri në Gjakovë Nga Gjakova deri në grykëderdhje të Drinit Bardhë	I pa dëmtuar I dëmtuar Me dëmtime evidente Dëmtime evidente
Lumi Ibër	Drejtim i ujë rrjedhës Kushtov - Mitrovicë dhe vazhdim	Dëmtime evidente
Lumi Drenicë, Llap, Sitnicë	Të gjitha degët	I pa dëmtuar
Morava e Binçes	Doberçan, Domarovc, Krivareka në hyrje Kamenicës në Hajnovc, dega e lumit Desivojc në Lajçiç	Me dëmtime evidente dhe te vazhdueshme
L. Lepenci	Nga burimi deri ne Doganaj Nga Doganaj deri në Kaçanik Nga Kaçaniku deri ne kufi me Maqedoninë	I pa dëmtuar Dëmtime të lehta Dëmtime të lehta

Fig. 3. Tabela për gjendjen në shtretërit e lumenjve. Burimi: MMPH.

Pellgu lumor	2009 ha të degraduar	2012 ha të degraduar
Drini i bardhë	970.8	1165.8
Ibër	2.6	4.5
Morava e Binçes	31.5	39.1
Lepenci	0	0
Gjithsejtë	1004.94	1209.4

Fig.4. Tabela për krahasimin e gjendjes se shtretërve te lumenjve. Burimi: MMPH.

Konkluzione:

- Nga të dhënat e mësipërme është e qartë se faktori njëri dhe sjellja e tij ndaj lumenjve është njëri nga shkaktarët kryesor në degradimin e shtretërve të lumenjve;
- Nxjerrja e pakontrolluar dhe ilegale e zhavorrit është faktori tjetër që po ndikon direkt në formën natyrore të shtratit të lumit, i cili shpesh nuk po mundet të përballojë prurjet e ujit pas të reshurave të mëdha. Është e domosdoshme që përmes masave dhe rregullave ligjore të bëhet ndërprerja e aktiviteteve të tilla;
- Të gjitha nivelet e planifikimi dhe menagjimit urban duhet të bëjnë matjet dhe regjistrimin e të dhënave për nivelin e degradimit dhe sipërfaqet e rrezikuara nga vërshimet e lumenjve;
- Faktorët natyror përkatësisht reshjet e mëdha janë njëri nga shkaktarët kryesor që po ndikon dhe po e ndihmon degradimin e shtretërve të lumenjve duke përfshirë edhe sipërfaqe të mëdha të tokave bujqësore që shtrihen në të dy anët e shtretërve;
- Në këtë drejtim është e domosdoshme një përkrahje dhe kujdes më i madh nga institucionet përkatëse si ne nivel qendror dhe atë lokal në riparimi i dëmeve në argjinaturat e dëmtuara, pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve nga mbetjet dhe mbeturinat e shumta, ndërtimin e argjinaturave të reja (sipas studimeve të Hidroekonomies së Kosovës) etj.;

Treguesi:	**PËRDORIMI (SHFRYTËZIMI) I TOKËS (Eurostat: Lan_LU);**
Synimi:	ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM DHE I BALANCUAR HAPËSINOR
Objektivi:	PLANIFIKIMI DHE SHFRYTËZIM RACIONAL I TOKËS

Përshkrimi i treguesit: Toka, si element kryesor mjedisor dhe resurs natyror, është bazë për shumicën e aktiviteteve biologjike dhe njerëzore në planetin tonë. Ky tregues paraqet sasinë e sipërfaqeve dhe raportet e shfrytëzimit (në ha dhe %) të territorit caktuar, sipas klasave dhe nënklasave kryesore (të përvetësuara), të përdorimit të tokës nga aktivitete kryesor bujqësore, pyjore, ujore dhe nga ndërtimet njerëzore (përfshirë banimin, industrinë, tregtinë, turizmin, rekreacionin, infrastrukturën dhe shërbimet e ndryshme).

Përdorimi (shfrytëzimi) i sipërfaqes së tokës		2002			2012		
Klasat	Nënklasat	ha	%	%	ha	%	%
Sip. Tokës Pyjore	Tokë e zënë me Pyje	460 800	42.1	44.7	481 000	44.7	47.4
	Tokë tjetër pyjore	28 200	2.6		29 200	2.7	
Sip. Tokës Bujqësore	Tokë e punueshme	342 400	31.3	45.3	309 000	28.7	43.7
	Livadhe / Kullosa	153 200	14.0		161 400	15.0	
Sip. Tokës ndërtimore	Vendbanime urbane/rurale	40 000	3.7	9.8	48 000	4.5	8.4
	Tokë tjetër ndërtimore	65 000	5.9		42 400	3.9	
Sipërfaqe Ujore	Liqene dhe lumenj	4 600	0.4	0.4	5 200	0.5	0.6
	Ligatina & moçale				800	0.1	
Sipërfaqja totale e tokës		**1 094 200**	**100**	**100**	**1 077 000**	**100**	**100**

Fig. 1. Tabela e pjesëmarrjes kryesore të përdorimit të tokës në Kosovë (me klasat e shtuara nga IPH). Burimi: APK/MBPZhR 2013.

Mënyra e matjes së treguesit: Për të pasqyruar pjesëmarrjen e përdorimit të sipërfaqes së tokës, së pari maten dhe regjistrohen sasitë e sipërfaqeve (në km² ose ha) të përdorimit kryesor sipas klasifikimit të përvetësuar, nga të cilat dalin edhe raportet (në %) të pjesëmarrjes së secilit sektorë në kuadër të sipërfaqes totale të territorit caktuar (Kosovë, Komunë, etj.).

Burimi informatës/ave: Burimi i shfrytëzuar i të dhënave për sasitë e përdorimit të tokës sipas nënklasave është përdorë Raporti më i ri nga APK / MBPZHR, "Inventarizimi Nacional i Pyjeve të Kosovës 2012", Prishtinë 2013.




Fig. 2. Grafiku me nënklasa të përdorimit të tokës në Kosovë. Burimi: APK/MBPZhR 2013.

Kufizimet e matjes së treguesit: Të dhënat për përdorim të tokës janë shumë të rëndësishme për të kuptuar funksionimin e sistemeve mjedisore dhe se vlerësimi periodik i ndryshimeve do të tregoj ndikimet e mundshme njerëzore në resurset natyrore, larminë biologjike dhe ekosisteme. Deri më tani, jemi shërbyer me llogaritje dhe vlerësime nga sektorë të ndryshëm. Ngjashëm me këtë, edhe të dhënat më të fundit, të llogaritura në bazë të 3.453 sipërfaqeve provë, në grafikun dhe tabelën e përdorimit të sipërfaqes së tokës nga APK/MBPZhR, nuk sigurojnë saktësi, por janë në shërbim të krahasimeve të ndryshme të vlerave.

Mirëpo, së shpejti, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), pritet të publikoj rezultatet të proceduara zyrtare nga Regjistrimi Bujqësor i vitit 2014 për përdorimin e sipërfaqes së tokës, që do të jenë më të sigurta dhe në linjë me ato që jepen nga EUROSTAT-i (Agjencia Evropiane e Statistikave) për vendet e BE-së.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Për zhvillimin hapësinor, përveç posedimit (zotërimit) të pronësisë së tokës është shumë me rëndësi edhe shfrytëzimi i tokës si resurs natyror dhe burim ekonomik për zhvillimin e vendit. Ky shfrytëzim i tokës, përbëhet nga dy koncepte të ndërlidhura mes veti, si:

- Zënia e sipërfaqes tokës - që i referohet mbulimit fizik-biologjik të tokës (si zona me të mbjella, me bari, me pyje, me ujë, me ndërtime / ndërhyrje artificiale etj.), dhe
- Përdorimi i sipërfaqes së tokës - që i referohet funksionit të shfrytëzimit socio-ekonomik të saj (si zonat për bujqësi, pylltari, vendbanime, infrastrukturë, etj.).

Informatat për shfrytëzimin (posedimin, mbulesën dhe përdorimin) e sipërfaqes së tokës, formojnë bazën e të dhënave për analiza të ndryshme hapësinore, territoriale dhe të trendit të zhvillimit socio - ekonomik, të cilat gjithnjë e më shumë ndikojnë në arritjen e zhvillimit të dëshiruar strategjik me qëllim të ruajtjes së vlerave natyrore dhe shfrytëzimit racional të tyre në favor të përmirësimit të jetesës në përgjithësi.




Fig. 3. Grafiku me raportet e llojeve kryesor të përdorimit të sip. tokës për 23 shtetet anëtare të BE-së. Burimi: Eurostat 2009.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Ndryshimi i vlerave sasiore të përdorimit të tokës (në ha dhe %), është shkak i proceseve të vazhdueshme që ndodhin në mjedisin tonë jetësor dhe nuk vërehen në baza ditore. Ato janë pasojë e tensioneve që dalin nga konflikti mes kërkesës së popullsisë për më shumë banim/strehim, vende pune, infrastrukturë e shërbimeve dhe nevojës për ruajtje të larmisë biologjike, ekosistemeve, resurseve natyrore e kulturore, të hapësirave të përbashkëta rekreative, etj. Aktualisht, ndër vlerat më të rëndësishme të ndryshuara të përdorimit të tokës në vend, gjatë dhjetë viteve të fundit (shih tabelën), veçojmë:

1. Rritjen graduale prej 2.7 % të sipërfaqes së përgjithshme të tokës pyjore dhe ngritje të sipërfaqes me pyje nga 0.27 në 0.28 ha/b
2. Rënien prej 1.6 % të sipërfaqes përgjithshme të tokës për përdorim bujqësor dhe ulje të sipërfaqes së punueshme nga 0.20 në 0.18 ha/b;
3. Rënien prej 1.4 % të sipërfaqes përgjithshme ndërtimore dhe rritjen prej 0.8 % të sipërfaqes së tokës me ndërtime nga vendbanimet, dhe
4. Rritjen prej 0.2 % e sipërfaqes përgjithshme ujore me kontribut të barabartë nga nënklasat e saj.

Konkluzione:

- Krahasimi i jashtëm (ndër-shtetëror) i rezultateve të drejtpërdrejta (vlerave sasiore), për klasat ose nënklasat e përdorimit të sipërfaqes së tokës, nuk pritet të japin rezultate reale e të krahasueshme, meqë varen nga gjeografia, reliefi dhe lloji i zënies së sipërfaqes së tokës në territorin e vendit caktuar;
- Krahasimi i jashtëm i rezultateve të drejtpërdrejta bëhet vetëm për rezultatet që paraqesin ndryshimet sasiore përbrenda një klase (ose nënklase), përmes një treguesi tjetër ndihmës, si:

sipërfaqja e tokës së punueshme bujqësore për kokë banori, në Kosovë është në limitin kritik prej 0.18 ha/b përderisa në vendet e BE-së është 0.52 ha/b.

- Krahasimi i rezultateve të brendshme (vendore) bëhet përbrenda të njëjtës klasë (ose nënklasë) por në periudha të ndryshme kohore, si p. sh.:
  - Rënia e vlerës së % së përdorimit bujqësor (prej 1.6 %), është pasojë e konvertimit të tokës bujqësore në tokë pyjore, tokë ndërtimore dhe në sipërfaqe ujore, janë ndikuar nga ndryshimet klimatike, ndërtimet legale e ilegale dhe zgjerimit të shtretërve të lumenjve nga gërryerjet dhe vërshimet;
  - Rritja e vlerës së % së tokës ndërtimore (prej 0.8 %), është shkaktuar nga kërkesat e pakontrolluara të lëvizjeve të popullsisë dhe ndryshimeve në ekonomi;
  - Rritja e vlerës së % së sipërfaqes pyjore (prej 2.7 %), është shkaktuar dhe stimuluar nga ndikimi i ndryshimeve klimatike – mjedisore, përmes zgjerimit të habitatit vegjetativ dhe shndërrimit të kullosave në sipërfaqe pyjore, dhe
  - Rritja e vlerës së % së sipërfaqes ujore është rezultat i baraspeshuar i shtimit të pjesëmarrjes së moçaleve dhe ligatinave në këtë klasë dhe i zgjerimit të shtretërve të lumenjve nga gërryerja e bankinave gjatë vërshimeve dhe nxjerrja e pakontrolluar e inerteve.

Treguesi :	**PYLLZIMI DHE RIPYLLZIMI SI MASË ANTIEROZION**
Synimi:	MBROJTJA E PYJEVE DHE TOKAVE PYJORE
Objektivi:	PARANDALIMI I EROZIONIT

Përshkrimi i treguesit: Ky indikator paraqet degradimin e pyjeve nga prerjet ilegale si dhe shpyllëzimet pa kriter që kanë dhen rezultate negative ne mbrojtjen e pyjeve si dhe rritjen e shkallës së erozionit.

Mënyra e matjes së indikatorit: Matja e rritjes vjetore natyrale, e shprehur në Ha ose % për sipërfaqe të pyllëzuara dhe të ripyllëzuara të tokës pyjore dhe në m^3 për vëllimin e masës drunore në pyje, bëhet nga APK (Agjencia e Pyjeve të Kosovës) në kuadër të MBPZhR, që është edhe burimi më i sigurt për këto informata.
Burimi i informatave: Në Kosovë janë dy institucione të burimit të informatave : Agjencia e Pyjeve të Kosovës dhe Agjencinë e Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës**.** APK-ja është përgjegjëse për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike ndërsa AMMK për parqet Kombëtare.
Kufizimet për matjen e Indikatorit: Informatat për treguesin bazohen nga statistikat që janë marr drejtpërsëdrejti nga tereni. Në bazë të studimeve të bëra nga Agjencia Pyjore e Kosovës përveç studimeve shkencore janë theksuar edhe problemet sa i përket mungesës së monitorimit si pasoj e numrit të vogël të monitoruesve si dhe problemet që janë paraqit si rezultat i fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga vet njeriu.

Rëndësia e treguesit për zhvillim hapësinor: Është ndër treguesit kryesor për mbrojtjen e ekosistemit dhe të zhvillimit mjedisor, si një nga 3 shtyllat përbërëse të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili na ofron të dhëna, si për burimet dhe shtrirjen e këtij resursi të nevojshëm natyror në Kosovë ashtu edhe për specifika të ndryshme të Sfidave Zhvillimore, duke marrë parasysh të gjitha interesat tjera publike. Për më shumë, e drejta për ripërtëritje dhe ripyllëzim të sipërfaqeve pyjore, parashihet: si masë për mbrojtje të natyrës, në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L-233 me nenet 8 dhe 48) dhe si masë kundër erozionit, në Ligjin për Ujërat e Kosovës (Nr. 04/L-147 me nenet 51 – 54).



Fig.1. Harta e shtrirjes pyjeve në Kosovë. Burimi: MBPZHR.

Gjendja e treguesit dhe Krahasimi: Kushtet e mira fiziko-gjeografike janë shumë të përshtatshme për rritjen e pyjeve ku mesatarja vjetore e shtimit natyrale është 0.5% ose 2020 ha/vit. Pyllëzim ose farim artificial për periudhë 2002-2012 janë 2800 ha si dhe specie druri te futura (akacie)3200 ha ku mbulushmëria e sip. pyjore zvogëlon aktivitetin eroziv. Pyje te mbrojtura (Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna) janë 59600ha. apo 12.3% e sipërfaqes pyjore. Sipërfaqet e dëmtuara të pyjeve nga sëmundjet e ndryshme, moti i keq, rrëshqitjet, zjarri, prerje ilegale etj. Me rreth 58200 ha apo 12 % e sipërfaqes së

përgjithshme të pyjeve ku zjarret janë dukuri që përfshin sipërfaqen me te madhe degraduese 12200ha ose 2.5% e sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve që ndikojnë në rritjen e shkallës erozive. Rritja vjetore bruto specieve drunore është 1960000m³ ndërsa ikja vjetore (prerje dhe ikje natyrale) është 1862000m³ kurse rritja natyrore është 98000m³ ose 5% në shkallë vjetore .Prerjet vjetore në Kosovë janë më të larta në Evropë qe përafërsisht balancohen me rritjen vjetore . Krahasuar me Sllovenin qe ka prerje vjetore 37% kurse Evropa JL 50%.

Sipërfaqet e dëmtuara e të degraduara të pyjeve, që ndikojnë në rritjen e shkallës erozive në ato zona, sillen rreth 12 % (ose 58.200 ha) të sipërfaqes së përgjithshme, shkaktohen nga zjarret (me 2.5 % ose 12.200 ha), sëmundjet e ndryshme, moti i keq, rrëshqitjet, prerjet ilegale, etj. Mirëpo, referuar "Strategjisë për zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020", në Kosovë, rreth 70% të territorit pyjor mbulohet me plane menaxhimi, që këtë tregues e bënë mjaft perspektivë në kuadër të përafrimit me Bashkimin Evropian. Ngaqë, BE-ja (më 2006), kishte miratuar Planin e Veprimit për Pyjet 2007 – 2013, duke ofruar një kornizë aktivitetesh të ndërlidhura me komunitetin, në nivel të shteteve anëtare, me objektivin e përgjithshëm: Mbështetja e zgjerimit për menaxhim të qëndrueshëm pyjor dhe sigurimi i rolit shumë funksional të pyjeve.
Përndryshe, pyjet e mbrojtura (në kuadër të Parqeve Kombëtare: Mali Sharr dhe Bjeshkët e Nemuna), që përbëjnë rreth 12.3 % (me 59.600 ha) të sipërfaqes tërësishme pyjore në Kosovë, janë përgjegjësi e MMPH-së.

Pyjet në Kosovë	2003-2004	2012-2013	Rritje vjetore (në Ha & m³)
Sektori privat (ha)	185.920	180.800	
Sektori publik (ha)	278.800	295.200	
E pa njohur (ha)	0	5000	
Sipërfaqe totale pyjore (në ha)	464.720	481.000	**2.020 (0.5%)**
Vëllimi total (në m³)	33,9 milion	40,5 milion	**0.8 mil.(2 %)**

Fig. 2. Tabela e rritjes vjetore të pyjeve. Burimi: MBPZhR.

Konkluzione:


- Sipas informatave të mësipërme duhet të shtohet niveli i monitorimit i cili në shumë raste është i pa mjaftueshëm. Arsye për këtë është humbja e masës shumë të nevojshme drusore që po ndodhë nga prerjet ilegale;
- Masë e nevojshme dhe preventive në këtë drejtim është mirëmbajtja e pyjeve përkatësisht meliorimi i pyjeve dhe i kullosave dhe intervenimi bio-kimik ne zonat qe dëmtohen nga sëmundjet e ndryshme;
- Zbutja e erozionit është masë tjetër e rëndësishme me ndikim direkt në mbrojtjen e vlerave mjedisore. Në hapësira dhe vende të caktuara është e domosdoshme ndërtimi i pritave, gardianeve, gardheve dhe pandave që ndihmojnë në eliminimin e erozionit.
- Në përgjithësi duhet të shtohen aktivitete dhe të vendosen rregulla që janë në favor të mbrojtjes së mjedisit të gjelbër që në mënyrë indirekte ndikojnë edhe në zbutjen e shkallës së erozionit.

Treguesi:	**POTENCIALI I TOKËS BUJQËSORE**
Synimi:	MBROJTJA, RUAJTJA DHE SHFRYTËZIMI RACIONAL I RESURSEVE NATYRORE
Objektivi:	MENAXHIMI EFIKAS I TOKËS SË PËRSHTATSHME BUJQËSORE

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet potencialin e tokës bujqësore në Kosovë, të klasifikuar sipas përshtatshmërisë (cilësisë, klimës dhe terrenit) saj për përdorim nga sektori bujqësor, të mbështetur në modelin "Përshtatshmëria e Tokës Bujqësore (PTB)", të ndërtuar në Udhëzuesin për Planifikim Hapësinor Rural, si pjesë e Sistemit Kombëtar për Vlerësim dhe Planifikim të Menaxhimit të Tokës, i dalë nga projekti i BE-së: Mbështetje e Mëtutjeshme e Shfrytëzimit Tokës (EULUP)[29] 2012.

Përshtatshmëria	Cilësia e tokës	Kodi	Grupet e shfrytëzimit të tokës
0	E Papërshtatshme	8	Tokë pyjore që pamundëson kultivimin e kulturave bujqësore
1-35	Shumë e dobët	7	Tokë e dobët, me pengesa të mëdha kultivuese, kryesisht kullosa & livadhe;
36-45	E dobët	6	
46-55	Nën mesatare	5	Tokë bujqësore me disa kufizime për kultivim e kulturave bujqësore
56-65	Mesatare	4	
66-75	Mbi mesatare	3	
76-85	E mirë	2	Tokë e mirë lavërtarie për kultivimin e kulturave bujqësore
86-100	Shumë e mirë	1	

Fig. 1. Tabela me 8 klasat e tokës bujqësore me ndarje për nga përshtatshmëria, cilësia dhe mënyra e shfrytëzimit. Burimi: Projekti i BE/EULUP.



Mënyra e matjes së treguesit: Realizimin e matjes së këtij treguesi duhet bërë përmes identifikimit dhe shtrirjes hapësinore dhe më pas maten sipërfaqet për të tetë (8) klasat e tokës bujqësore, sipas modelit të ndërtuar nga projekti i BE-së "EULUP" për tërë territorin e Kosovës(fig. 2).

Fig. 2. Harta e shtrirjes së 8 klasave sipas Përshtatshmërisë së Tokës Bujqësore në Kosovë. Burimi: Projekti i BE/EULUP.

Klasifikimi për nga përshtatshmëria (cilësia dhe mënyra përdorimit) e tokës bujqësore bazohet në të dhëna relevante të rëndësisë së përgjithshme (që përbëjnë 100 %), duke përfshirë vetitë fizike të tokës (me 65 % pjesëmarrje), të veçorive të tjera si relievi, ndryshimet hapësinore dhe

[29] Projekti Nr. 2010/230-489 i BE / ZNKE-së, EULUP - Mbështetje e Mëtutjeshme e Shfrytëzimit Tokës, Raporti Nr. 17 "Udhëzues për Planifikim Hapësinor", Prishtinë 2012.

rregullimi peizazhit (me 25 %) si dhe kushtet klimatike (me 10 %). Rezultatet e sipërfaqeve, sipas klasave të dhëna në modelin e PTB-së shprehen si vlera numerike dhe njësia saj në km² (ose ha) kurse pjesëmarrja e tyre nxirret si % në kuadër të sipërfaqes përgjithshme të Kosovës .

Burimi i informatës/ave: Ekzistojnë shumë burime të dhënash për treguesin, nga institucionet shkencore, publike dhe qeveritare të nivelit qendror dhe lokal, por modeli gjenerues është në Bazën e të Dhënave në IPH (ose në Raportin Teknik Nr.17, "Udhëzues për Planifikim Hapësinor", Projekti i BE-së me Nr. 2010/230-489, EULUP: Mbështetje e Mëtutjeshme e Shfrytëzimit Tokës 2012), të njohur si "Sistemi Kombëtar për Vlerësim dhe Planifikim të Menaxhimit të Tokës".

Kufizimet për matjen e treguesit: Kategorizimi dhe cilësia e tokës në Kosovë, tani është vlerësuar duke e zhvilluar një Sistem Kombëtar për Përshtatshmërinë e Tokës Bujqësore (PTB), meqë, "klasat e kadastrave" të deritanishme nuk i plotësonin nevojat moderne të planifikimit hapësinor e urban. Grupi i ekspertëve nga BE-ja, në kuadër të projektit "EULUP", kanë analizuar të dhënat aktuale të tokës, klimës dhe terrenit në Kosovë, duke ekzaminuar edhe të dhëna tjera të klasifikimit të përshtatshmërisë së tokës në vendet e rajonit dhe gjetkë, dhe në fund krijuan një klasifikim specifik që i përshtatet më së miri nevojave të këtij vendit, të dhënave në dispozicion dhe se është në përputhje me metodat e FAO-s (Food and Agriculture Organization of the United Nations).

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Ka të bëjë me rëndësinë e gjetjes së potencialit të tokës bujqësore, të ndarë në 8 klasa sipas përshtatshmërisë të bazuar në faktorët ndikues mjedisor, të kushteve klimatike e të mundësisë së përdorimit terrenit dhe të cilësisë fizike të saj, për planifikimin dhe menaxhimin e politikave kombëtare për zhvillimin ekonomik dhe për sigurimin e ushqimit për popullsinë e vendit. Është shumë me rëndësi, që hartat në Sistemin Kombëtar të përgatitura nga EULUP-i të shërbejnë për kornizë bazë dhe të integrohen me prioritetet strategjike komunale dhe të reflektojnë zgjidhje në nivel vendi (ose qendrore). Përderisa, në mënyrë të ngjashme, edhe informatat e mbledhura nga vendbanimet urbane dhe rurale, të cilat, do të përditësohen me të dhëna më të reja dhe të hollësishme, do të integrohen dhe reflektojnë në zgjidhjet me prioritete dhe interesa komunale.

Klasat nga PTB	Gjith. sip. e tokës në km²	Sip. tokës bujqësore në km²	% e Tokës Buj. sipas klasave	Cilësia e T. Bujq. & %
1	1054.51	907.01	20.77	1 – 4 81.32 %
2	1279.84	1014.84	23.24	
3	1354.42	956.36	21.90	
4	1445.45	672.35	15.40	
5	1323.13	374.00	8.57	5 – 8 18.68 %
6	989.06	186.25	4.27	
7	490.37	71.20	1.63	
8	2871.32	184.20	4.22	
Total	10808.1	4366.21	100.00 %	100.00 %

Fig. 3 Tabela e shpërndarjes së sipërfaqes (km²) dhe pjesëmarrja (%) brenda klasave të PTB-së. Burimi: Projekti i BE/EULUP.




Fig. 4 Grafiku i shpërndarjes së % nëpër sektorët urban, bujqësor dhe pyjor në klasat kryesore të PTB sipas MTC (Mbulesa e Tokës CORINE) 2006. Burimi: Projekti i BE/EULUP.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Ky tregues paraqet potencialin e tokës bujqësore, sipas modelit të ndërtuar për Përshtatshmërinë e Tokës Bujqësore (PTB), në kuadër të Sistemit Kombëtar për Vlerësim dhe Planifikim të Menaxhimit të Tokës, për territorin e Kosovës (si në fig. 1, 2, 3 dhe 4).

Nga këtu, vërehet se, Kosova ka potencial të mjaftueshëm të tokës bujqësore për sigurimin e ushqimit të nevojshëm për popullsinë e vet, me mesataren e sipërfaqes së përgjithshme për kokë banori prej 0.25 ha/b, që është afër kufirit kritik prej 0.17 ha/b dhe larg mesatares së BE-së prej 0.52 ha/b. Për më tepër, në këto zona, që shtrihen kryesisht në pjesët e rrafshëta dhe përskaj luginave lumore, njëkohësisht gjenden edhe vendbanimet më të mëdha të Kosovës, të cilat, përditë e më shumë kanë kërkesa për zgjerime të mëtejme, përkundër faktit se për rreth tyre shtrihet toka me përshtatshmëri dhe me cilësi më të lartë bujqësore, që i përkasin klasave 1 – 4 dhe përfshijnë mbi 80 % të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore.


Konkluzione:

- Në Kosovë, pas luftës së fundit, janë bërë zhvillime stihie, të pakoordinuara me ndërhyrje të pakontrolluara në mjedis, si shkak i lëvizjeve të popullsisë dhe të nevojës tyre për strehim/banim dhe zhvillim ekonomik (ndërtimet urbane për shërbime publike, sociale, kulturore, tregtare e komerciale, infrastrukturë, transport, rekreacion, industri, etj.);
- Kërkesat e shumta të popullsisë për këto zhvillime të paplanifikuara dhe pa monitorim efikas të zbatimit tyre kanë atakuar tokën më cilësore dhe më të përshtatshme bujqësore dhe për pasojë sollën konvertimin e saj në tokë ndërtimore – zhvillimore urbane;
- Toka bujqësore duhet të mbrohet e të ruhet si resurs natyror dhe të përdoret vetëm për qëllime bujqësore në mënyrë që të sigurohet prodhim i mjaftueshëm me qëllim të plotësimit të nevojave të popullsisë dhe më pas edhe për eksport të këtyre prodhimeve që do të ndikonte edhe në përmirësimin e bilancit tregtar ekonomik të vendit;
- Prandaj, ndaj kësaj kategorie të tokës bujqësore që kërkon një përkujdesje dhe menaxhim efikas (mbrojtje, ruajtje, trajtim, planifikim dhe shfrytëzim racional), nevojitet përkushtim më serioz i të gjithëve, me qëllim të:
    - Realizimit të politikave qeverisëse për zhvillim të vendit,
    - Arritjes së synimeve dhe të objektivave kryesore të sektorit bujqëor, dhe
    - Përfitimit ekonomik ose të sigurimit të ekzistencës për më shumë se gjysmën e popullsisë së Kosovës e cila merret vetëm me aktivitete bujqësore.

Treguesi:	**POTENCIALI I TOKËS NDËRTIMORE**
Synimi:	MBROJTJA, RUAJTJA DHE SHFRYTËZIMI RACIONAL I RESURSEVE NATYRORE
Objektivi:	MENAXHIMI I POTENCIALIT TË TOKËS SË PËRSHTATSHME PËR NDËRTIM

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet potencialin e tokës ndërtimore në Kosovë të mbështetur në modelin e projektit të EULUP-it të njohur si "Plani i Zonave Ndërtimore (PZN). PZN përbëhet nga shumë shtresa të të dhënave hapësinore të cilat reflektojnë kufizime të zhvillimeve hapësinore duke u mbështetur në legjislacionin Kosovar në fuqi. PZN-ja është informatë rasterike në GIS të cilën e posedon MMPH-ja. Në bazë të PZN-së mund të llogariten se cilat sipërfaqe janë të përshtatshme për ndërtim sipas kritereve të dhëna në këtë model. PZN jep restrikcionet për 16 veçori hapësinore.

Mënyra e matjes së treguesit: Mënyra e matjes së këtij treguesi është përmes kufizimeve të dhëna në ndërtimin e këtij modeli. Kufizimet janë faktorë që tregojnë se cilat sipërfaqe nuk kanë kufizime fare (0) dhe atyre që kanë kufizime (1 – 16), siç shihen në fig. 1 dhe janë renditur në vijim:



0. Pa kufizime,
1. Përshtatshmëria e tokave bujqësore - klasa 1-4,
2. Ndjeshmëria e tokës ndaj erozionit >75,
3. Hapësirat me biodiversitet të vlerësuar >75,
4. Shkalla hipsometrike >1200 m,
5. Ndjeshmëria e ujërave nëntokësor >75,
6. Zonë e rezervuar për miniera,
7. Hapësirat nën ujitje,
8. Zonat e ruajtura natyrore,
9. Rrjeti i largpërçuesve 100 m buffer,
10. Zonat e rrezikuara nga vërshimet,
11. Zona e ujërave të mbrojtura,
12. Guroret,
13. Lokacionet e trashëgimisë kulturore,
14. Zonat e minuara,
15. Aeroportet dhe kufizimit rreth tyre,
16. Monumentet e natyrës.

Fig. 1. – Plani i Zonave të Ndërtimit (PZN) sipas kufizimeve në Kosovë. Burimi: EULUP.

Burimi i informatës/ave: Për këtë tregues ka disa burime të informatave që përfshijnë shumë institucione qeveritare dhe publike në Kosovë, ndërsa modeli gjenerues është në IPH.

Kufizimet për matjen e treguesit: Ky tregues në përgjithësi tregon dy zona në Kosovë që kanë të bëjnë me zona që ka kufizime dhe zona që nuk ka kufizime të zhvillimeve hapësinore. Dobësia e këtij treguesi janë mos azhurnimi me ndryshimet aktuale që kanë ndodhë në hapësirë dhe fakti që nuk tregon zonat me kufizime ose jo jashtë zonës aktuale të ndërtimit. Kjo dobësi mund të eliminohet atëherë kur sigurohen të dhënat në GIS (Geographic Information System) për kufijtë e zonave aktuale ndërtimore.

Rëndësia e treguesit për zhvillim hapësinor: Ky tregues është i rëndësishëm për shkak që mundëson gjetjen e zonave që nuk kanë kufizime të zhvillimeve hapësinore dhe zonave që kanë shkallë të caktuar të kufizime për zhvillime hapësinore. Ky tregues është i rëndësisë së madhe sepse mundëson krahasimin e potencialit të tokës ndërtimore sipas regjioneve dhe komunave në Kosovë, i cili do të shërbejë për lokalizimin dhe shtrirjen e zonave të ardhshme të ndërtimit në Kosovë dhe sipas komunave.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Ky tregues paraqet potencialin e zonave ndërtimore në Kosovë sipas kufizimeve ose jo kufizimeve, duke mos përfshirë zonat aktuale ndërtimore si dhe ndryshimet e bëra deri më tani në territorin e Kosovës. Sipas PZN-së, sipërfaqja totale e territorit të Kosovës sipas 16 faktorëve me kufizime dhe sipërfaqeve pa kufizime është si në grafikun në vijim:




Fig. 2. Grafiku i Pjesëmarrjes së Zonave Kufizuese në Kosovë (në km^2). Burimi: Projekti i BE/EULUP.

Bazuar në PZN, Kosova ka 18.11% ose 1972.74 km^2 të territorit të sajë si tokë të përshtatshme për ndërtim, ndërsa pjesa tjetër e mbetur shtrihet në njërën ose në disa nga 16 faktorët kufizues të modelit, e që paraqesin kufizime për zhvillim (ose ndërtim) të ardhshëm.

Ndërsa gjendja sipas komunave është si në vijim:

Fig. 3. Tabela me sipërfaqe sipas faktorit kufizues nëpër komuna të Kosovës (në km^2). Burimi: Projekti i BE/EULUP.

Komuna/Faktori	0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
Ferizaj	36.205	180.19	20.28	28.0525	19.8725	26.81	3.7275	0	0	21.945	6.015	0.1275	1.205	0.0075	0	0	0.125
Drenas	51.89	130.78	4.365	3.3375	0	2.47	15.625	47.7475	0	11.795	2.5425	0.5975	2.005	0	2.1275	0	0.38
Istog	14.85	158.215	32.2675	17.01	122.9675	27.1075	7.945	56.1125	0	13.5475	0.8825	0.835	1.1875	1.4375	0	0	0
Klinë	45.095	194.3275	1.8375	0	0	35.115	13.8725	0	1.7825	3.795	6.0325	2.3725	3.075	0.685	0.51	0.0225	0.495
Leposaviq	192.61	46.0375	122.8775	62.6825	54.805	0	42.96	0	0	5.5525	0.74	2.17	1.58	0.41	1.68	0	0
Malishevë	57.765	198.6225	14.47	3.835	0	5.9625	16.53	0	1.605	5.365	0.62	0.13	0.85	0.0075	0.465	0	0.2575
Obiliq	3.4675	33.16	1.1325	0.0275	0	9.535	21.3075	15.105	0	17.4625	2.98	0	0.4225	0.24	0	0	0
Pejë	29.72	94.0075	27.185	19.265	240.5475	77.8825	3.7375	49.15	42.105	9.22	2.24	0.3875	4.5025	2.305	0	0	0.2575
Podujevë	156.835	215.5075	42.4725	59.2675	36.965	42.8675	35.355	0	0	21.255	10.6825	6.43	2.8275	0	0.46	0	0.7575
Rahovec	41.3775	146.9375	9.535	1.8525	0	12.0775	18.69	28.25	0.0525	7.3775	4.64	0.365	1.815	2.155	0.78	0	0
Shtime	28.485	52.325	20.265	9.3225	0.0025	7.89	7.885	0	0	3.64	2.405	0	2.105	0	0	0	0.125
Skenderaj	61.9525	268.305	8.685	9.01	0	8.0625	4.45	0	0	10.4475	0	1.2375	1.3425	0.845	0	0	0
Suharekë	86.42	113.3325	59.7675	25.12	17.65	17.3775	4.92	0	24.82	8.325	0.8275	0.1775	1.55	0.6975	0	0	0
Zubin Potok	69.855	31.27	92.2725	62.3525	37.535	2.47	14.31	0	0	3.8175	0.5175	14.3125	0.895	0.905	0	0	0

Zveçan	44.8075	17.0175	25.8175	14.15	2.1825	2.6825	4.455	0	0	6.7925	0.7825	0.7075	0.6275	1.5125	1.2625	0	0
Gjakovë	100	265.0925	37.9875	8.3475	18.255	84.355	14.7775	19.9325	0	20.875	3.8225	9.77	1.7775	0.8675	0.2725	0.5025	0
Vushtri	47.0825	143.725	13.255	18.56	3.92	7.8875	15.9375	76.455	0	12.7875	2.35	0.9125	1.7525	0.015	0.185	0	0
Fushë Kosovë	5.6575	25.53	0.195	0.0025	0	8.44	35.0425	0	0	7.175	0.605	0.1675	0.7975	0.5	0	0	0
Mamushë	0.3175	5.295	0.0975	0	0	4.5275	0	0	0	0.7075	0	0	0	0	0	0	0
Partesh	8.5125	8.85	0.5075	0.025	0	5.6075	0.5875	0	0	2.18	2.18	0.09	0.1275	0	0	0	0
Deçan	5.3975	26.245	9.675	15.92	131.3225	7.2475	0.1475	83.21	0	5.165	0.0625	0.46	0.85	7.915	0	0	0.375
Junik	2.68	22.075	3.855	6.2575	39.09	1.7825	0.9075	0.3725	0	0	0	0	0.7425	0	0	0	0
Novoberdë	85.1125	69.6375	11.2875	9.28	0	0.3375	17.4	0	0	8.3	0	0.1075	1.5125	0.7625	0.23	0	0
Lipjan	49.7875	150.375	33.865	6.7275	0	10.635	54.2875	2.9025	0.34	10.875	5.97	0.345	1.955	0.4	5.085	4.5925	0.27
Hani I Elezit	34.2425	6.14	30.655	4.2125	0.0225	0	2.34	0	0	4.0525	0	0.4875	0.39	0	0	0	0
Kaçanik	37.73	44.53	67.3475	13.67	0.0075	4.27	2.1	0	22.0375	16.5925	0.4725	0.125	2.465	0	0	0	0
Gjilan	138.7225	132.5625	37.9175	12.1375	0	11.315	44.495	0	0	7.9725	0.7575	2.54	2.09	0.125	0	0	0.255
Prizren	105.7175	104.5375	91.645	38.7	50.2675	26.185	23.755	46.105	110.5825	19.295	0.5275	4.6975	2.6725	1.785	0	0	0.375
Dragash	22.4175	29.2125	12.53	25.0875	310.2575	1.1	13.1075	0	14.55	3.4325	0	0.2925	0.6225	0.075	0	0	0
Shterpcë	25.4925	12.345	20.5925	26.81	30.375	0	0.6725	0	128.6375	1.77	0	0	0.7025	0.105	0.18	0	0
Graçanicë	1.4425	22.065	1.2625	0.0425	0	3.575	72.13	0	0	15.225	0.93	2.18	0.705	1.7	1.1675	0	0
Prishtinë	108.595	129.7825	147.325	44.2925	0.1325	11.48	26.6125	7.805	8.9625	29.18	0.945	5.295	1.735	0.3975	0.5825	0	0
Ranillug	24.595	30.56	2.535	1.7575	0	4.865	7.1425	0	0	4.3525	0.8425	0.12	0.83	0	0	0	0
Kamenicë	126.335	121.8675	41.28	30.1625	0.1575	15.0475	74.535	0	0	3.6425	0.34	0.265	2.475	0	0	0	0
Viti	54.95	104.9075	49.6875	12.9625	3.5175	19.615	12.01	0	0	3.975	5.5075	1.255	1.1425	0.0925	0	0	0
Kllokot	2.5475	6.8975	1.78	0.05	0	9.2325	0.41	0	0	1.4925	0	0.6175	0.385	0	0	0	0
Mitrovicë Veriore	1.0925	2.0925	0.0625	0	0	0.23	0.0775	0	0	1.485	0.005	0.0225	0.0275	0.3675	0	0	0
Mitrovicë	62.9775	64.7475	35.79	51.1225	73.2125	5.95	13.1425	4.9025	0	11.8025	1.1475	1.0925	2.04	0	2.785	0	0
Totali	1972.74	3409.108	1134.365	641.4125	1193.065	521.995	647.3875	438.05	355.475	342.6725	68.3725	60.6925	53.7875	26.3115	17.7725	5.1175	3.6725
%	18.11	31.30	10.41	5.89	10.95	4.79	5.94	4.02	3.26	3.15	0.63	0.56	0.49	0.24	0.16	0.05	0.03

Konkluzionet:

- Aplikimi i kufizimeve të vazhdueshme kryesisht të karakterit mjedisorë dhe bujqësorë e kufizon edhe potencialin e tokës ndërtimore.
- Mos azhurnimi i gjeo-informacioneve mbi të cilat është ndërtuara modeli i potencialit të tokës ndërtimore ose PZN-ja krijon rezultatet jo reale edhe për potencialin dhe vendndodhjen e këtyre zonave.
- Pavarësisht disa kufizimeve ky tregues mundëson përcjelljen e trendit të shfrytëzimit të potencialit të tokës ndërtimore dhe lokalizimin e kësaj kategorie të tokës.
- Ndër Objektivat më të rëndësishme për monitorimin e këtij treguesi do të jenë:
  1. Rishikimi i faktorëve dhe parametrave të modelit apo rishikimi i pjesshëm i përmbajtjes së modelit;
  2. Azhurnimi i informacioneve gjeografike në bazë të së cilave është ndërtuar ky model;
  3. Krijimi i informacioneve gjeografike me rezolucion më të detajuar hapësinor;
  4. Sforcimi ligjor i këtij modeli dhe detyrimi i komunave që zgjerimin e zonave ndërtimore ta bëjnë sipas PZN-së.

Treguesi:	**VENDBANIMET JOFORMALE (VBjF)**
Synimi:	PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË JETESËS
Objektivi:	PARANDALIMI DHE ZVOGËLIMI I NUMRIT TË VBjF-ve (FORMALIZMI TYRE)

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet numrin e vendbanimeve joformale në nivel vendi dhe të ndara (regjistruara) edhe sipas njësive lokale administrative në fuqi.

Mënyra e matjes së treguesit: Procesi i identifikimit të vendbanimeve joformale është bërë dhe përfunduar nga MMPH-ja, ku në vitin 2010 është punuar edhe raporti mbi gjendjen e vendbanimeve joformale në Kosovë, në bazë të cilit janë të identifikuara 174 VBjF. Mënyra e matjes së këtij treguesi është përmes raporteve që nxjerr MMPH-ja kohë pas kohe. Ky tregues do të matet përmes këtyre nën tregueseve:

- Numri i vendbanimeve joformale;
- Numri i banorëve në vendbanimet joformale;
- Struktura etnike dhe socio-ekonomike e popullsisë në vendbanimet joformale;
- Shkalla e investimeve zhvillimore (kapitale) dhe urbanizimi tyre.




Fig. 1. Vendbanimet joformale në komunën e Mitrovicës (2010). Burimi: MMPH/DPH "Raporti i gjendjes së VBjF" 2010.

Burimi i informatës/ave: Burimi kryesor i sigurimit të informatave për këtë tregues janë MMPH-ja dhe drejtoritë përkatëse komunale.

Kufizimet për matjen e treguesit: Ky tregues momentalisht nuk mund të trajtohet për shkak se nuk ka informata krahasuese. Raporti i vetëm zyrtarë për vendbanimet joformale është "Raporti i Gjendjes së Vendbanimeve Joformale në Kosovë i botuar në vitin 2010.

Mënyra e vlerësimit të vendbanimeve joformale shtron nevojën për tu diskutuar seriozisht dhe në mënyrë objektive. Se si një vendbanim joformal largohet nga lista e vendbanimeve joformale (... kur bëhet formal) duhet të trajtohet në mënyrë më të thellë. Sipas praktikës aktuale një vendbanim joformal largohet nga lista e vendbanimeve joformale në momentin kur ai vendbanim përfshihet dhe trajtohet nga dokumentet e planifikimit në nivel lokal (PZHK, HZK, PZHU ose edhe PRrH (PRrU)). Duke marr në konsideratë nivelin e dokumenteve të planifikimit dhe shkallën e implementimit të të tyre, konsiderojmë se ky vlerësim nuk është adekuat dhe për më tepër i pa favorshëm për banorët e këtyre vendbanimeve.

Përveç raportit të gjendjes së vendbanimeve joformale të vitit 2010 nuk kemi ndonjë raport tjetër që tregon gjendjen e vendbanimeve joformale pas vitit 2010.

Rëndësia e treguesit për zhvillim hapësinor: Ky tregues është i rëndësishëm për shkak që do të mundësojë identifikimin e vendbanimeve joformale në nivel vendi dhe komune, si dhe do të mundësojë trendin e rritjes ose zvogëlimit të numrit të vendbanimeve joformale duke u fokusuar edhe në analizimin kushteve të jetës në këto vendbanime përmes shkallës së investimeve në projektet kapitale dhe zhvillimor. Rregullimi i vendbanimeve joformale është detyrë dhe obligim i planeve përkatëse hapësinore që përfshijnë territorin e këtyre vendbanimeve.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Në bazë të raportit mbi gjendjen e vendbanimeve joformale të vitit 2010, numri i përgjithshëm i vendbanimeve joformale në Kosovë është 174. Sipas këtij raporti, numrin më të madh të vendbanimeve joformale e kanë komunat si: Klina 20, Gjilani 17, Graçanica 15, Skenderaj 10, Peja 10, Deçani 9, Vushtrria 9, Lipjani 9, e kështu me radhë. Për më tepër shiko figurën nr. 2.




Fig. 2. Grafiku me numrin e Vendbanimeve joformale sipas komunave në Kosovë (2010)

Konkluzione: Mënyra e identifikimit, trajtimit dhe largimit nga lista e vendbanimeve joformale të një vendbanimi joformal është në interes nacional për tu diskutuar në mënyrë objektive dhe sidomos kriteri i largimit të një vendbanimi joformal nga lista kryesore. Trajtimi sipërfaqësorë i kësaj çështje krijon mundësi reale për rritjen e kësaj kategorie të vendbanimeve dhe mund të shkaktoj probleme të shumta (sociale, pronësore, ekonomike dhe shëndetësore) për banorët e këtyre vendbanimeve.

Objektivat më me rendësi për monitorimin e këtij treguesi do të mund të ishin si në vazhdim:

1. Identifikimi i hapësinor i VJF me kufijtë e tyre të saktë në GIS;
2. Rishikimi i kritereve për identifikimin e vendbanimeve joformale;
3. Vendosja e kritereve objektive kur një VJF mund të dali nga lista e VJF;
4. Zhvillimi i studimeve socio-ekonomike dhe pronësoro-juridike për secilin VJF;
5. Zhvillimi i projekteve dhe programeve të veçanta që mund të trajtojnë një problem të vetëm ose disa probleme bashkërisht në VJF.

Treguesi:	**NUMRI I NDËRTIMEVE PA LEJE**
Synimi:	PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË JETESËS
Objektivi:	URBANIZIMI DHE LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet numrin e ndërtimeve pa leje në nivel vendi dhe të ndara edhe sipas njësive lokale administrative në fuqi ose në ndarje tjetër specifike për nevoja statistikore.

Mënyra e matjes së treguesit: Në Kosovë, procesi i trajtimit të ndërtimeve pa leje është në vazhdim e sipër si pjesë e punës së MMPH-së për implementimin e Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje me Nr. 04/L-188. Në Ligjin për Ndërtim me Nr. 04/L-110, neni 15 tregon ndarjen e kategorive të objekteve për lëshimin e lejes ndërtimore sipas nivelit të rrezikshmërisë, si:

1. Kategoria I - ndërtimet me rrezikshmëri të ulët,
2. Kategoria II - ndërtimet me rrezikshmëri të mesme, dhe
3. Kategoria III - ndërtimet me rrezikshmëri të lartë dhe me interes nacional.

Ndërsa, neni 19 tregon për kompetencat e subjekteve për lëshimin e lejes ndërtimore, ku MMPH-ja është përgjegjëse për objektet e kategorisë së III-të dhe komunat janë përgjegjëse për objektet e kategorisë së I-rë dhe të II-të. Po ashtu, edhe përgjegjësia për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje, i takon MMPH-së për kategorinë e III-të dhe komunave për kategorinë e I-rë dhe të II-të.



Fig. 1. – Harta e ndërtimeve pa leje në Kosovë. Burimi: RShNPL[30] 2015.

Matja e këtij treguesi bëhet përmes Regjistrit Shtetëror të Ndërtimeve Pa Leje (RShNPL), që zhvillohet në MMPH, në bazë të informatave dhe raportimeve që vijnë nga komunat, të mbështetura me të dhëna për nën treguesit si: në vijim:

- ✓ Numri i ndërtimeve pa leje;
- ✓ Numri i lejeve ndërtimore të lëshuara nga drejtoritë përkatëse brenda vitit;
- ✓ Numri i refuzimeve të lejes ndërtimore të lëshuara nga drejtoritë përkatëse brenda vitit;
- ✓ Periudha kohore e pritjes për leje ndërtimore;
- ✓ Numri i ankesave në organet kompetente;

[30] MMPH / DPHBN, Regjistri Shtetëror I Ndërtimeve Pa Leje, Prishtinë 09.09.2015.

✓ Numri i rrënimeve.

Burimi i informatës/ave: Burimet kryesore dhe të vetme për marrjen e informatave për këtë tregues janë MMPH / DPHBN dhe Komunat e Kosovës / Drejtoritë e Urbanizmit dhe të Inspektoratit.

Nr.	Kategoria	Komuna	Nr. objekteve
1		Deçan	11893
2		Dragash	12314
3		Ferizaj	32721
4		Fushë Kosovë	7453
5		Gjakovë	8501
6		Gjilan	32128
7		Gllogoc	14152
8		Gracanicë	2617
9		Hani i Elezit	2000
10		Istog	3874
11		Junik	917
12		Kaçanik	8691
13		Kamenicë	915
14		Klinë	12016
15		Kllokot	33
16		Leposaviq	6
17		Lipjan	15783
18		Malishevë	19780
19		Mamushë	1
20	I - II	Mitrovicë e Jugut	8134
21		Novobërdë	6
22		Obiliq	3550
23		Partesh	0
24		Pejë	13568
25		Podujevë	4796
26		Prishtinë	46528
27		Prizren	27900
28		Rahovec	14822
29		Ranillug	1766
30		Shtërpce	530
31		Shtime	9766
32		Skënderaj	5967
33		Suharekë	15333
34		Viti	3190
35		Vushtrri	9738
36		Zubin Potok	1
37		Zveçan	5
38		Mitrovicë e Veriut	1441
	III	**MMPH**	849
TOTAL			**353685**

Kufizimet për matjen e treguesit: Kufizimet për matjen e këtij treguesi ndërlidhen me disa komuna të cilat nuk e kanë filluar procesin e regjistrimit të ndërtimeve pa leje në territorin e tyre si pjesë e projektit shtetëror për përpilimin e RShNPL-së. Këto, kryesisht janë komuna që menaxhohen nga minoritetet në Kosovë, të cilat procesin e regjistrimit të ndërtimeve pa leje në territorin e tyre e ndërlidhin me çështje politike. Ndërsa, vështirësitë tjetër do të jetë edhe natyra e mekanizmit raportues nga niveli lokal në atë qendror, për ndërtimet pa leje të cilat kanë ndodh pas datës 30 gusht 2013 e të cilat i nënshtrohen ligjit për Ndërtim.


Rëndësia e treguesit për zhvillim hapësinor: Ky tregues është i rëndësishëm për shkak që do të mundësojë identifikimin e çdo objekti të ndërtuar pa jele dhe do të mundësoje krijimin e hartës së përgjithshme të ndërtimeve pa leje të cilat do të shqyrtohen dhe prezantohen edhe në Hartën Zonale të Kosovës dhe Komunës.

Me anë të këtij treguesi do të bëhet edhe përcaktimi i zonave me numër të objekteve të kësaj kategorie, të cilat në procesin e planifikimit do të kenë efekte në orientimin e zhvillimeve dhe investimeve kapitale në hapësirë për integrimin e tyre drejt zonave formale urbane.

Fig. 2. Tabela me numrin e ndërtimeve pa leje sipas komunave dhe MMPH-së. Burimi: RShNPL (09.09.2015).

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: MMPH-ja, në kuadër të zbatimit të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje, deri më 09.09.2015 ka përfunduar procesin e përpilimit të Regjistrit Shtetëror të Ndërtimeve pa Leje (RShNPL). Gjendja sipas këtij Regjistri është paraqitur në tabelën e fig. 2, ku numri i ndërtimeve pa leje në gjithë territorin e Republikës së Kosovës është 353.685 objekte, prej nga 849 objekte ose 0.24 % e totalit janë të kategorisë së III-të dhe 352,836 objekte ose 99.76 % i përkasin kategorisë së I-rë dhe të II-të.

Fig. 3. Grafiku sipas numrit të ndërtimeve pa leje të regjistruara nëpër komuna. Burimi: IPH (sipas RShNPL 2015)



Konkluzione:

Në nivelin e lartë të ndërtimeve pa leje ka ndikuar:

- Mungesa e planeve urbanistike për të përcjellë shkallën e madhe të zgjerimit urbanë;
- Mos efikasiteti i instrumenteve ligjore, organizative dhe monitoruese në komuna dhe Kosovë;
- Momentalisht numri i ndërtimeve pa leje është më i madhe se numri i ndërtimeve me leje në Kosovë, përkundër situatës që mbizotëron në vendet e BE dhe në shumicën e vendeve të rajonit;
- Megjithëse, Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje do të trajtoj dhe legalizoj shumicën e ndërtimeve të kësaj kategorie, përsëri do të mbetet numër mjaft i madh i objekteve, të cilat janë ndërtuar pas 30 Gushtit të vitit 2013 dhe vazhdojnë të ndërtohen akoma, që do të trajtohen me Ligjin për Ndërtim;
- Kurse, për menaxhim të kësaj situate duhet të përcaktohen edhe objektivat e qarta e kryesore të radhitura si në vazhdim:
- Inventarizimi i objekteve pa leje të ndërtuara pas datës 30 gusht 2013;
- Monitorimi i implementimit të Hartës Zonale të Kosovës dhe Hartave Zonale të Komunave, si dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme;
- Ndërtimi i një DB në GIS që përmbledh të gjitha objektet e ndërtuara (kategoria I, II – III) duke përfshirë edhe statusin legal të ndërtimit.

Treguesi:	**LLOJLLOJSHMËRIA BIMORE (EEA: CSI 009)**
Synimi:	INVENTARIZIMI I FLORËS
Objektivi:	VLERËSIMI I GJENDJES SË LLOJEVE BIMORE DHE PËRDORIMI I QËNDRUESHËM I TYRE

Përshkrimi i treguesit: Llojllojshmëria bimore paraqet numrin e llojeve të ndryshme, që janë të përfaqësuara në një komunitet të caktuar dhe përbëhet prej dy komponentëve: llojet e pasura, që paraqesin numërimin e thjesht të llojeve dhe llojet ekuilibër, që vlerësojnë se sa është e barabartë abondanca[31] e llojeve.




Fig. 1. Harta e zonave të rëndësishm të bimëve. Burimi: Raporti fillestar teknik i identifikimit të zonave Natyra 2000, në Kosovë.

Mënyra e matjes së treguesit: Matja e këtij treguesi bëhet duke llogaritur numrin e asociacioneve apo fitocenozave, aleancave, rendeve dhe klasave të vegjetacionit të pyjeve dhe livadheve, në raport me sipërfaqen e përgjithshme në vend.

Burimi i të dhënave: Burimi kryesor i të dhënave për këtë tregues është Departamenti i Biologjisë, në Universitetin e Prishtinës.

Kufizimet për matjen e treguesit: Kufizimet që paraqiten në matjen e këtij treguesi janë si rezultat i mungesës se inventarizimit të fitodiversitetit, në Kosovë. Pastaj shkatërrimi i diversitetit floristik nga faktori antropogjen po ashtu paraqesin pengesë për matjen e treguesit. Një gjë e tillë ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në shkatërrimin e habitateve dhe zhdukjen e llojeve bimore, të cilat nuk janë të njohura për shkencën dhe që duhet të hulumtohen.

Rëndësia për zhvillimin hapësinor: Ky tregues është i rëndësishëm sepse është mbështetje e ekosistemeve tokësore, në nivel global. Rol tjetër për zhvillimin hapësinor është ofrimi i shërbimeve të ekosistemeve për mbrojtjen e pellgjeve lumore, rregullimin e shtretërve të lumenjëve, duke përfshirë edhe ata ndërkufitar, përmirësimin e tokave, stabilizimin e klimës globale dhe sigurimin e habitateve për shumë lloje të faunës së egër.

Gjendja e treguesit: Sipas shënimeve të autorëve të ndryshëm mendohet se në Kosovë janë prezent afro 2800-3000 lloje të florës vaskulare.[32] Vegjetacioni i Kosovës është i përfaqësuar më 139 asociacione/fitocenoza, 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa.[33] Vegjetacioni i livadheve të ultësirave klasifikohet në katër asociacione që i përkasin një aleance, një rendi dhe një klase. Vgjetacioni i livadheve kodrinore subalpike dhe alpike klasifikohet në 65 asociacione, 33 aleanca, 22 rende dhe 13 klasa. Ndërsa vegjetacioni pyjor në 70 asociacione, 29 aleanca, 8 subaleanca, 12 rende dhe 6 klasa.

Konkluzione:

1. Mos evidentimi i zonave të rëndësishme bimore;
2. Mungesa e hulumtimit të të gjitha llojeve bimore në Kosovë;
3. Mungesa e të dhënave për llojet bimore të rrezikuara dhe atyre të rrezikuara me zhdukje
4. Mungesa e inventarizimit bimor
5. Mos evidentimi i të gjitha llojeve bimore të cilat janë të rëndësishme për tu përfshirë në Listën e Kuqe të Botës

[31] Abondanca është vlerësimi relativ i numrit të individëve për çdo lloj të asociacionit
[32] Millaku F, etj. Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës sëKosovës, MMPH, GIZ, UP - Prishtinë, 2013
[33] Strategjia dhe plani i veprimit për Biodiversitetin, MMPH, 2011 – 2020

Treguesi:	**ZONAT E MBROJTURA NATYRORE** (EEA: CSI 008)
Synimi:	MBROJTJA DHE SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I VLERAVE TË TRASHËGIMISË
Objektivi:	IDENTIFIKIMI DHE RUAJTJA E HABITATEVE NATYRORE DHE E LARMISË BIOLOGJIKE

Përshkrimi i treguesit: Zonat e mbrojtura, paraqesin sipërfaqen e gjelbër me vlera të trashëguara natyrore të cilat gëzojnë mbrojtje ligjore, e që janë identifikuar për rrjetin Emerald të Këshillit të Evropës, në të cilin Kosova ende nuk është anëtare.




Fig. 1. Harta me zonat e mbrojtura natyrore në Kosovë. Burimi: IMNK / AMMK / MMPH.

Mënyra e matjes së treguesit: Nga të gjitha zonat e mbrojtura, të identifikuara në vend deri në vitin 2014, është llogaritur shuma e përbashkët e sipërfaqeve të tyre. Vlera e dhënë në përqindje, tregon raportin, në kuadër të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës.


Burimi i informatës/ave: Burimi kryesor i të dhënave për këtë tregues është Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN), në kuadër të Agjencisë së Mbrojtjes së Mjedisit të Kosovës (AMMK), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)[34].

Kufizimet për matjen e treguesit: Lidhur me këtë çështje nuk ka ndonjë kufizim të veçantë përpos mungesës së ekspertizës adekuate për identifikimin e zonave përkatëse. Aktualisht jemi në fazën e identifikimit të zonave potenciale, në këtë drejtim Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës me kapacitetet e veta është duke propozuar zona të reja, të cilat së shpejti do të kenë statusin e mbrojtjes ligjore.

[34] MMPH / AMMK, Raporti për Gjendjen e Natyrës 2010-2013, Prishtinë 2014.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Treguesi i zonave të mbrojtura natyrore ka rëndësi të madhe, duke pasur parasysh se përmes identifikimit dhe planifikimit të mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm mjedisor, do të arrihet zhvillimi ekonomik i vendit. Në kuadër të këtyre zonave janë krijuar edhe regjime të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të shkallës së parë, dytë dhe tretë, në të cilat ndalohen aktivitetet që kanë ndikim të dëmshëm për vlerat e trashëgimisë natyror dhe kulturore, larmisë biologjike dhe peisazhit.

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Gjatë krahasimit të të dhënave të shprehura në përqindje, për zonat e mbrojtura deri në vitin 2007, shihet se Kosova ishte e renditur e parafundit në rajon, që do të thotë se kishte vetëm 4,2 % sipërfaqe të mbrojtur në kuadër të territorit të vendit (fig. 2).



	Total area km²	Protected area km²	Protected area in %
Albania	28 745	2 619	9.1
Croatia	56 628	5 125	9.1
Bosnia and Herzegovina	51 129	385	0.8
Macedonia	25 722	1 882	7.3
Montenegro	13 812	1 061	7.7
Serbia	77 474	3 719	4.8
Kosovo	10 887	462	4.2

Fig. 2. Grafiku me % e zonave të mbrojtura në vendet e regjionit / 2007. Burimi: Ministritë përkatëse të rajonit.

Mirëpo, pas shpalljes së Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", si kategori e dytë e mbrojtjes në IUCN, sipërfaqja e zonave të mbrojtura është rritë në rreth 11 %, kështu që, Kosova tani është renditur e treta me radhë në mesin e shteteve të këtij rajoni (fig.3).




Fig. 3. Grafiku i renditjes së vendeve të regjionit / 2014. Burimi: Ministritë e vendeve të rajonit.

Konkluzione:

- Vendi ynë posedon larmi biologjike me vlera të veçantë natyrore, të cilat duhet të merren në konsideratë dhe të trajtohen sipas normave dhe standardeve në fuqi gjatë planifikimit të zhvillimeve në natyrë nga të gjitha nivelet e planifikimit;
- Sikur në vendet e regjionit dhe më gjerë, edhe në Kosovë, zonat e mbrojtura duhet të ndahen dhe të trajtohen sipas kategorive të IUCN-së, në mënyrë që si të tilla të bëhen pjesë e rrjeteve të ndryshme ndërkombëtare të zonave të mbrojtura.
- Është shumë e nevojshme fillimi i identifikimit dhe përcaktimit të rajoneve biogjeografike dhe grumbullimi i të gjitha informatave hapësinore për to. Këto të dhëna duhet të na shërbejnë si argument bazë për kyçjen e vendit tonë në rrjetet dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare, që merren me trajtimin dhe mbrojtjen e rajoneve në fjalë.

Treguesi	**NUMRI I MONUMENTEVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE NËN MBROJTJE**
Synimi:	MBROJTJA DHE ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM I TRASHËGIMISË KULTURORE
Objektivi:	NGRITJA E NIVELIT TË VLERAVE TË MONUMENTEVE ME IDENTITET KULTURORË

Përshkrimi i treguesit: Ky tregues paraqet numrin e monumenteve, të objekteve dhe tërësive me vlera të Trashëgimisë Kulturore (që sipas Ligjit për TK janë ndërtime dhe struktura me vlera të veçanta arkeologjike, arkitektonike, historike, artistike dhe shkencore me interes shoqëror dhe shtetëror), të cilat kërkojnë trajtim ligjor dhe profesional për mbrojtjen, ruajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.




Fig.1. Harta me ZVM të definuara në PH të Kosovës. Burimi: MMPH/IPH, nga PH i Kosovës, Prishtinë 2010.

Mënyra e matjes së treguesit: "Lista e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme[35]", që publikohet rregullisht tri viteve të fundit, është instrumenti kryesor për matjen numrit të monumenteve të trashëgimisë kulturore (me përmbajtje të trashëgimisë të luajtshme dhe të paluajtshme kulturo-historike) në Kosovë, duke mundësuar azhurnim të kohë pas kohe të saj.

Burimi i informatës/ave: Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) përkatësisht Departamenti për Trashëgimi Kulturore (DTK) duke përfshirë edhe njësitë e saja si Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK), janë burimi kryesor i informatave.

[35] MKRS: Lista e Trashëgimisë Kulturore për mbrojtje të përkohshme Prishtinë 2014

Kufizimet për matjen e treguesit: Sipas përgjegjësive, të dhënat për vlerat e trashëgimisë kulturo-historike mblidhen nga Qendrat Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (QRTK) përmes procesit të inventarizimit. Ndonjëherë, ndodh, që informatat të mos jenë në harmoni të plotë më gjendjen ekzistuese të monumentit, që në mënyrë direkte ndikon në prezantimin korrekt të gjendjes.

Rëndësia e treguesit për zhvillimin hapësinor: Identifikimi dhe regjistrimi i të dhënave për numrin, gjendjen dhe shtrirjen e objekteve dhe tërësive me vlera të trashëgimisë kulturore, ndikon drejt arritjes së synimit për mbrojtjen e identitetit dhe të vlerave të trashëguara kulturore – historike dhe që përmes zhvillimit të turizmit kulturor të arrihet edhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në nivelin lokal dhe qendror. Sigurimi i mjeteve financiare dhe i kapaciteteve njerëzore profesionale ndikon drejtpërdrejtë në shkallën e përgatitjes, trajtimit, planifikimit dhe të menaxhimit të projekteve dhe planeve në të dyja nivelet e qeverisjes për zhvillim të qëndrueshëm të vlerave të trashëgimisë kulturore me "status të mbrojtjes së shtetit".

Gjendja e treguesit dhe krahasimi: Nga listat dhe diagramet në vazhdim paraqitet numri i objekteve dhe tërësive arkitektonike, të objekteve dhe lokaliteteve arkeologjike, të zonave historike dhe monumenteve, kishave dhe manastireve, etj, që janë të regjistruara në listën e trashëgimisë botërore nga të Kosovës. Edhe pse, Kosova, nuk është ende anëtare e UNESCO-s, të katër (4) monumentet e saj për momentin (fig. 2 dhe 3) janë të evidentuara si të "Krahinës së Serbisë", gjë e cila pritet të ndryshohet së shpejti.



Fig. 2. Diagrami me nr. e monumenteve të trashëgimisë botërore-në UNESCO, nga shtetet e rajonit. Burimi: MMPH / IPH sipas Listës së UNESCO-s, nga Web:.wwwhttp://whc.unesco.org/en/list/

UNESCO - Lista e trashëgimisë botërore	
Kosova	Manastiri i Deçanit
	Patrikana e Pejës
	Kisha e Levishës
	Manastiri i Graçanicës
Shqipëria	Butrinti
	Zona historike e Beratit
	Zona historike e Gjirokastrës
Sërbia	Stari Ras Sopoçani
	Manastiri i Studenicës
	Lokalitet arkeologjik Gamzigrad - Romuliana
Mali i Zi	Regjioni natyror dhe kulturo-historik i Kotorit
	Parku Kombëtar Durmitor
Maqedonia	Trashëgimia natyrore dhe kulturore e Rajonit të Ohrit

Fig. 3. Tabela me monumentet e trashëgimisë botërore - UNESCO, nga Kosova dhe shtetet e rajonit. Burimi: MMPH / IPH sipas Listës së UNESCO-s, nga Web:.www. http://whc.unesco.org/en/list/.

Fig. 4. Tabela me numrin monumenteve të TK nga listat e viteve 2012-2015. Burimi: MKRS, Lista e monumenteve të TK-së në Kosovë.

Lista e Trashëgimisë kulturore të Kosovës për mbrojtje të përkohshme					
Kategoritë	Trashëgimia Arkeologjike		Trashëgimia Arkitekturore		Trashëgimia Luajtshme
Nën-kategoritë	Monument / Ansambël	Lokalitet arkeologjik / Rezervat	Monument / Ansambël	Fusha të konservimit arkitekturor	Objekte të luajtshme
2012/2013	86	267	824	2	X
2013/2014	87	312	825	2	199
2014/2015	87	314	833	2	202



Fig. 4. Diagrami me numrin e monumenteve të TK nga listat e viteve 2012-2015. Burimi: MKRS, Lista e monumenteve të TK-së në Kosovë.

Përderisa, numri i përgjithshëm i monumenteve të Kosovës, në Listën Botërore të Trashëgimisë Kulturore në UNESCO-s është 4, ndërkaq në Listën e Mbrojtjes së Përkohshme të MKRS-së, me statusin e mbrojtjes ligjore nga shteti, të vitit 2014, janë gjithsejtë 1.438 objekte dhe tërësi. Këto Monumente, ndahen dhe kanë edhe numrin e veçantë sipas kategorisë dhe nënkategorisë që i përkasin, siç janë paraqitur edhe në fig. 4 dhe 5.

Konkluzione:

- Duke e analizuar numrin nga lista e trashëgimisë kulturore të Kosovës, vërehet një rritje graduale për këto tri vite, që është një tregues i mundshëm për arritjen e synimit që ka të bëjë me mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të TK;
- Duke u bazuar në informatat e mësipërme mund të konkludohet se indikatori "Numri i Monumenteve të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje" është njëri ndër indikatorët më të rëndësishëm, që duhet të trajtohet në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor të nivelit qendror dhe lokal. Të gjithë përgjegjësit duke përfshirë edhe hartuesit e dokumenteve të planifikimit hapësinor janë të obliguar që të marrin në konsideratë trajtimin e monumenteve që dalin nga Lista e Monumenteve nën Mbrojtje. Një veprim i tillë do të ketë ndikim direkt në ruajtjen e identitetit historik/kulturor për zonën e përfshirë në planin përkatës. Planet hapësinore dhe urbane duhet të shërbejnë si instrumente për zhvillimin e territoreve përkatëse dhe mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Në bazë të analizave që janë bërë për këtë indikator, rekomandohet që:
    - Të fillohet iniciativa për nxjerrjen urgjente të listës së përhershme të trashëgimisë kulturore; dhe
    - Të punohet harta e Trashëgimisë Kulturore, ku do të përfshihen kategoritë, nënkategoritë si dhe numri i objekteve nga lista e trashëgimisë së përhershme.

TREGUESIT/INDIKATORËT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

SETI I PARË

Hartues i dokumentit:

Instituti për Planifikim Hapësinor

Luan NUSHI, drejtor (arkitekt planer)

Faton DEVA (arkitekt planer), koordinator i projektit;

Elvida PALLASKA (arkitekt planere), ndihmëse e koordinatorit;

Përgjegjës të zhvillimit të treguesve/indikatorëve:

Arbën RRECAJ (arkitekt planer);
- Raporti në mes prodhimit dhe konsumit të energjisë elektrike
- Përqindja e popullsisë që furnizohet me ujë të pijshëm
- Përqindja e rrugëve të asfaltuara nga rrjeti i rrugëve
- Dendësia e rrjetit rrugor të asfaltuar në Kosovë
- Dendësia e rrjetit hekurudhor në republikën e Kosovës

Faton DEVA (arkitekt planer);
- Shkalla e papunësisë (me përkrahjen e praktikanteve Etnike Dibrani dhe Albulena Murati)
- Raporti në mes popullsisë urbane dhe rurale (me përkrahjen e praktikantit Faton Morina)
- Potenciali i tokës bujqësore
- Përdorimi (shfrytëzimi) i tokës

Elvida PALLASKA (arkitekt planere);
- Vlera e eksport - importit dhe e bilanci tregtar
- Pjesëmarrja e sektorëve në BPV

Shpend AGAJ (gjeograf planer);
- Kualiteti i ajrit
- Kualiteti i ujërave sipërfaqësore
- Degradimi i shtretërve të lumenjve dhe rreziku nga vërshimet
- Pyllëzimi dhe ripyllzimi si masë antierozion

Nexhmije KAMBERI (biolog planerë, ish zyrtare e IPH-së);
- Progresi në menagjimin e zonave të ndotura
- Zonat e mbrojtura natyrore
- Llojllojshmëria bimore

Besim GOLLOPENI (sociolog planer, ish zyrtar i IPH-së);
- Dendësia e popullsisë dhe shpërndarja e saj
- Migrimet e jashtme në Kosovë

Zana MEHMETI (arkitekt planere);
- Numri i vizitorëve të jashtëm dhe vendor

Festa NELA (arkitekt planer/GIS);
- Numri i monumenteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje

Gëzime Grajqevci (arkitekt planere);
- Bruto produkti vendor (BPV) për kokë banori

Riza MURSELI (gjeograf planer/GIS);
- Potenciali i tokës ndërtimore
- Vendbanimet joformale
- Numri i ndërtimeve pa leje

Literatura dhe referencat për treguesit e trajtuar

- MMPH/IPH, Qershor 2010, "Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+", IPH, Prishtinë;
- Agjencia e statistikave të Kosovës, Qershor, 2015; Seria 3: Statistikat Ekonomike**/** Statistikat e Hotelerisë TM 1 – 2015
- www. http : //whc. unesco. org/en/ list;
- Agjencia Statistikore e Kosovës, dhjetor 2013, "Atllasi I regjistrimit të popullisë në Kosovë, ESK, Prishtinë", Prishtinë;
- Seidel, M. A.2010, "Innovative Spatial Planning Instruments and their Contribution to European Integration", Conference-Paper, European Management Institute, University of Waterloo, 2010;
- The World Bank, "Knowledge Economy Index (KEI) 2012 Rankings" Avaliable from http://siteresources.worldbank.org/INTUNIKAM/Resources/2012.pdf ;
- UNDP, 2012 "Raporti I zhvillimit njerëzor në Kosovë 2012", sektori privat dhe punësimi", Prishtinë;
- The World Bank, IBRD-IDA. World Development indicators, data by country. [online] Qasur ne: <http://data.worldbank.org/country/kosovo>[Qasur Tetor 2015]
- MKRS / DTK, 2012/2013/2014, "Lista e Trashëgimisë kulturore të Kosovës me mbrojtje të përkohshme", Prishtinë.
- AMMK, Raporti për Hotspotet Mjedisore në Kosovë, Prishtinë, 2011
- IKMN, Raporti për Gjendjen e Natyrës 2010-2013, Prishtinë 2014
- DMM, Raporti fillestar teknik i identifikimit të zonave Natyra 2000, në Kosovë
- IKMN, Raporti i gjendjes së natyrës, 2006-2007
- MMPH, Strategjia dhe plani i veprimit për Biodiversitetin, 2011 – 2020
- Millaku F, 2013, Libri i Kuq i Florës Vaskulare të Republikës sëKosovës, MMPH, GIZ, UP - Prishtinë
- Studimi i sektorit pyjor të Kosovës – 2013
- Inventarizimi i Nacional i Pyjeve të Kosovës, 2012, 2013.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Shtator 2014, "Bruto produkti vendor në qasjen e shpenzimeve (2008-2013)", ASK, Prishtinë.
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Mars 2013, Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, MTI, Prishtinë.
- INSTITUTI RIINVEST, 2014, "Klima e Biznesit në Kosovë – Një Perspektivë Ndër-Rajonale, INSTITUTI RIINVEST, Prishtinë.
- MMPH. Regjistri kombëtar i ndërtimeve pa leje në Kosovë, Prishtinë 11 qershor 2015.
- MMPH. "Raporti i Gjendjes së Vendbanimeve Joformale në Kosovë", Prishtinë 2010.
- MMPH-EULUP. "Plani i Zonave Ndërtimore (PZN)", Prishtinë 2011.
- Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Infrastrukturës (MI), 2015, "Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeqar", MI;
- T. Kerni, 2015, "Region JIE s potencijalom, ali i pred izazovima", A.T.Kerni;
- Trainkos Sh.A, 2013, "Plani i biznesit 2014", Trainkos Sh.A;
- Infrakos Sh.A, 2014, "Ekspozeu i rrjetit", Infrakos Sh.A;
- Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Kanalizim (ZRUK), 2014, "Raporti vjetor i performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Kosovë në 2013", ZRUK;
- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), 2015, "Deklaratë mbi Sigurinë e Furnizimit në Kosovë (energji elektrike, gaz natyror dhe naftë)", ZRRE;
- S. E. Weishaar, S. Madani, 2015, "Report on the long-term economic viability of constructing new electricity capacities for electricity exports in the Western Balkan countries", CEE Bankwatch Network, The University of Groningen, The Netherlands, The Advisory House, Germany
- Busurelo, I. Zgrabljic, M. Lenardic, S. Klanjcic, 2015, "The Republic of Croatia: Energy, Potential and Projects"
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atllasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Migrimi kosovar , Prishtinë 2014
- ASK 2013 dhe http://en.wikipedia.org/wiki/Balkans.
- "Balkan vital Graphics" collection at http://www.grida.no/publications/vg/balkan.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atllasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013.
- Ramadani I, "Planifikimi Hapësinor dhe Urban", Prishtinë 2013.
- Burimi: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Glossary:Revision_of_the_degree_of_urbanisation

- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): Atllasi i Regjistrimit të Popullsisë Kosovë 2011, Prishtinë 2013.
- INSTAT, ''Njerëzit dhe puna në Shqipëri'' faqe 28, Tiranë 2004.
- ASK, "Rezultatet e Anketës së fuqisë punëtore në Kosovë 2014" faqe 10, Prishtinë, Qershor 2014.
- Projekti Nr. 2010/230-489 i BE / ZNKE-së, EULUP - Mbështetje e Mëtutjeshme e Shfrytëzimit Tokës, Raporti Nr. 17 "Udhëzues për Planifikim Hapësinor", Prishtinë 2012.
- APK / MBPZHR, "Inventarizimi Nacional i Pyjeve të Kosovës 2012", Prishtinë 2013
- Eurostat

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

TREGUESIT/INDIKATORËT PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

SETI I PARË

Qershor, 2016

Prishtinë